



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Viti: 2026 – Numri: 198

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E hënë, 14 shtator 2026

PËRMBAJTJA

	Faqe
Urdhër i Kryetarit të Kuvendit nr. 52, datë 4.9.2026	Për delegimin e përfaqësimit ligjor të Kuvendit të Shqipërisë..... 19811
Udhëzim i ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit nr. 5, datë 1.9.2026	Për një ndryshim dhe shtesë në udhëzimin nr. 980, datë 15.11.2024, “Për përcaktimin e formës dhe mënyrës së paraqitjes së kërkesës për miratimin si përdorues për të ushtruar aktivitet brenda parqeve teknologjike dhe shkencore”..... 19813
Udhëzim i ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit nr. 6, datë 1.9.2026	Për zbatimin e vendimit nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar..... 19813
Udhëzim i ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit nr. 7, datë 1.9.2026	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 5222, datë 26.6.2015, “Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014, ‘Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes’, të ndryshuar”..... 19824
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 892, datë 3.9.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Spanjës..... 19829
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 893, datë 3.9.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Austrisë..... 19831
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 894, datë 3.9.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Francës..... 19832
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 907, datë 4.9.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Spanjës..... 19834

Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 908, datë 4.9.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së lisë së dhenve dhe dhive, të shfaqur në shtetin e Rumanisë.....	19836
Urdhër i ministrit të Mbrojtjes nr. 1908, datë 9.9.2026	Për delegimin e kompetencave.....	19837
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut datë 25.8.2026	Çështja Papandile kundër Shqipërisë (<i>kërkesa nr. 38771/23</i>).....	19837
Vendim i Bordit të Mbikëqyrjes Publike nr. 30, datë 26.8.2026	Për një ndryshim në rregulloren nr. 2, datë 22.2.2018, “Për funksionimin e Komisionit të Provimeve të Aftësive Profesionale dhe mbikëqyrjes së procesit të testimit të kandidatëve për auditues ligjor dhe kontabilist të miratuar të Bordit të Mbikëqyrjes Publike”, të ndryshuar.....	19842
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 241, datë 28.8.2026	Mbi modifikimin e licencës së shoqërisë “Power Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 25 mw.....	19857
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 242, datë 28.8.2026	Mbi fillimin e procedurës administrative për kërkesën e shoqërisë “AlbPower” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	19860
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 243, datë 28.8.2026	Mbi modifikimin e licencës së shoqërisë “GreeNNat Solar Park Ballsh” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 100 mw.....	19861
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 244, datë 28.8.2026	Mbi modifikimin e licencës së shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 8.8 mw.....	19865
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 245, datë 28.8.2026	Mbi modifikimin e licencës së shoqërisë “Sunny Side Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 100 mw.....	19868
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 246, datë 28.8.2026	Mbi fillimin e procedurës administrative për kërkesën e shoqërisë “EuroTech Innovation” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.....	19871

**URDHËR****Nr. 52, datë 4.9.2026****PËR DELEGIMIN E PËRFAQËSIMIT
LIGJOR TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 76 të Kushtetutës; të neneve 28, 29 dhe 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” dhe të neneve 7, pika 1 të Rregullores së Kuvendit,

URDHËROJ:

1. Drejtori i përgjithshëm i Shërbimit Legjislativ dhe Monitorimit të Institucioneve në Kuvendin e Shqipërisë është autoriteti të cilit i delegohet kompetenca e përfaqësimit të institucionit, në lidhje me proceset gjyqësore në Gjykatën Kushtetuese.

2. Autoriteti i përcaktuar në pikën 1, personi që do të përfaqësojë Kuvendin, autorizohet për të hartuar, nënshkruar dhe dorëzuar ankimin/rekursin në të gjitha seancat gjyqësore të çështjes administrative/civile/penale/gjyqësimit në Gjykatën Kushtetuese.

3. Përfaqësimi i Kuvendit të Shqipërisë në proceset gjyqësore/Gjykatën Kushtetuese, sipas këtij urdhri, i jep të drejtë përfaqësuesit të autorizuar të kryejë çdo veprim procedural të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, në kuadër të përfaqësimit në të gjitha nivelet përkatëse të gjyqësimit.

4. Autorizimet për përfaqësim ligjor të Kuvendit të Shqipërisë në proceset gjyqësore, kur thirret si palë në një gjykim, lëshohen nga drejtori i përgjithshëm i Shërbimit Legjislativ dhe Monitorimit të Institucioneve në emër të personit që do të përfaqësojë Kuvendin.

5. Autorizimet për përfaqësim ligjor të Kuvendit të Shqipërisë në proceset gjyqësore në Gjykatën Kushtetuese, kur thirret si subjekt i interesuar, lëshohen nga drejtori i përgjithshëm i Shërbimit Legjislativ dhe Monitorimit të Institucioneve në emër të personit që do të përfaqësojë Kuvendin.

6. Modeli i autorizimit për përfaqësim në proceset gjyqësore është sipas lidhjes nr. 1 bashkëlidhur këtij urdhri.

7. Përfaqësimi për çdo proces gjyqësor/gjykim në Gjykatën Kushtetuese bëhet nga autoriteti i përcaktuar në pikën 1 dhe në pamundësi të tij, rast pas rasti, nga personat e përcaktuar me autorizim të lëshuar nga drejtori i përgjithshëm i Shërbimit Legjislativ dhe Monitorimit të Institucioneve.

8. Urdhri nr. 7, datë 17.9.2025, “Për delegimin e përfaqësimit ligjor të Kuvendit të Shqipërisë”, shfuqizohet.

9. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR
Niko Peleshi**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

Nr. ____ prot.

Tiranë, më _____._____.2026

LIDHJA 1

AUTORIZIM**Për përfaqësimin në çështjen administrative/civile/penale
dhe në Gjykatën Kushtetuese**

Paditës/kërkues: _____

I paditur/subjekt i interesuar: _____

Objekt: _____

Në mbështetje të neneve 64–77 të Kodit Civil, të nenit 96 të Kodit të Procedurës Civile; të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar; të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të urdhrit të Kryetarit të Kuvendit nr. ____, datë _____._____.2025, “Për delegimin e përfaqësimit ligjor të Kuvendit të Shqipërisë”

VENDOSA:

Autorizimin e z./znj. _____, me detyrë _____, për të përfaqësuar Kuvendin e Shqipërisë në të gjitha seancat gjyqësore të çështjes administrative, civile, penale, gjykim në Gjykatën Kushtetuese me objektin e sipërcituar deri në shpalljen e vendimit në gjykatën kompetente për gjykimin e mosmarrëveshjeve përkatëse/Gjykatën Kushtetuese.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM I SHËRBITIT LEGJISLATIV
DHE MONITORIMIT TË INSTITUCIONEVE**



UDHËZIM
Nr. 5, datë 1.9.2026

**PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË
UDHËZIMIN NR. 980, DATË 15.11.2024,
“PËR PËRCAKTIMIN E FORMËS DHE
MËNYRËS SË PARAQITJES SË
KËRKESËS PËR MIRATIMIN SI
PËRDORUES PËR TË USHTRUAR
AKTIVITET BRENDA PARQEVE
TEKNOLOGJIKE DHE SHKENCORE”**

Në mbështetje të pikës 4, neni 102, të Kushtetutës; të nenit 18, pika 3, të ligjit nr. 58/2022, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e parqeve teknologjike dhe shkencore”, të ndryshuar; të kreut I, pika 1, të vendimit nr. 418, datë 7.7.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e procedurave për përzgjedhjen e përdoruesit në parqet teknologjike dhe shkencore”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 980, datë 15.11.2024, “Për përcaktimin e formës dhe mënyrës së paraqitjes së kërkesës për miratimin si përdorues për të ushtruar aktivitet brenda parqeve teknologjike dhe shkencore”, bëhen ndryshimet dhe shtesa, si më poshtë:

1. Në formularin 2 “Formulari i vetëdeklarimit”, të parashikuar në shkronjën “b”, të pikës 1, të nenit 4, shkronjat “a” dhe “b” shfuqizohen.

2. Pas nenit 6 shtohet neni 6/1 me titull “Subjektet e ngarkuara për zbatim”, me përmbajtje si vijon:

“6/1 Ngarkohet struktura përgjegjëse për parqet teknologjike dhe shkencore pranë Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit dhe çdo person fizik ose juridik, shqiptar ose i huaj, i cili ka fituar statusin e zhvilluesit të Parkut Teknologjik dhe Shkencor, për zbatimin e këtij udhëzimi.”.

3. Ngarkohet struktura përgjegjëse për parqet teknologjike dhe shkencore pranë Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit dhe çdo person fizik ose juridik, shqiptar ose i huaj, i cili ka fituar statusin e zhvilluesit të Parkut Teknologjik dhe Shkencor për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I EKONOMISË
DHE INOVACIONIT
Delina Ibrahimaj

UDHËZIM
Nr. 6, datë 1.9.2026

**PËR ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 54,
DATË 5.2.2014, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E
KRITEREVE, TË PROCEDURËS DHE TË
MËNYRËS SË DHËNIES ME QIRA,
ENFITEOZË APO KONTRATA TË TJERA
TË PASURISË SHTETËRORE”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës dhe të pikës 3, të kreut IX, të vendimit nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

**KREU I
TË PËRGJITHSHME**

1. Ky udhëzim përcakton rregullat dhe procedurat që zbatohen për dhënien me qira ose enfiteozë të pasurive shtetërore, në përputhje me kriteret, kushtet dhe mënyrën e përcaktuar në vendimin nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar, që më poshtë citohet (VKM).

2. “Truall i lirë” – është pasuria e paluajtshme shtetërore, e identifikuar si e tillë në regjistrin e pasurive të paluajtshme, e cila nuk është e zënë nga ndërtime, objekte apo struktura të përhershme.

3. “Tokë inproduktive” – Janë toka cilësisht të dobëta të cilat nuk janë të përshtatshme për prodhim. Për kategoritë e zërave kadastrale që, për nga natyra dhe karakteristikat e tyre, mund të trajtohen si tokë inproduktive, vlerësimi dhe



përfshirja e tyre në këtë kategori bëhet pas marrjes së konfirmimit nga institucioni kompetent, në përputhje me fushën e përgjegjësisë, lidhur me klasifikimin e zërit përkatës kadastral si tokë inproduktive.

4. “Ndërtesë” – është çdo objekt ndërtimor i realizuar mbi ose në sipërfaqen e tokës, i cili përbëhet nga struktura të përhershme dhe shërben për një funksion të caktuar përdorimi.

5. “Sipërfaqe funksionale (jo nën ndërtesë)” – janë hapësirat e lira përreth objektit, të nevojshme për t’i shërbyer këtij të fundit. Sipërfaqja funksionale jepet me qira/enfiteozë gjithnjë me objektin e ndërtuar mbi sipërfaqen e tokës dhe sipërfaqen e lidhur ngushtësisht me të.

6. “Makineri, pajisje dhe linja prodhimi të institucioneve shtetërore” – janë tërësia e mjeteve teknike, mekanike, elektrike, elektronike dhe teknologjike, përfshirë makineritë individuale, pajisjet ndihmëse, instalimet teknologjike dhe linjat e prodhimit, në pronësi ose administrim të institucioneve/ndërmarrjeve apo shoqërive shtetërore.

7. “Adresë zyrtare elektronike” – është adresa elektronike e përcaktuar nga institucioni përgjegjës për zhvillimin e procedurës së dhënies me qira/enfiteozë të pasurive shtetërore, e cila shërben si mjet zyrtar për publikimin, administrimin dhe komunikimin elektronik gjatë procedurës.

8. “Seksioni i posaçëm i faqes zyrtare elektronike të institucionit” - është moduli i dedikuar në faqen zyrtare elektronike të institucionit, në të cilin publikohen njoftimet e procedurave të dhënies me qira ose enfiteozë të pasurisë shtetërore.

9. “Pasuri shtetërore mbi 200 m²” – është pasuria e paluajtshme shtetërore, e regjistruar dhe e individualizuar si pasuri më vete në dokumentacionin kadastral, sipërfaqja e së cilës rezulton mbi 200 m². Kur në të njëjtën zonë kadastrale ndodhen dy ose më shumë pasuri shtetërore dhe shprehet interes për marrjen në përdorim me qira/enfiteozë, kufiri prej 200 m² vlerësohet për secilën pasuri më vete.

KREU II PROCEDURA E DHËNIES ME QIRA/ENFITEOZË TË PASURISË SHTETËRORE

1. Organi që ushtron të drejtën e përfaqësuesit të pronarit të pasurisë shtetërore, vihet në lëvizje për fillimin e procedurës së dhënies me qira ose enfiteozë të pasurisë shtetërore, me kërkesë të një subjekti të interesuar ose me propozim të institucionit, ndërmarrjes apo shoqërisë shtetërore që ka në administrim pasurinë shtetërore.

1.1 Kërkesa nga çdo subjekt i interesuar, shoqërohet me dokumentacion paraprak i cili, sipas rastit, përmban:

a) të dhënat identifikuese të kërkuarit dhe, kur kërkuari është person juridik, ekstraktin e regjistrimit tregtar, NUIS/NIPT-in dhe dokumentin që provon përfaqësimin;

b) identifikimin e pasurisë që kërkohet të jepet me qira ose enfiteozë dhe të dhënat kadastrale;

c) përshkrimin e veprimtarisë që synohet të ushtrohet, afatin e kërkuar, nivelin e parashikuar të investimit, punësimit dhe burimit të financimit;

ç) dokumentacionin orientues teknik, si projektide, skica ose informacion tjetër paraprak, kur natyra e veprimtarisë ose e pasurisë e kërkon.

Dokumentacioni paraprak shërben për vlerësimin e mundësisë së fillimit të procedurës dhe nuk zëvendëson dokumentacionin që kërkohet në momentin e shpalljes së procedurës së konkurrimit.

1.2 Kur propozimi për fillimin e procedurës inicohet nga institucioni, ndërmarrja apo shoqëria shtetërore që ka në administrim pasurinë, dokumentacioni i paraqitur duhet të jetë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në pikën 1, të kreut II, të VKM-së.

2. Përgatitja e procedurës së dhënies me qira ose enfiteozë të pasurisë shtetërore, zhvillohet në rrugë shkresore. Institucioni që ka në përgjegjësi administrimi pasurinë shtetërore përgatit dokumentacionin tekniko-ligjor, në të cilin përcaktimi i afatit të përdorimit, veprimtarisë që do të ushtrohet në pasuri, bëhet nga institucioni përgjegjës, rast pas rasti, në përputhje me destinacionin e pasurisë dhe interesin publik.

2.1 Kur pasuria shtetërore është në pronësi të institucioneve të qeverisjes qendrore apo nga organet e njëjësive të vetëqeverisjes vendore,



procedura zhvillohet nga këto institucione, sipas parashikimeve në VKM.

2.2 Për pasuritë shtetërore, për të cilat nga dokumentacioni kadastral rezulton se pasuria është në pronësi “shtet” dhe nuk është regjistruar në përgjegjësi administrimi të një institucioni shtetëror, shoqërie shtetërore ose ndërmarrjeje shtetërore, ministria përgjegjëse për ekonominë zhvillon procedurën për dhënien e saj me qira ose enfiteozë, në përputhje me përcaktimet e VKM-së dhe këtij udhëzimi. Struktura përgjegjëse në ministrinë përgjegjëse për ekonominë, përgatit dokumentacionin tekniko-ligjor dhe vijon procedurën e dhënies me qira ose enfiteozë, sipas procedurave dhe afateve të përcaktuara në VKM dhe në këtë udhëzim. Në çdo rast, kur gjatë procedurës, rezulton se pasuria është regjistruar në përgjegjësi administrimi të një institucioni tjetër ose evidentohet ekzistenca e një akti administrativ për kalimin e saj në administrim, ministria përgjegjëse për ekonominë ndërpret procedurën dhe ia përcjell dokumentacionin institucionit që ka në përgjegjësi administrimi pasurinë, për vijimin e procedurës sipas përcaktimeve të VKM-së.

3. Institucioni përgjegjës për zhvillimin e procedurës, pas administrimit të dokumentacionit tekniko-ligjor, publikon njoftimin në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në seksionin e posaçëm të faqes së tij zyrtare elektronike, në përputhje me përcaktimet e VKM-së. Në seksionin e posaçëm publikohen, njoftimet, dokumentacioni i nevojshëm për t'u depozituar nga ofertuesit, rezultatet e procedurës, njoftimi i fituesit, si dhe çdo akt ose informacion tjetër, publikimi i të cilit është i nevojshëm. Nga momenti i publikimit të njoftimit, komunikimi ndërmjet institucionit dhe ofertuesve, administrimi i dokumentacionit dhe çdo veprim procedural gjatë konkurrimit zhvillohen vetëm nëpërmjet adresës zyrtare elektronike të institucionit.

4. Ofertuesit depozitojnë ofertën dhe dokumentacionin shoqërues në adresën zyrtare elektronike të përcaktuar në njoftimin për konkurrim, brenda afatit të përcaktuar për depozitimin e ofertave. Për efekt të paraqitjes dhe administrimit elektronik, dokumentacioni paraqitet në format PDF-je.

5. Oferta dhe dokumentacioni shoqërues, i depozituar pas përfundimit të afatit të përcaktuar ose në një adresë të ndryshme nga adresa zyrtare

elektronike e përcaktuar në njoftimin për konkurrim, nuk merren në shqyrtim nga komisioni i dhënies me qira/enfiteozë.

6. Pas përfundimit të afatit për depozitimin e ofertave, komisioni i ngritur për këtë qëllim akseson ofertat e depozituara dhe harton procesverbalin e hapjes së procedurës.

Procesverbali përmban të paktën:

- a) datën dhe orën e hapjes së procedurës;
- b) përbërjen e Komisionit dhe deklaratimet e anëtarëve për mungesën e konfliktit të interesit;
- c) listën e ofertuesve pjesëmarrës;
- ç) dokumentacionin e paraqitur nga secili ofertues;
- d) konstatimet e evidentuara gjatë administrimit të ofertave.

Procesverbali nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit dhe është pjesë përbërëse e dosjes së procedurës. Ai përbën akt të brendshëm administrativ.

7. Komisioni verifikon deklaratimet dhe të dhënat e paraqitura nga ofertuesit nëpërmjet platformës elektronike *e-Albania* ose nëpërmjet ndërveprimit ndërinstitucional, konform legjislacionit në fuqi. Paraqitja e dokumenteve provuese nga ofertuesit nuk e përjashton komisionin nga detyrimi për kryerjen e verifikimeve përkatëse. Kur gjatë verifikimit, konstatohen pasaktësi ose mospërputhje që ndikojnë në përmbushjen e kushteve të procedurës, komisioni vepron në përputhje me përcaktimet e VKM-së.

8. Komisioni vlerëson çdo ofertë të vlefshme në bazë të kriterëve dhe metodologjisë së mëposhtme. Në rast se administrohet vetëm një ofertë e vlefshme, ajo vlerësohet sipas këtyre kriterëve dhe metodologjisë.

Pikët për secilin kriter përcaktohen nga institucioni përgjegjës, rast pas rasti, në përputhje me natyrën e procedurës. Oferta më e favorshme për secilin kriter vlerësohet me pikët maksimale, ndërsa ofertat e tjera vlerësohen, sipas formulës:

$$- Pof = (Oof / Omax) \times Pk$$

ku:

- **Pof** – pikët e ofertuesit;
- **Oof** – oferta e ofertuesit;
- **Omax** – oferta që ka marrë pikët maksimale për kriterin përkatës;
- **Pk** – pikët e përcaktuara për kriterin.

Shpallet fitues ofertuesi që, pas vlerësimit, renditet i pari sipas numrit të pikëve të grumbulluara,



në përputhje me VKM-në dhe dokumentet e procedurës.

9. Ofertuesit kanë të drejtë të paraqesin ankim pranë titullarit të institucionit, brenda afatit të përcaktuar në VKM. Ankimi paraqitet në rrugë shkresore dhe duhet të përmbajë të dhënat identifikuese të ankuesit, objektin e ankimit, shkaqet mbi të cilat mbështetet, si dhe dokumentacionin përkatës, nëse ka. Regjistrimi i ankimit pezullon vijimin e procedurës deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga titullari i institucionit.

10. Titullari i institucionit, brenda afatit të përcaktuar në VKM, ngre komisionin për shqyrtimin e ankimit. Komisioni shqyrton pretendimet e ankuesit, dokumentacionin e procedurës dhe çdo provë tjetër të administruar gjatë zhvillimit të saj, dhe i propozon titullarit të institucionit lënien në fuqi ose revokimin e vendimit të ankimuar.

11. Pas përfundimit të vlerësimit të ofertave dhe, kur është rasti, pas përfundimit të procedurës së ankimit, komisioni i dhënies me qira/enfiteozë, harton raportin përfundimtar të procedurës.

Raporti përfundimtar përmban:

- a) përmbledhjen e procedurës së zhvilluar;
- b) rezultatet e verifikimit dhe të vlerësimit të ofertave;
- c) klasifikimin përfundimtar të ofertuesve;
- ç) propozimin për shpalljen e fituesit.

12. Titullari i institucionit vendos për shpalljen e fituesit, në përputhje me propozimin e komisionit. Vendimi publikohet në seksionin e posaçëm të faqes zyrtare elektronike të institucionit.

13. Brenda afatit të përcaktuar në VKM, subjekti fitues depoziton pranë institucionit përgjegjës dokumentacionin në formë fizike, sipas kërkesave të dokumenteve të procedurës. Struktura përgjegjëse për lidhjen e kontratave, administron dokumentacionin e depozituar dhe verifikon përputhshmërinë e tij me dokumentacionin e paraqitur në rrugë elektronike gjatë procedurës së konkurrimit. Kur konstatohet se dokumentacioni i depozituar nuk përputhet me dokumentacionin e paraqitur elektronikisht ose nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e procedurës, institucioni vepron sipas përcaktimeve të VKM-së.

14. Krahas procedurës së konkurrimit, dhënia me qira ose enfiteozë e pasurisë shtetërore mund të realizohet edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë, vetëm në rastet e parashikuara shprehimisht në VKM. Në

rastet e dhënies me qira ose enfiteozë në mënyrë të drejtpërdrejtë nuk zbatohen fazat procedurale që lidhen me zhvillimin e konkurrimit, përveç kërkesave dhe verifikimeve që, sipas natyrës së tyre, janë të zbatueshme edhe për këtë procedurë. Procedura për dhënien me qira/ enfiteozë në mënyrë të drejtpërdrejtë zhvillohet në rrugë shkresore.

a) Procedura për dhënien me qira ose enfiteozë në mënyrë të drejtpërdrejtë fillon mbi bazën e kërkesës së paraqitur nga subjekti kërkuar ose institucioni i interesuar;

b) Struktura përgjegjëse për lidhjen e kontratave shqyrton kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur dhe verifikon përmbushjen e kushteve ligjore për vijimin e procedurës në mënyrë të drejtpërdrejtë;

c) Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit, struktura përgjegjëse harton një relacion të arsyetuar, i cili përmban, të paktën:

i. identifikimin e pasurisë shtetërore objekt të kërkesës;

ii. identifikimin e subjektit kërkuar dhe qëllimin e përdorimit të pasurisë;

iii. përshkrimin e rrethanave konkrete të rastit dhe argumentimin e përmbushjes së kushteve të përcaktuara në VKM, mbështetur në dokumentacionin provues;

iv. propozimin për vijimin e procedurës së dhënies me qira ose enfiteozë në mënyrë të drejtpërdrejtë, sipas kushteve të përcaktuara në VKM.

Relacioni i arsyetuar shoqërohet me të gjithë dokumentacionin që provon përmbushjen e kushteve ligjore për dhënien e pasurisë në mënyrë të drejtpërdrejtë;

ç) Në rast se plotësohen kushtet për dhënien me qira ose enfiteozë të pasurisë shtetërore në mënyrë të drejtpërdrejtë, titullari, mbi bazën e relacionit të arsyetuar dhe dokumentacionit shoqërues, urdhëron fillimin e procedurës së dhënies me qira ose enfiteozë në mënyrë të drejtpërdrejtë.

15. Procedura për zëvendësimin e një pasurie shtetërore të përfshirë në fondin e kompensimit fizik fillon me paraqitjen e një kërkesë nga çdo i interesuar, i cili shpreh interesin për marrjen me qira ose enfiteozë të pasurisë shtetërore dhe zhvillimin e saj nëpërmjet realizimit të investimeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

a) Kërkesa i përcillet strukturës përgjegjëse për lidhjen e kontratave në ministrinë përgjegjëse për



ekonominë, e cila verifikon statusin e pasurisë objekt kërkesë. Kur nga verifikimi rezulton se pasuria është pjesë e fondit të kompensimit fizik, struktura përgjegjëse për lidhjen e kontratave, nëpërmjet komunikimit zyrtar institucional me strukturën përgjegjëse për shitjen e pasurive shtetërore, kërkon konfirmimin nëse, për pasurinë objekt kërkesë, ka përfunduar procedurat e privatizimit dhe nuk është shitur. Në rast se konfirmohet se pasuria është pjesë e Fondit të Kompensimit Fizik, si dhe procedurat përkatëse lidhur me të kanë përfunduar dhe se pasuria nuk është shitur, tjetërsuar apo nuk është objekt i një procedure tjetër që pengon disponimin e saj, struktura përgjegjëse për lidhjen e kontratave vlerëson kërkesën e të interesuarit, natyrën dhe rëndësinë e investimit të propozuar, si dhe mundësinë e zhvillimit të pasurisë;

b) Kur, në bazë të vlerësimit të kryer, konstatohet se zhvillimi i pasurisë nëpërmjet investimit të propozuar është në interes të zhvillimit dhe përdorimit ekonomik të saj dhe se rasti përfshihet në kushtet e parashikuara në pikën 16, të kreut II, të VKM-së, struktura përgjegjëse për lidhjen e kontratave i përcjell strukturës përgjegjëse për administrimin e aseteve në ministrinë përgjegjëse për ekonominë praktikën e administruar, së bashku me kërkesën e të interesuarit, dokumentacionin e pasurisë, konfirmimet e marra dhe vlerësimin e kryer, me qëllim fillimin e procedurës për zëvendësimin e pasurisë me një pasuri tjetër shtetërore.

c) Struktura përgjegjëse për administrimin e aseteve në ministrinë përgjegjëse për ekonominë identifikon një pasuri tjetër shtetërore, me vlerë të njëjtë ose më të madhe, e cila propozohet për zëvendësimin e pasurisë së përfshirë në Fondin e Kompensimit Fizik;

ç) Për pasurinë e identifikuar për zëvendësim kryhen verifikimet e nevojshme, lidhur me statusin juridik, dokumentacionin, vlerën dhe mundësinë e përfshirjes së saj në Fondin e Kompensimit Fizik;

d) Struktura përgjegjëse për administrimin e aseteve kryen korrespondencën me strukturën përgjegjëse për përfshirjen dhe administrimin e pasurive në Fondin e Kompensimit Fizik, me qëllim konfirmimin e mundësisë së zëvendësimit të pasurisë dhe të përfshirjes së pasurisë së identifikuar në fond;

dh) Pas përfundimit të verifikimeve dhe marrjes së konfirmimeve përkatëse, struktura përgjegjëse për

administrimin e aseteve përgatit praktikën për zëvendësimin e pasurisë dhe ia paraqet titullarit të institucionit për miratim;

e) Pas miratimit të zëvendësimit, ministria përgjegjëse për ekonominë i kërkon institucionit përgjegjës për kthimin dhe kompensimin e pronave:

i. heqjen e pasurisë objekt kërkesë nga Fondi i Kompensimit Fizik, në përputhje me aktin me të cilin ajo është përfshirë në këtë fond;

ii. kthimin e dokumentacionit të pasurisë që do të jepet në përdorim;

iii. marrjen në administrim të dokumentacionit të pasurisë së identifikuar për zëvendësim, me qëllim përfshirjen e saj në Fondin e Kompensimit Fizik;

ë) Dokumentacioni i pasurisë së identifikuar për zëvendësim i përcillet institucionit përgjegjës për kthimin dhe kompensimin e pronave, me qëllim përfshirjen e saj në Fondin e Kompensimit Fizik;

f) Me përfundimin e procedurës së zëvendësimit dhe kthimin e dokumentacionit të pasurisë që do të jepet në përdorim, struktura përgjegjëse për lidhjen e kontratave vijon procedurën për dhënien në përdorim të pasurisë, në përputhje me përcaktimet e VKM-së.

16. Llogaritja e tarifës dysheme për pasuritë shtetërore që jepen me qira ose enfiteozë kryhet, si më poshtë:

a) Për ndërtesat

Tarifa dysheme mujore për metër katror është 0,3 për qind e vlerës mesatare të shitblerjes së banesave, të përcaktuar në aktin përkatës në fuqi për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, në bashkinë përkatëse ku ndodhet pasuria shtetërore, në momentin e dhënies së pasurisë me qira ose enfiteozë.

Shembull: Për një pasuri shtetërore të ndodhur në Bashkinë Tiranë, me sipërfaqe ndërtese 100 m², nëse vlera mesatare e shitblerjes së banesave për zonën kadastrale përkatëse në fuqi, është 124 316 lekë/m², tarifa dysheme mujore për metër katror ndërtesë llogaritet:

$$124\,316 \times 0,3\% = 372,95 \text{ lekë/m}^2.$$

Vlera dysheme e detyrimit mujor për ndërtesën është:

$$100 \text{ m}^2 \times 372,95 = 37\,295 \text{ lekë/muaj.}$$

b) Ndërtesë + sipërfaqe funksionale

Tarifa dysheme mujore për sipërfaqen funksionale është 20 për qind e tarifës dysheme të përcaktuar për ndërtesën. Për një pasuri me



ndërtesë 100 m² dhe sipërfaqe funksionale 200 m², tarifa dysheme për sipërfaqen funksionale është:

$$372,95 \times 20\% = 74,59 \text{ lekë/m}^2.$$

Vlera dysheme e detyrimit mujor për sipërfaqen funksionale është:

$$200 \text{ m}^2 \times 74,59 = 14\,918 \text{ lekë/muaj.}$$

Në këtë rast, vlera dysheme e detyrimit të përgjithshëm mujor është:

$$37\,295 + 14\,918 = 52\,213 \text{ lekë/muaj.}$$

Trualli nën ndërtesë (objekti) përfshihet në tarifën e qirasë së ndërtesës.

c) Për ndërtesat me dy ose më shumë kate

Kur ndërtesa ka dy ose më shumë kate, për efekt të llogaritjes së detyrimit mujor merret në konsideratë sipërfaqja e çdo kati.

Për shembull, për një ndërtesë me dy kate, ku kati i parë ka sipërfaqe 100 m² dhe kati i dytë 80 m², sipërfaqja totale e ndërtesës që merret në konsideratë për llogaritjen e detyrimit është:

$$100 \text{ m}^2 + 80 \text{ m}^2 = 180 \text{ m}^2.$$

Nëse tarifa dysheme është 372,95 lekë/m²/muaj, vlera dysheme e detyrimit mujor për ndërtesën është:

$$180 \text{ m}^2 \times 372,95 = 67\,131 \text{ lekë/muaj.}$$

ç) Për tunelet dhe vendstrehimet

Për tunelet dhe vendstrehimet, tarifa dysheme mujore për metër katror llogaritet duke pjesëtuar me 5 tarifën dysheme të përcaktuar për ndërtesat, në bashkinë përkatëse ku ndodhet pasuria shtetërore.

Shembull: Nëse tarifa dysheme për ndërtesën është 372,95 lekë/m²/muaj, tarifa dysheme për tunelin ose vendstrehimin është:

$$372,95 : 5 = 74,59 \text{ lekë/m}^2.$$

Për një tunel ose vendstrehim me sipërfaqe 100 m², vlera dysheme e detyrimit mujor është:

$$100 \text{ m}^2 \times 74,59 = 7\,459 \text{ lekë/muaj.}$$

d) Për truallin e lirë

Kur pasuria shtetërore që jepet me qira ose enfiteozë është truall i lirë, tarifa dysheme përcaktohet sipas tarifave të parashikuara në aneksin C, pjesë përbërëse të VKM-së, sipas bashkisë dhe qarkut përkatës.

Shembull: Për një pasuri shtetërore, të llojit truall i lirë, me vendndodhje në Bashkinë Tiranë, me sipërfaqe 100 m², tarifa dysheme mujore për metër katror, llogaritet:

$$100 \text{ m}^2 \times 121 \text{ lekë/m}^2 = 12\,100 \text{ lekë/muaj.}$$

dh) Për sipërfaqet e truallit, funksionale ose të lira, që jepen me qira ose enfiteozë për qëllime të ndërtimit të terminaleve të mjeteve të transportit,

tarifa dysheme përcaktohet në masën 20 (njëzet) lekë/m², e cila zbatohet në mënyrë të njëjtë, pavarësisht nga vendndodhja e sipërfaqes.

e) Për tokat inproduktive

Për tokat inproduktive, tarifatat dysheme janë të njëjta me ato të përcaktuara për tokat bujqësore sipas legjislacionit në fuqi. Klasifikimi i pasurisë si tokë inproduktive, verifikohet paraprakisht nëpërmjet konfirmimit të institucionit përgjegjës.

Shënim. Vlerat e përdorura në shembujt e mësipërm janë ilustruese. Për truallin e lirë, zbatohen vlerat e aneksit C, pjesë përbërëse e VKM-së në fuqi, në momentin e dhënies me qira/enfiteozë të pasurisë shtetërore. Për ndërtesat, përdoret vlera mesatare e shitblerjes së banesave të përcaktuar në aktin përkatës për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave në fuqi, në momentin e dhënies së pasurisë me qira ose enfiteozë.

17. Ndryshimi i treguesve dhe afateve të planit të biznesit

a) Qiramarrësi/enfiteozëmarrësi, mund të paraqesë pranë qiradhënësit/enfiteozëdhënësit kërkesë për ndryshimin e treguesve dhe afateve të planbiznesit kur provon pamundësinë ose vështirësinë për realizimin e treguesve dhe afateve, sipas planbiznesit të miratuar në kontratën ekzistuese. Kërkesa shoqërohet me dokumentacionin provues dhe planbiznesin e ndryshuar;

b) Qiradhënësi/enfiteozëdhënësi shqyrton kërkesën dhe vlerëson në mënyrë të veçantë ekzistencën dhe natyrën e rrethanës së justifikueshme për pamundësinë e realizimit të treguesve dhe afateve sipas planbiznesit të miratuar në kontratë;

c) Për qëllime të zbatimit të këtij udhëzimi, konsiderohen raste të justifikueshme, rrethanat objektive, të dokumentuara dhe të paparashikueshme në momentin e paraqitjes së ofertës, të cilat nuk varen nga vullneti i qiramarrësit/enfiteozëmarrësit dhe që kanë ndikuar drejtpërdrejt në zbatimin e planit të biznesit, duke përfshirë:

i. rastet e forcës madhore dhe rrethanat e jashtëzakonshme;

ii. vonesat në pajisjen me leje, licenca, autorizime apo dokumente të tjera nga autoritetet publike, kur këto vonesa nuk janë shkaktuar nga qiramarrësi/enfiteozëmarrësi;

iii. evidentimin, pas lidhjes së kontratës, të kushteve teknike, fizike, gjeologjike, infrastrukturore apo të tjera të



pronës, të paparashikuara në momentin e ofertimit, të cilat ndikojnë në realizimin e investimit ose të veprimtarisë;

iv. ndryshimet në legjislacion, dokumentet e planifikimit, kërkesat urbanistike, mjedisore, teknike apo standardet e detyrueshme, të cilat ndikojnë në realizimin e planit të biznesit;

v. ndryshimet e kërkuara nga autoritetet kompetente në projektin teknik, projektin e zbatimit ose dokumentacionin përkatës, kur këto ndryshime ndikojnë në treguesit ose afatet e planit të biznesit;

vi. rrethana të tjera objektive, të jashtëzakonshme dhe të dokumentuara, të cilat e bëjnë objektivisht të pamundur ose dukshëm më të vështirë përmbushjen e treguesve apo afateve fillestare;

ç) Tregues të planit të biznesit, për qëllime të zbatimit të këtij udhëzimi, konsiderohen, sipas natyrës së aktivitetit dhe përmbajtjes së planit të biznesit:

i. vlera dhe fazat e investimit;

ii. vlera e investimit për çdo periudhë ose fazë të zbatimit;

iii. numri i vendeve të punës që parashikohet të krijohen;

iv. afatet për realizimin e investimit dhe vënien në funksion të aktivitetit;

v. kapacitetet prodhuese, përpunuese, shërbyese ose të tjera të aktivitetit;

vi. sipërfaqet ose pjesë pasurie që do të vihen në funksion të aktivitetit, kur këto përbëjnë tregues të planit të biznesit;

vii. të ardhurat ose tregues të tjerë ekonomikë të parashikuar në planin e biznesit, kur këta janë përcaktuar si detyrime ose objektiva në ofertë;

viii. çdo tregues tjetër konkret dhe i matshëm, i përcaktuar në planin e biznesit dhe të pranuar si pjesë e ofertës fituese;

d) Rishikimi mund të konsistojë në ndryshimin e vlerës së një treguesi, shpërndarjen e tij në periudha të ndryshme ose shtyrjen e afatit të realizimit, vetëm në masën që është e nevojshme për të përballuar rrethanën që ka shkaktuar pamundësinë ose vështirësinë në zbatimin e planit të biznesit. Rishikim lejohet vetëm kur plotësohen njëkohësisht kushtet e parashikuara në pikën 3, të kreut IV, të VKM-së. Në këtë rast, miratimi i ndryshimit të planbiznesit bëhet me marrëveshje me shkrim ndërmjet palëve. Marrëveshja shoqërohet me planin e biznesit të ndryshuar dhe kur ndryshimi prek përmbajtjen e kontratës, me ndryshimet përkatëse në kontratë.

18. Kontratat e qirasë të lidhura para hyrjes në fuqi të VKM-së, në të cilat ushtrohet veprimtari

prodhuese me regjim “Fason”, mund të amendohen duke kaluar në kontratë me tarifën simbolike 1 euro/kontrata, me kërkesë të qiramarrësit dhe pas verifikimit të përmbushjes së kushteve të përcaktuara në këtë udhëzim. Për amendimin e kontratës, qiramarrësi paraqet pranë qiradhënësit kërkesën, së bashku me dokumentacionin që provon përmbushjen e kushteve ligjore, të paktën:

a) kontratën e qirasë të lidhur para hyrjes në fuqi të VKM-së;

b) dokumentacionin që provon ushtrimin e veprimtarisë prodhuese me regjim “Fason”;

c) dokumentacionin që provon realizimin e investimit dhe nivelin e punësimit në objektin e marrë me qira, sipas parashikimeve të kreut V, të VKM-së;

ç) aktin e monitorimit të përbashkët, nga i cili rezulton se qiramarrësi ka respektuar kushtet dhe detyrimet e përcaktuara në kontratën e qirasë.

18.1 Kur nga verifikimi rezulton se plotësohen kushtet për kalimin e kontratës me tarifë 1 (një) euro, kontrata amendohet ndërmjet palëve.

KREU III

KONTRATAT ME TARIFËN 1 EURO/KONTRATA

1. Për kontratat me tarifë simbolike 1 euro/kontrata, pagesa e garancisë së kontratës bëhet sipas faturës së lëshuar nga qiradhënësi dhe kushtet e kthimit të saj, janë pjesë e negociatës së kontratës. Në çdo rast, qiramarrësi/enfiteozëmarrësi i paraqet qiradhënësit/enfiteozëdhënësit, kërkesë të shoqëruar me dokumentacionin:

a) Raport i audituesit ligjor dhe ekspertit për vlerësimin e pasurive të paluajtshme, për investimet e realizuara nga qiramarrësi/enfiteozëmarrësi në objektin e marrë me qira dhe të paraqitura në bilanci financiar të asaj shoqërie;

b) Bilancin financiar të shoqërisë qiramarrëse/enfiteozëmarrëse për vitin përkatës;

c) Aktmonitorimi i përbashkët.

Qiradhënësi/enfiteozëdhënësi cakton ekspertët e licencuar për verifikimin e vlerave të investimeve, për periudhën nga lidhja e kontratës deri në vitin e fundit ushtrimor. Kur vlera e investimeve është në nivelin e shprehur në kontratë, qiradhënësi/enfiteozëdhënësi miraton kthimin e garancisë së ngurtësuar. Shpenzimet për caktimin e ekspertëve



do t'i ngarkohen subjektit qiramarrës/enfiteozëmarrës.

2. Kur garancia e kontratës është siguruar nëpërmjet një kompanie sigurimi, në rast të mosrealizimit të nivelit të investimit, qiradhënësi/enfiteozëdhënësi ushtron të drejtat që rrjedhin nga kontrata e sigurimit, në përputhje me kushtet e saj.

3. Në kontratat me tarifë 1 euro/kontrata vendosen sanksione kur subjekti qiramarrës/enfiteozëmarrës, nuk zbaton kushtet e kontratës së qirasë/enfiteozës sipas parashikimeve të VKM-së.

a) Për mosrealizimin e vlerës së investimit të parashikuar në kontratë, subjekti qiramarrës/enfiteozëmarrës penalizohet me 10 për qind të vlerës së investimit të përcaktuar. Ky sanksion vendoset pas paraqitjes së pasqyrave financiare vjetore, të certifikuara nga eksperti kontabël i miratuar:

i. në rast se subjekti qiramarrës/enfiteozëmarrës nuk paraqet, brenda afatit të përcaktuar nga qiradhënësi/enfiteozëdhënësi, pasqyrat financiare vjetore të certifikuara nga eksperti kontabël i miratuar, qiradhënësi/enfiteozëdhënësi i kërkon subjektit paraqitjen e tyre brenda një afati shtesë;

ii. në përfundim të afatit shtesë, në mungesë të dokumentacionit të kërkuar dhe, nga dokumentacioni dhe të dhënat e tjera të disponueshme, rezulton mosrealizimi i investimit të parashikuar në kontratë, qiradhënësi/enfiteozëdhënësi procedon me vendosjen e penalitetit;

b) Për çdo vend pune të përcaktuar, të llogaritur mbi bazën e mesatares vjetore të vendeve të punës të parashikuara në kontratë, subjekti qiramarrës/enfiteozëmarrës penalizohet me 50,000 (pesëdhjetë mijë) lekë:

i. për verifikimin e vendeve të punës të realizuara nga subjekti qiramarrës/enfiteozëmarrës, merret në konsideratë numri mesatar vjetor i punonjësve, i pasqyruar në vërtetimin përkatës të lëshuar nga institucioni përgjegjës për tatimet.

4. Kur qiramarrësi ose enfiteozëmarrësi deklaron vende pune të realizuara nëpërmjet nënkontraktorëve, struktura përgjegjëse për monitorimin e kontratave, verifikon ekzistencën e marrëdhënies kontraktore dhe lidhjen e veprimtarisë së nënkontraktorit me objektin e kontratës. Për efekt të verifikimit, qiramarrësi ose enfiteozëmarrësi depoziton:

a) kontratën e nënkontraktimit ose dokumentin që provon marrëdhënien juridike me nënkontraktorin;

b) dokumentacionin që provon se veprimtaria e nënkontraktorit ushtrohet në funksion të realizimit të objektit të kontratës;

c) dokumentacionin që provon numrin e vendeve të punës të krijuara nga nënkontraktori në kuadër të zbatimit të kontratës.

Vendet e punës të krijuara nga nënkontraktori merren në konsideratë vetëm kur provohet se janë krijuar për realizimin e objektit të kontratës.

5. Në rastet e parashikuara në pikën 6, të kreut V, të VKM-së, qiramarrësi ose enfiteozëmarrësi, i cili pretendon se ka përmbushur kushtet e përcaktuara në pikat 2 ose 3, të kreut V, të VKM-së, paraqet kërkesë pranë qiradhënësit ose enfiteozëdhënësit, të shoqëruar me dokumentacionin që provon realizimin e investimeve dhe përmbushjen e detyrimeve kontraktore.

a) Qiradhënësi ose enfiteozëdhënësi shqyrton kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur, verifikon përmbushjen e kushteve të përcaktuara në pikat 2 ose 3, të kreut V, të VKM-së dhe, kur konstaton se ato janë përmbushur, i propozon ministrisë përgjegjëse për ekonominë kalimin e kontratës në kontratë me tarifë simbolike 1 (një) euro, duke i përcjellë dokumentacionin përkatës.

Propozimi shoqërohet, të paktën, me:

i. propozimin e qiradhënësit/enfiteozëdhënësit;

ii. vendimin e këshillit bashkiak për miratimin e kalimit të kontratës së qirasë në tarifë simbolike 1 euro/kontrata, kur kontrata e qirasë/enfiteozës është lidhur nga njësitë e vetëqeverisjes vendore;

iii. pasqyrat financiare të vitit të fundit ushtrimor, të certifikuara nga eksperti kontabël i miratuar, të shoqëruara me raportin e audituesit ligjor mbi investimet e realizuara në pasurinë shtetërore;

iv. aktmonitorimet e mbajtura;

v. çdo dokument tjetër që provon përmbushjen e kushteve të përcaktuara në pikën 6, të kreut V, të VKM-së;

b) Ministria përgjegjëse për ekonominë shqyrton propozimin dhe dokumentacionin e përcjellë nga qiradhënësi ose enfiteozëdhënësi dhe, kur vlerëson se dokumentacioni është i plotë, përgatit propozimin përkatës për në Këshillin e Ministrave. Në çdo rast, pas miratimit të vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave, institucioni që ka lidhur kontratën e qirasë ose të enfiteozës ngarkohet me



ndjekjen e procedurës për amendimin e kontratës ekzistuese.

KREU IV MONITORIMI I KONTRATAVE

1. Njësia përgjegjëse për monitorimin e kontratës së qirasë ose të enfiteozës ushtron monitorimin e zbatimit të kontratës dhe për këtë qëllim, kryen këto detyra:

a) pas lidhjes së kontratës, dorëzon pasurinë objekt kontrate me procesverbal, sipas genplanit /planrilevimit përkatës;

b) monitoron përdorimin e pasurisë në përputhje me qëllimin e përcaktuar në kontratë dhe respektimin e të gjitha detyrimeve kontraktore nga qiramarrësi ose enfiteozëmarrësi;

c) verifikon përmbushjen e detyrimeve financiare, përfshirë pagesën e qirasë, përlllogaritjen e kamatëvonesave dhe penaliteteve, si dhe ndjek arkëtimin e tyre sipas legjislacionit në fuqi;

ç) monitoron realizimin e investimeve dhe nivelin e punësimit të marrë përsipër në kontratë, nëpërmjet akteve të rakordimit dhe verifikimeve periodike, duke dokumentuar rezultatet dhe duke informuar institucionin që ka lidhur kontratën;

d) harton, të paktën një herë në 6 (gjashtë) muaj, akt monitorimet e përbashkëta mbi zbatimin e kontratës dhe ia përcjell institucionit që ka lidhur kontratën;

dh) evidenton problematikat e konstatuara gjatë zbatimit të kontratës dhe i propozon institucionit që ka lidhur kontratën masat e nevojshme për zgjidhjen e tyre;

e) në përfundim ose zgjidhje të kontratës, merr në dorëzim pasurinë me procesverbal;

ë) kur autorizohet nga titullari i institucionit që ka lidhur kontratën, përfaqëson institucionin në veprimet procedurale ose gjyqësore që lidhen me zbatimin e kontratës;

2. Për përfitimin e zbritjes së detyrimit mujor të qirasë/enfiteozës, qiramarrësi ose enfiteozëmarrësi i paraqet qiradhënësit ose enfiteozëdhënësit, kërkesë të shoqëruar me dokumentacionin:

a) Raport i audituesit ligjor për investimet e kryera, në objektin e marrë me qira nga data e marrjes në dorëzim të objektit deri në vitin e fundit ushtrimor të miratuar;

b) Pasqyrat financiare shoqëruar me raport audituesi ligjor për vitin përkatës;

c) Aktmonitorimi i përbashkët me njësinë monitoruese, lidhur me respektimin e kushteve kontraktuale.

2.1 Qiradhënësi ose enfiteozëdhënësi pasi shqyrton kërkesën, urdhëron emërimin e grupit të ekspertëve, të përbërë, nga auditues ligjor dhe ekspert për vlerësimin e pasurive të paluajtshme, për verifikimin e vlerave të investimeve, që qiramarrësi ose enfiteozëmarrësi ka kryer në pasurinë e marrë me qira, për periudhën nga lidhja e kontratës deri në vitin e fundit ushtrimor. Kur vlera e investimeve është në nivelin e shprehur në vendim, qiradhënësi ose enfiteozëdhënësi miraton zbritjen e detyrimit mujor të qirasë, për periudhën në vijim. Shpenzimet për caktimin e ekspertëve përkatës i ngarkohen qiramarrësit/enfiteozëmarrësit.

3. Qiramarrësi/enfiteozëmarrësi ka të drejtë të ankimojë gjobat ose penalitetet e vendosura në zbatim të kontratës së qirasë/enfiteozës. Ankimi paraqitet pranë institucionit që ka lidhur kontratën. Për shqyrtimin e ankimit, titullari i institucionit urdhëron ngritjen e një grupi pune, të ndryshëm nga struktura përgjegjëse që ka vendosur gjobën ose penalitetin objekt ankimi. Grupi i punës shqyrton pretendimet e ankuesit, administron dhe verifikon dokumentacionin përkatës, kryen dhe përgatit një relacion të arsyetuar, i cili i paraqitet titullarit të institucionit për vendimarrje.

Mbi bazën e dokumentacionit të administruar dhe relacionit të arsyetuar, titullari i institucionit merr vendim brenda afatit të përcaktuar në pikën 4, të kreut VI, të VKM-së, për:

a) lënien në fuqi të gjobës ose penalitetit dhe rrëzimin e ankimit;

b) shfuqizimin ose revokimin e gjobës ose penalitetit;

c) ndryshimin e aktit, duke pranuar pjesërisht ankimin.

4. Për rastet kur subjekti kontraktues ka bashkuar disa kontrata në një të vetme, mbështetur në pikën 6, kreu VI, të VKM-së, në analogji me afatin e hyrjes në fuqi të kontratës bëhet edhe përlllogaritja e kohës së konsumimit të saj, që është data e hyrjes në fuqi të kontratës së parë.

5. Procedura për shqyrtimin e kërkesës për shembjen e objekteve ose ndërtimeve ekzistuese:

a) Qiramarrësi ose enfiteozëmarrësi paraqet kërkesë pranë ministrisë përgjegjëse për ekonominë për shembjen e objekteve ose ndërtimeve ekzistuese, duke bashkëlidhur:



i. kontratën e qirasë ose të enfiteozës;
ii. planbiznesin, në të cilin parashikohet shembja e objekteve ose ndërtimeve;

iii. procesverbalin e marrjes në dorëzim të objektit të kontratës;

b) Ministria përgjegjëse për ekonominë administron kërkesën dhe kërkon mendim nga institucioni që ka në përgjegjësi administrimi pasurinë shtetërore mbi kërkesën e paraqitur;

c) Në mbështetje të dokumentacionit të paraqitur nga qiramarrësi/enfiteozëmarrësi dhe mendimit të institucionit që ka në përgjegjësi administrimi pasurinë shtetërore, ministri përgjegjës për ekonominë urdhëron emërimin e ekspertit kontabël të miratuar/audituesit ligjor dhe, kur vlerësohet nevojshme dhe ekspertin vlerësues të pasurive të paluajtshme, rast pas rasti;

c) Eksperti kontabël i miratuar/audituesi ligjor dhe sipas rastit, eksperti vlerësues i pasurive të paluajtshme hartojnë raportin dhe ia paraqesin ministrisë përgjegjëse për ekonominë brenda afatit të përcaktuar në urdhrin e emërimit;

d) Në mbështetje të raportit të ekspertimit, ministri përgjegjës për ekonominë, me akt administrativ individual, autorizon kryerjen e pagesës së vlerës kontabël të përcaktuar në raport. Struktura përgjegjëse për buxhetin dhe menaxhimin financiar, kryen procedurat për kryerjen e pagesës së vlerës kontabël nga qiramarrësi ose enfiteozëmarrësi në llogarinë e ministrisë përgjegjëse për ekonominë, në përputhje me përcaktimet e VKM-së.

KREU V

HYRJA NË PROCEDURË PRIVATIZIMI ME TË DREJTË PARABLERJE

1. Qiramarrësi ose enfiteozëmarrësi, që pretendon përmbushjen e kushteve të përcaktuara në kreun VIII, të VKM-së, paraqet kërkesë pranë ministrisë përgjegjëse për ekonominë ose institucionit që monitoron kontratën, sipas përcaktimeve në VKM. Kërkesa shoqërohet me:

a) raportin e vlerësimit nga ekspertë të fushës, me përbërje ekspert vlerësues së pasurisë së paluajtshme dhe audituesit ligjor të pavarur;

b) dokumentacionin teknik dhe financiar që provon realizimin e investimit, në përputhje me qëllimin për të cilin është lidhur kontrata;

c) aktmonitorimet e përbashkëta midis njësisë monitoruese dhe qiramarrësit/enfiteozëmarrësit.

2. Struktura përgjegjëse për monitorimin e kontratave administron kërkesën dhe verifikon:

a) përputhshmërinë e investimit me qëllimin e kontratës;

b) realizimin e nivelit të investimit;

c) respektimin e detyrimeve kontraktore;

ç) përmbushjen e kushteve të tjera të përcaktuara në VKM.

Kur dokumentacioni nuk rezulton i plotë, subjekti njoftohet me shkrim për plotësimin ose saktësimin e tij brenda afatit të përcaktuar. Shqyrtimi i kërkesës vijon vetëm pas administrimit të dokumentacionit të plotë. Për verifikimin e nivelit të investimit, struktura përgjegjëse për monitorimin e kontratave krahason raportin e vlerësimit të investimeve, duke krahasuar vlerën e truallit të përcaktuar në hartën e vlerës së truallit, sipas legjislacionit në fuqi, me vlerën e investimeve të kryera në objekt.

3. Në rast se rezulton se janë përmbushur kriteret për të hyrë në procedurë privatizimi, me të drejtë parablerje, struktura përgjegjëse për monitorimin e kontratave i paraqet titullarit të institucionit propozimin për njoftimin e qiramarrësit/enfiteozëmarrësit, mbi lindjen e të drejtës reale.

4. Kur kontrata e qirasë ose e enfiteozës është lidhur nga një institucion i qeverisjes qendrore ose nga një organ i njësisë së vetëqeverisjes vendore, institucioni monitorues, pas konfirmimit të përmbushjes së kushteve, përcjell dokumentacionin pranë strukturës përgjegjëse për privatizimin e pronës shtetërore, në përputhje me përcaktimet e VKM-së.

KREU VI

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Njësitë monitoruese të kontratave të qirasë/enfiteozës dhe struktura përgjegjëse në ministrinë përgjegjëse për ekonominë, në raportimin e të dhënave, mbi monitorimin e kontratave të qirasë/enfiteozës me sipërfaqe mbi 200 m² dhe nën 200 m², do t'i përmbahen formatit të miratuar me anë të këtij udhëzimi.

2. Formatet mbi monitorimin e kontratave të qirasë/enfiteozës me sipërfaqe mbi 200 m² dhe nën 200 m² janë pjesë integrale e këtij udhëzimi.

3. Udhëzimi nr. 13, datë 26.4.2018, "Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 54, datë



5.2.2014, ‘Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore’, shfuqizohet.

4. Ngarkohen ministria përgjegjëse për ekonominë, ministrinë e linjës, institucionet qendrore e shtetërore, ndërmarrjet dhe shoqëritë shtetërore, si dhe organi i njëjësive të vetëqeverisjes

vendore, secili në përputhje me përgjegjësitë e tyre sipas VKM-së, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I EKONOMISË DHE
INOACIONIT
Delina Ibrahimaj

Pasqyra për derdhjen e detyrimit të qirasë/enfiteozës nga qiramarrësi/enfiteozëmarrësi për vitin _____

Njësia Monitoruese:

Qëllimi i dhënies me qira/enfiteozë të objektit:

Sipërfaqe e përgjithshme:

Afati i kontratës:

Data e lidhjes së kontratës:

Data e marrjes në dorëzim:

Detyrimi mujor:

Periodha	Ditë vonesë	Kamatëvonesa (%/ditë)	Detyrimi (lekë)	Data e pagesës	Pagesa e detyrimit (lekë)	Kamatëvonesa e paguar (lekë)	Likuidimi gjithsej (lekë)	Diferenca e detyrimit (lekë)	Diferenca e kamatëvonesës (lekë)	Shënime
Garancia e kontratës										E ngurtësuar deri në përfundim të kontratës
Çelje nga periodha/viti i mëparshëm										
Detyrimi i qirasë/enfiteozës për muajin janar										
Detyrimi i qirasë/enfiteozës për muajin shkurt										
Detyrimi i qirasë/enfiteozës për muajin mars										
Detyrimi i qirasë/enfiteozës për muajin prill										
Detyrimi i qirasë/enfiteozës për muajin maj										
Detyrimi i qirasë/enfiteozës për muajin qershor										
Detyrimi i qirasë/enfiteozës për muajin korrik										
Detyrimi i qirasë/enfiteozës për muajin gusht										
Detyrimi i qirasë/enfiteozës për muajin shtator										
Detyrimi i qirasë/enfiteozës për muajin tetor										
Detyrimi i qirasë/enfiteozës për muajin nëntor										
Detyrimi i qirasë/enfiteozës për muajin dhjetor										
SHUMA										

Shpërndarja e të ardhurave:

Për subjektin qiramarrës/enfiteozëmarrës

Për njësinë monitoruese



OBJEKTE SHETETËRORE TË DHËNA ME QIRA/ENFITEOZË
(Raport përmblendhës)

Nr.	Qiradhënësi/ Enfiteozdhënësi	Qiramarrësi/ Enfiteozëmarrësi	Nr. dhe data e kontratës	Qëllimi i kontratës	Sipërfaqja (m ²)	Investimi planifikuar / realizuar (lekë)	Punësimi planifikuar / realizuar	Qiraja/Enfiteo za detyrim / pagesë (lekë)	Faza e realizimit / afati	Ecuria në tremujor (%)	Shënime / problematika
I	Kontrata me sipërfaqe deri në 200 m ²										
1											
2											
3											
4											
5											
6											
II	Kontrata me sipërfaqe mbi 200 m ²										
1											
2											
3											
4											
5											
	PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME										

Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit _____

UDHËZIM
Nr. 7, datë 1.9.2026

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË UDHËZIMIN NR. 5222, DATË
26.6.2015, “PËR ZBATIMIN E VENDIMIT
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 926,
DATË 29.12.2014, PËR KRITERET E
VLERËSIMIT TË PRONËS
SHETETËRORE QË PRIVATIZOHET APO
TRANSFORMOHET DHE
PROCEDURËN E SHITJES’,
TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të pikës 14, kreu IV, të vendimit nr. 926, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe për procedurën e shitjes”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

I. Në udhëzimin nr. 5222, datë 26.6.2015, “Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014, Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes’, të ndryshuar”, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë vijojnë:

1. Kudo në këtë udhëzim, togfjalëshi “...pronë publike...” zëvendësohet me togfjalëshin “...pronë shtetërore...”.

2. Kudo në këtë udhëzim, fjala “...genplan...” zëvendësohet me togfjalëshin “...genplan/plan rilevimi...”.

3. Kudo në këtë udhëzim, togfjalëshi “...Dega e shoqërive publike...” zëvendësohet me togfjalëshin “...struktura përgjegjëse për privatizim...”.

4. Kudo në këtë udhëzim, pas fjalës “qira/qirasë”, shtohet fjala “enfiteozë/enfiteozës”.

5. Pika 1 e udhëzimit, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Në zbatim të pikës 1, kreu I, të VKM-së nr. 926, datë 29.12. 2014, të ndryshuar, këtij udhëzimi i nënshtrohen të gjitha pronat e paluajtshme shtetërore dhe pasuritë e luajtshme, objektet e veçanta, mjetet kryesore dhe mjetet e xhiros të ndërmarrjeve shtetërore dhe asetet e shoqërive tregtare të zbritura nga kapitali i tyre, të cilat plotësojnë kriteret për privatizim, sipas këtij vendimi. Të gjitha aktet nënligjore dhe administrative, për miratimin e privatizimeve dhe komisioneve përkatëse të vlerësimit, të nxjerra përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, do të konsiderohen të vlefshme për sa kohë nuk ka një urdhër të ministrit përgjegjës për ekonominë për shfuqizimin e tyre.”.

6. Pika 2 e udhëzimit, ndryshohet si më poshtë vijon:



“Në zbatim të pikës 2, kreu I, të VKM-së nr. 926, datë 29.12.2014, të ndryshuar, institucionet qendrore dhe organet e njësive të vetëqeverisjes vendore dërgojnë kërkesat e tyre për privatizimin e pronave shtetërore që kanë në administrim ose në pronësi në ministrinë përgjegjëse për ekonominë. Ministri përgjegjës për ekonominë nxjerr urdhrin për fillimin e procedurave të privatizimit, sipas kërkesave të përmendura më sipër. Në rast se ministria përgjegjëse për ekonominë u kërkon institucioneve qendrore apo organeve të njësive të vetëqeverisjes vendore kërkesën për prononcim privatizimi për pronat e paluajtshme shtetërore që kanë në administrim ose në pronësi, këto institucione janë të detyruara që, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës, të dërgojnë mendimin e tyre për privatizimin e këtyre pasurive. Nëse institucionet qendrore apo organet e njësive të vetëqeverisjes vendore shprehen për mosprivatizimin e pronave shtetërore në administrim apo në pronësi, apo pronave shtetërore të institucioneve që kanë në varësi administrative, atëherë ato duhet ta argumentojnë qartë këtë fakt. Në rastet kur për objektet, që janë në pronësi të organeve të pushtetit vendor, është marrë vendimi i këshillit të njësive të qeverisjes vendore për privatizimin/tjetërsimin e tyre dhe këto objekte janë miratuar për t’u përfshirë në procedurë privatizimi, pas nxjerrjes së urdhrin të privatizimit nga ministri përgjegjës për ekonominë, struktura përgjegjëse për privatizimin njofton institucionin administrues/pronar të pronës shtetërore për fillimin e procedurave të privatizimit, me qëllim afishimin e njoftimit përkatës në ambientet e pronës shtetërore, për efekt njohjeje nga ish-pronarët.”

7. Pika 3 e udhëzimit, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Në zbatim të pikës 3, kreu I, të VKM-së nr. 926, datë 29.12.2014, të ndryshuar, Komisioni i vlerësimit të pronës shtetërore, në zbatim të këtij vendimi ngrihet nga ministri përgjegjës për ekonominë. Ky komision ka në përbërje të tij 3 (tre) anëtarë: përfaqësuesin e strukturës përgjegjëse për privatizim, një ekspert vlerësues të licencuar dhe një përfaqësues të ndërmarrjes apo institucionit në administrim/pronësi të të cilit ndodhet prona shtetërore. Komisioni kryesohet nga përfaqësuesi i strukturës përgjegjëse për privatizim. Sipas nevojave të procesit të vlerësimit të pronës shtetërore, ministri përgjegjës për ekonominë urdhëron që në

komisionin e vlerësimit të marrë pjesë edhe një auditues apo ekspert të tjerë të licencuar sipas procesit të vlerësimit.”

8. Pika 4 e udhëzimit, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Në zbatim të pikave 2, 3 dhe 4, të kreut II, të VKM-së nr. 926, datë 29.12.2014, të ndryshuar, Komisioni i vlerësimit inspekton dhe verifikon gjendjen reale të objektit dhe më pas eksperti/ekspertët vlerësues i/të licencuar i/të pasurisë së paluajtshme të këtij komisioni, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve përgatitin në 5 (pesë) kopje origjinale genplani/plan rievimi, i cili/të cilët mban/mbajnë përgjegjësi ligjore për hartimin e genplanit/planit të rievimit dhe për saktësinë e matjeve teknike të kryera. Genplani/plan rievimi i përgatitur ku përcaktohet qartë truallin nën objekt, truallin funksional dhe sipërfaqja e përgjithshme, i dorëzohet menjëherë nga eksperti, përfaqësuesit të strukturës përgjegjëse për privatizim. Nëse, pas hartimit të genplanit/plan rievimit nga eksperti/ekspertët vlerësues, rezultojnë sipërfaqe truall të lira (më shumë se sipërfaqja nën objekt dhe ajo funksionale), institucioni administrues, në zbatim të procedurave ligjore përkatëse, ia kalon ato Agjencisë së Trajtimit të Pronave, për përdorimin për fond kompensimi për ish-pronarët ose për kthim fizik.”

9. Pika 5 e udhëzimit, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Në zbatim të pikës 4, të kreut I, të VKM-së nr. 926, datë 29.12.2014, të ndryshuar, ekspertët vlerësues në përbërje të komisionit të vlerësimit të pronës shtetërore përzgjidhen nga ministri përgjegjës për ekonominë nga lista e ekspertëve të licencuar për vlerësimin e pasurive të paluajtshme, sipas fushës së vlerësimit dhe licencës përkatëse. Paga e ekspertit/ekspertëve vlerësues, si edhe çdo shpenzim për përgatitjen e dokumentacionit të vlerësimit përballohen nga ministria përgjegjëse për ekonominë.

Paga e ekspertëve përcaktohet, si më poshtë:

a) 5% e vlerës së objektit të vlerësuar deri në 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë, por jo më pak se 100 000 (njëqind mijë) lekë pa TVSH;

b) 4% e vlerës së objektit të vlerësuar për vlera mbi 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë, por jo më pak se 500 000 (pesëqind mijë) lekë dhe jo më shumë se 1 000 000 (një milion) lekë, pa TVSH.



Pagesa kryhet pas dorëzimit të raportit përfundimtar të vlerësimit dhe pranimit të tij nga struktura përgjegjëse për privatizimin. Në rast se raporti nuk pranohet për shkak të mangësive, struktura përgjegjëse njofton me shkrim ekspertin vlerësues, duke specifikuar arsyet e mospranimit dhe korrigjimet e kërkuara. Eksperti vlerësues është i detyruar të kryejë korrigjimet dhe ta ridorëzojë raportin. Pagesa kryhet vetëm pas dorëzimit të raportit të korrigjuar dhe pranimit të tij.”.

10. Pikat 7 dhe 9 të udhëzimit shfuqizohen.

11. Pika 8 e udhëzimit ndryshohet si më poshtë vijon:

“Trualli që privatizohet konsiderohet sipërfaqja nën objekt dhe sipërfaqja funksionale (nëse ka) rreth tij, e përcaktuar sipas genplanit të objektit, që është pjesë e dokumentacionit të privatizimit që përgatit komisioni i vlerësimit sipas pikave 3 dhe 4, të kreut II, të VKM-së nr. 926, datë 29.12.2014, të ndryshuar. Për pronat shtetërore objekt të kontratave të qirasë/enfiteozës, të lidhura në zbatim të VKM-së nr. 54/2014, të ndryshuar, kontrata dhe anekset e saj merren në konsideratë për identifikimin e pronës objekt privatizimi. Sipërfaqja e truallit nën objekt dhe e truallit funksional përcaktohet dhe verifikohet në përputhje me kriteret dhe dokumentacionin tekniko-ligjor të parashikuar në VKM-në nr. 926, datë 29.12.2014, të ndryshuar”.

12. Pika 10 e udhëzimit, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Ministria përgjegjëse për ekonominë i dërgon çdo 6 (gjashtë) muaj Agjencisë së Trajtimit të Pronave kërkesën rreth hartës së miratuar të çmimeve. Agjencia e Trajtimit të Pronave, brenda afatit të përcaktuar ligjor dërgon hartën e miratuar të çmimeve të truallit. Në rastet kur për vendndodhjen e pronës shtetërore që privatizohet çmimi i truallit nuk figuron në hartën e çmimeve, vlerësimi i pronës shtetërore kryhet sipas vlerës së tregut. Struktura përgjegjëse për privatizimin i vë në dispozicion komisionit të vlerësimit hartën e çmimeve, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, të konfirmuar çdo 6 (gjashtë) muaj nga Agjencia e Trajtimit të Pronave (ATP). Përcaktimi i vlerës së pronës shtetërore, në përputhje me hartën e çmimeve dhe legjislacionin në fuqi, si edhe përzgjedhja e metodologjisë së vlerësimit janë në përgjegjësinë e ekspertit vlerësues, i cili, në

bazë të dokumentacionit, harton raportin përfundimtar të vlerësimit të pronës shtetërore.”.

13. Pikat 11, 11.1, 11.2, 11.3, dhe 11.4 të udhëzimit shfuqizohen.

14. Pika 12 e udhëzimit, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Dokumentacioni i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit, i cili i përcillet strukturës përgjegjëse për privatizimin, duhet të përmbajë vendimin e Komisionit të Vlerësimit, relacionin e Komisionit të Vlerësimit të nënshkruar nga të gjithë anëtarët, raportin e vlerësimit të hartuar nga eksperti/ekspertët dhe të nënshkruar prej tyre, kartelën e pasurisë së bashku me hartën treguese dhe të dhënat plotësuese nëse ka, miratimin e privatizimit, shkresën e ngritjes së Komisionit të Vlerësimit, si dhe genplanin/planin e rlevimit përkatës të konfirmuar nga të gjithë anëtarët e komisionit. Në zbatim të pikës 7, kreu II, të VKM-së nr. 926, datë 29.12.2014, të ndryshuar, në rast se për pronën objekt privatizimi Agjencia Shtetërore e Kadastrës nuk vendos në dispozicion kartelën e pasurisë, por vërtetimin e pasurisë për zonat kadastrale që nuk i janë nënshtruar regjistrimit fillestar, komisioni, për efekt të vlerësimit të pronës shtetërore, do të bazohet në këtë të fundit.

Në rastet kur prona shtetërore objekt privatizimi, në regjistrat e pasurisë nuk ka objekt të regjistruar, por vetëm truall, pas miratimit të ministrit, struktura përgjegjëse për privatizim ia përcjell dokumentacionin tekniko-financiar të institucionit administrues të pronës, genplanin/plan rlevimin, si dhe dokumentacione ASHK-së strukturës përgjegjëse për shitjen e pronës shtetërore, e cila, në zbatim të kreut III, të VKM-së nr. 926, datë 29.12.2014, të ndryshuar, nënshkruan kontratën e shitjes.”.

15. Pika 13 e udhëzimit, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Pas plotësimit të dokumentacionit, sipas afatit të parashikuar në pikën 11, të kreut II, të VKM-së nr. 926, datë 29.12.2014, të ndryshuar, procedohet si më poshtë vijon:

a) Komisioni i Vlerësimit, pasi merr të gjitha konfirmimet e nevojshme përgatit dokumentacionin tekniko-ligjor, si dhe harton vendimin shoqërues, ku më pas ia përcjell strukturës përgjegjëse për privatizim. Në këtë vendim, krahas përcaktimit të qartë të të dhënave identifikuese të



pronës, si sipërfaqja e përgjithshme, ajo nën objekt dhe ajo funksionale, vlera e pronës shtetërore, si edhe përputhshmëria me dokumentacionin kadastral për pasuritë shtetërore, si edhe për linjat e prodhimit/shërbimit; shprehet edhe për përmbushjen ose jo të kriterëve tekniko-ligjore, sipas legjislacionit në fuqi për privatizimin e pronës shtetërore;

b) Struktura përgjegjëse për privatizim shqyrton dhe verifikon dokumentacionin e përcjellë, së bashku me vendimin e këtij komisioni për vijimin e procedurave të privatizimit. Në rast se dokumentacioni rezulton në përputhje me legjislacionin në fuqi, struktura përgjegjëse për privatizimin përgatit vlerësimin përfundimtar për përmbushjen e kriterëve në referencë të shkronjës “a”, të pikës 12, kreu II, të VKM-së nr. 926, datë 29.12.2014, të ndryshuar, ku propozon fillimin e procedurave të shitjes dhe ia dërgon ministrit përgjegjës për ekonominë. Në rast të kundërt, struktura përgjegjëse për privatizimin kërkon plotësimin e dokumentacionit apo saktësimin e tij, në përputhje me kërkesat ligjore, duke e rikthyer dosjen pranë komisionit të vlerësimit me rekomandimet përkatëse. Pas miratimit të ministrit, vlerësimi përfundimtar dhe dokumentacioni tekniko-ligjor dërgohen sipas procedurave të brendshme administrative pranë strukturës përgjegjëse për shitjen e pronës shtetërore.”.

16. Pika 14 e udhëzimit ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Në zbatim të shkronjës “a”, të pikës 2, kreu III, të VKM-së nr. 926, datë 29.12.2014, të ndryshuar, për rastet e shitjes së objekteve për të cilat është konfirmuar se ka pronar truall, bëhet publikimi me afishim në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për ekonominë, në mjediset e pronës shtetërore dhe në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare për një afat prej 20 (njëzet) ditësh, vetëm për pronarët e truallit.

Ish-pronari i truallit që dëshiron të blejë objektin apo çdo subjekt tjetër që në bazë të dokumenteve që disponon, pretendon të ketë pronësi mbi truallin e objektit që privatizohet, duhet të paraqitet pranë ministrisë përgjegjëse për ekonominë, brenda një afati 20-ditor nga dita e publikimit (afishimit), duke depozituar:

- kërkesën me shkrim, në të cilën shprehet se dëshiron të blejë objektin e publikuar për shitje;

- dokumentacionin që vërteton pagesën prej 20% të vlerës totale të objektit (mjete kryesore + mjete xhiro), pa vlerën e truallit të objektit që kërkon të blejë;

- vendimin përkatës të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-pronarëve, të noterizuar, të shoqëruar me planvendosjen e pronës;

- çdo dokument tjetër ligjor të regjistruar në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, i cili përcakton se ai është pronar i tokës;

- dëshmi trashëgimie;

- prokurë përfaqësimi dhe marrëveshje të dokumentuar midis bashkëpronarëve, kur ka të tillë.”.

17. Në pikën 28 të udhëzimit hiqet togfjalëshi “bazuar dhe në vendimin e Komisionit të Shqyrtimit dhe Transparencës.”.

18. Pas pikës 35 shtohen pikat 35/1, 35/2, 35/3, 35/4, 35/5, 35/6, 35/7 dhe 35/8, me përmbajtje si vijon:

“35/1. Në zbatim të pikës 27, të kreut III, të VKM-së nr. 926, datë 29.12.2014, të ndryshuar, pas kryerjes së pagesës së vlerës së plotë të pronës shtetërore, struktura përgjegjëse për shitjen verifikon dokumentacionin e pronës, përfshirë dokumentacionin e rifreskuar të pronësisë të marrë nga ASHK-ja (kartelë pasurie dhe hartë treguese). Pas këtij verifikimi, drejtuesi i strukturës përgjegjëse për shitjen nënshkruan kontratën e shitjes me blerësin.

35/2. Në zbatim të pikës 34, të kreut III, të VKM-së nr. 926, datë 29.12.2014, të ndryshuar, për subjektet qiramarrëse ose enfiteozëmarrëse të pasurive shtetërore me sipërfaqe mbi 500 (pesëqind) m², të dhëna me qira ose enfiteozë sipas kontratave me tarifën “1 euro/kontrata”, kërkesa për blerjen e pasurisë shqyrtohet në përputhje me pikat 35 deri në 43 të këtij kreu, me kusht që pasuria të mos jetë pasuri shtetërore e patjetërsueshme, në kuptim të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe subjekti të ketë realizuar, brenda afatit të përcaktuar në kontratën e qirasë ose enfiteozës për realizimin e investimit, investime në vlerë mbi 5 000 000 (pesë milionë) euro dhe në një vlerë më të lartë se 750 (shtatëqind e pesëdhjetë) për qind e vlerës së pasurisë shtetërore objekt i



kërkesës për blerje. Përmbushja e këtyre kushteve vërtetohet nëpërmjet dokumentacionit kontraktor, financiar dhe teknik, që provon realizimin dhe vlerën e investimeve, si dhe dokumentacionit që përcakton vlerën e pasurisë objekt i kërkesës.

35/3. Në zbatim të pikave 36 dhe 37, të kreut III, të VKM-së nr. 926, datë 29.12.2014, të ndryshuar, në kontratën e shitjes përfshihen dispozita që parashikojnë detyrimin e blerësit për të realizuar vlerën e plotë të investimit sipas plan-biznesit, brenda afatit të parashikuar në kontratën e mëparshme të qirasë ose enfiteozës, i cili pasqyrohet si kufizim në kartelën e pasurisë, si dhe vijimin e përmbushjes nga palët të detyrimeve të tjera të parashikuara në kontratën e mëparshme, që lidhen me çështjet teknike, ekonomike, të raportimit etj., me përjashtim të detyrimeve bazike të qirasë, ngushtësisht si institut i Kodit Civil. Në rast se blerësi nuk përmbush detyrimin për përfundimin e investimit sipas kushteve dhe afateve të kontratës së mëparshme të qirasë ose enfiteozës, ministria përgjegjëse ka të drejtë të zgjidhë në mënyrë të njëanshme kontratën e shitjes, sipas neneve 702, 703 dhe 737 të Kodit Civil, me rikthimin e pasurisë së privatizuar në pronësi të shtetit dhe me të drejtën për të mbajtur shumën e paguar më parë nga blerësi për blerjen e pasurisë. Blerësi nuk ka të drejtë ta tjetërsojë pasurinë e privatizuar tek të tretët deri në realizimin e vlerës së plotë të investimit të parashikuar në kontratën e mëparshme të qirasë ose enfiteozës, ku ky ndalim përbën hipotekë ligjore mbi pasurinë e privatizuar, në kuptim të nenit 563, shkronja “a”, të Kodit Civil, dhe pasqyrohet në regjistrin kadastral, ndërsa ky ndalim nuk pengon zhvillimin e pronës, në përputhje me projektin e përcaktuar më parë dhe legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, si dhe lidhjen e kontratave të sipërmarrjes ose porosisë për objektet e ndërtuara mbi të. Pas realizimit të vlerës së investimit sipas kontratës së qirasë ose enfiteozës, brenda afatit të përcaktuar në të, blerësi njofton ministrinë përgjegjëse për ekonominë, duke paraqitur aktin e vlerësimit që vërteton përmbushjen e investimit në vlerën dhe masën e përcaktuar në kontratë.

35/4. Në zbatim të pikës 2, të kreut III/1, të VKM-së nr. 926, datë 29.12.2014, të ndryshuar, kërkesa për kryerjen e shkëmbimit paraqitet vetëm

nga institucionet qendrore dhe organet e njësive të vetëqeverisjes vendore, ndërmarrjet shtetërore në varësi të tyre, të cilat kanë në përgjegjësi administrimi, pronësi ose përdorim pasurinë shtetërore, në vijim të quajtura bashkërisht “Organe propozuese”.

35/5. Në zbatim të pikës 14, të kreut III/1, të VKM-së nr. 926, datë 29.12.2014, të ndryshuar, pas marrjes së vendimit për përzgjedhjen e pasurisë, që propozohet të përfitohet përmes shkëmbimit, organi propozues i përcjell ministrisë përgjegjëse për ekonominë kërkesën për fillimin e procedurave të privatizimit përmes shkëmbimit, bazuar në argumentimin e saktë të nevojave për privatizimin e një prone tjetër nëpërmjet shkëmbimit me pronën që disponohet.

35/6. Struktura përgjegjëse për privatizimin vlerëson kërkesën e përcjellë nga organi propozues për fillimin e procedurave të privatizimit përmes shkëmbimit dhe i propozon ministrit përgjegjës për ekonominë miratimin ose jo të kërkesës. Në rast miratimi të kërkesës nga ministri përgjegjës për ekonominë, organi propozues fillon procedurat për realizimin e shkëmbimit sipas kreut III/1, të VKM-së nr. 926, datë 29.12.2014, të ndryshuar.

35/7. Ministria përgjegjëse për ekonominë, pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga organi propozues, merr vendim brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga paraqitja e kërkesës. Vendimi i arsyetuar i njoftohet titullarit të organit propozues brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e tij.

35/8. Ministria përgjegjëse për ekonominë, në bazë të dokumentacionit të përcaktuar në pikën 13, të kreut III/1, të VKM-së nr. 926, datë 29.12.2014, të ndryshuar, shqyrton kërkesën e organit propozues vetëm për sa u përket aspekteve të vlerësimit financiar të pronave, referuar shkronjës “ç”, të pikës 8, të të njëjtit kre, si dhe konstaton statusin, sipas dokumentacionit kadastral të përcjellë. Ajo ka të drejtë të mos e miratojë kërkesën e organit për një nga këto arsye:

a) nëse vlera e pasurisë shtetërore është më e madhe se ajo e pronës private që propozohet të shkëmbihet me të dhe subjekti privat nuk ka ofruar kompensimin e diferencës në të holla;

b) nëse është verifikuar pasaktësi në raportet e vlerësimit të pronave ose në të dhënat e paraqitura për to; për të verifikuar këtë kriter, ministria përgjegjëse rikryen vlerësimin e pasurive që



shkëmbehen, pavarësisht akteve të paraqitura nga organi shtetëror kërkuar;

c) nëse është i pranishëm një nga rastet e parashikuara në pikën 4, të kreut III/1, të VKM-së nr. 926, datë 29.12.2014, të ndryshuar.”.

II. Ngarkohet ministria përgjegjëse për ekonominë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I EKONOMISË
DHE INOVACIONIT
Delina Ibrahimaj

URDHËR
Nr. 892, datë 3.9.2026

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË GJUHËS BLU, TË
SHFAQUR NË SHTETIN E SPANJËS**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë;

b) spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Spanjës, janë sipas ndarjeve administrative të tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë	Ndarja administrative e nivelit të tretë*
Aragón	Huesca	Boltaña*
Cataluña	Girona	Pla de l'estany (banyoles)*
Castilla y León	Segovia	Segovia*
Castilla - La Mancha	Toledo	Galvez*
Castilla - La Mancha	Toledo	Toledo*
Castilla - La Mancha	Toledo	Oropesa*
Comunidad Foral de Navarra	Navarra	Ochagavía*
Extremadura	Badajoz	Don Benito*
Extremadura	Cáceres	Logrosan (Zorita)*
Extremadura	Cáceres	Navalmoral de la Mata*
País Vasco	Araba/Álava	Araba-Alava*
País Vasco	Gipuzkoa	Gipuzkoa*

Principado de Asturias	Asturias	Tineo*
Principado de Asturias	Asturias	Vegadeo*
Illes Balears	Illes Balears	Palma*
Illes Balears	Illes Balears	Menorca*
Galicia	A Coruña	Ferrol*
Galicia	A Coruña	A Barcala*
Galicia	Lugo	Chantada*
Galicia	Lugo	Meira*
Galicia	Pontevedra	Deza*
La Rioja	La Rioja	Alfaro*

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që kafshët e gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e dërgesës; dhe

ii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 60 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës; ose

iii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 28 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë asaj periudhe i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupe ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, të kryera të paktën 28 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët; ose

iv. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar një testi identifikimi të agentit të sëmundjes, me rezultate negative, të kryer të paktën 14 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët;

b) janë:

i. vaksinuar, të paktën 60 ditë përpara dërgesës, kundër të gjitha stereotipave të demonstruara të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenin 8.3.14



deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ii. identifikuar si të vaksinuar; ose

iii. është demonstruar se kishte antitropa për të paktën 60 ditë përpara dërgesës kundër të gjitha stereotipave të demonstruara se janë të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

c) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që meshkujt dhurues të spermës së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë para fillimit dhe gjatë mbledhjes së spermës; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për zbulimin e antitropave ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, midis 28 dhe 60 ditësh pas çdo grumbullimi për këtë ngarkesë; ose

iv. i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes në mostrat e gjakut të mbledhura në fillim dhe përfundim të, dhe të paktën çdo 7 ditë (testi i izolimit të virusit) ose të paktën çdo 28 ditë (testi PCR) gjatë mbledhjes së spermës për këtë ngarkesë, me rezultate negative;

v. sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

c) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që femrat dhuruese të embrioneve *in vivo* të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë përpara fillimit dhe gjatë mbledhjes së embrioneve; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitropat ndaj virusit të gjuhës blu midis 28 dhe 60 ditësh pas grumbullimit, me rezultate negative; ose

iv. i janë nënshtruar një testi për identifikimin e agjentit të sëmundjes në një kampion gjaku të marrë në ditën e mbledhjes së embrioneve, me rezultate negative;

v. embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.8, 4.9 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, sipas rastit;

vi. sperma e përdorur për fekundimin e ovociteve ishte në përputhje me nenin 8.3.9 ose nenin 8.3.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore.

4. Certifikata veterinare shëndetësore garanton origjinën e tyre sipas përcaktimeve në pikat 2 dhe 3 të këtij urdhri.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjithë subjektet importuese të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

6. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

7. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

8. Urdhri nr. 884, datë 2.9.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Spanjës”, shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri



URDHËR

Nr. 893, datë 3.9.2026

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË GJUHËS BLU, TË
SHFAQUR NË SHTETIN E AUSTRIËS**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë;

b) spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Austrisë, janë sipas ndarjeve administrative të tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë	Ndarja administrative e nivelit të tretë
Niederösterreich	Baden	Altenmarkt an der Triesting*
Vorarlberg	Bregenz	Lauterach*
Salzburg	Sankt Johann im Pongau	Eben im Pongau*
Steiermark	Hartberg-Fürstenfeld	Waldbach-Mönichwald*
Steiermark	Murtal	Pölstal*
Niederösterreich	Melk	Texingtal*
Oberösterreich	Gmunden	Bad Goisern am Hallstättersee*
Tirol	Kitzbühel	Brixen im Thale*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që kafshët e gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e dërgesës; dhe

ii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 60 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës; ose

iii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 28 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë asaj periudhe i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupe ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, të kryera të paktën 28 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët; ose

iv. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes, me rezultate negative, të kryer të paktën 14 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët;

b) janë:

i. vaksinuar, të paktën 60 ditë përpara dërgesës, kundër të gjitha stereotipave të demonstruara të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ii. identifikuar si të vaksinuar; ose

iii. është demonstruar se kishte antitrupe për të paktën 60 ditë përpara dërgesës kundër të gjitha stereotipave të demonstruara se janë të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

c) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që meshkujt dhurues të spermës së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë para fillimit dhe gjatë mbledhjes së spermës; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për zbulimin e antitrupeve ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, midis 28 dhe 60 ditësh pas çdo grumbullimi për këtë ngarkesë; ose

iv. i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes në mostrat e gjakut të



mbledhura në fillim dhe përfundim të, dhe të paktën çdo 7 ditë (testi i izolimit të virusit) ose të paktën çdo 28 ditë (testi PCR) gjatë mbledhjes së spermës për këtë ngarkesë, me rezultate negative;

v. sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ç) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që femrat dhuruese të embrioneve *in vivo* të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë përpara fillimit dhe gjatë mbledhjes së embrioneve; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupe ndaj virusit të gjuhës blu midis 28 dhe 60 ditësh pas grumbullimit, me rezultate negative; ose

iv. i janë nënshtruar një testi për identifikimin e agjentit të sëmundjes në një kampion gjaku të marrë në ditën e mbledhjes së embrioneve, me rezultate negative;

v. embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.8, 4.9 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, sipas rastit;

vi. sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve ishte në përputhje me nenin 8.3.9 ose nenin 8.3.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore.

4. Certifikata veterinare shëndetësore garanton origjinën e tyre sipas përcaktimeve në pikat 2 dhe 3 të këtij urdhri.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjithë subjektet importuese të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

6. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

7. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe

Peshkimit për çdo ngarkesë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

8. Urdhri nr. 864, datë 27.8.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Austrisë”, shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR
Nr. 894, datë 3.9.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË GJUHËS BLU, TË SHFAQUR NË SHTETIN E FRANCËS

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë;

b) spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Francës, janë sipas ndarjeve administrative të tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë	Ndarja administrative e nivelit të tretë
Ariège*		
Aude*		
Aveyron*		



Cantal*		
Creuse*		
Dordogne*		
Gers*		
Haute-Garonne*		
Hautes-Pyrénées*		
Haute-Savoie*		
Hérault*		
Landes*		
Lot*		
Manche*		
Puy-de-Dôme*		
Pyrénées-Atlantiques*		
Savoie*		
Tarn*		
Isère*		

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që kafshët e gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e dërgesës; dhe

ii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 60 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës; ose

iii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 28 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë asaj periudhe i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrapat ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, të kryera të paktën 28 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët; ose

iv. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes, me rezultate negative, të kryer të paktën 14 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët;

b) janë:

i. vaksinuar, të paktën 60 ditë përpara dërgesës, kundër të gjitha stereotipave të demonstruara të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ii. identifikuar si të vaksinuar; ose

iii. është demonstruar se kishte antitrapa për të paktën 60 ditë përpara dërgesës kundër të gjitha stereotipave të demonstruara se janë të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

c) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që meshkujt dhurues të spermës së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë para fillimit dhe gjatë mbledhjes së spermës; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për zbulimin e antitrapave ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, midis 28 dhe 60 ditësh pas çdo grumbullimi për këtë ngarkesë; ose

iv. i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes në mostrat e gjakut të mbledhura në fillim dhe përfundim të, dhe të paktën çdo 7 ditë (testi i izolimit të virusit) ose të paktën çdo 28 ditë (testi PCR) gjatë mbledhjes së spermës për këtë ngarkesë, me rezultate negative;

v. sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ç) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që femrat dhuruese të embrioneve *in vivo* të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë përpara fillimit dhe gjatë mbledhjes së embrioneve; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrapat ndaj virusit të gjuhës blu midis 28 dhe 60 ditësh pas grumbullimit, me rezultate negative; ose



iv. i janë nënshtruar një testi për identifikimin e agjentit të sëmundjes në një kampion gjaku të marrë në ditën e mbledhjes së embrioneve, me rezultate negative;

v. embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.8, 4.9 dhe 4.10, të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, sipas rastit;

vi. sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve ishte në përputhje me nenin 8.3.9 ose nenin 8.3.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore.

4. Certifikata veterinare shëndetësore garanton origjinën e tyre sipas përcaktimeve në pikat 2 dhe 3 të këtij urdhri.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjithë subjektet importuese të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

6. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

7. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të të gjithë kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

8. Urdhri nr. 862, datë 26.8.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Francës”, shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR

Nr. 907, datë 4.9.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË GJUHËS BLU, TË SHFAQUR NË SHTETIN E SPANJËS

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë;

b) spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Spanjës, janë sipas ndarjeve administrative të tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë	Ndarja administrative e nivelit të tretë*
Aragón	Huesca	Boltaña*
Cataluña	Girona	Pla de l'estany (banyoles)*
Cataluña	Lleida	Pallars Jussà (Trempt)*
Castilla y León	Segovia	Segovia*
Castilla - La Mancha	Toledo	Galvez*
Castilla - La Mancha	Toledo	Toledo*
Castilla - La Mancha	Toledo	Oropesa*
Comunidad Foral de Navarra	Navarra	Ochagavía*
Extremadura	Badajoz	Don Benito*
Extremadura	Cáceres	Logrosan (Zorita)*
Extremadura	Cáceres	Navalmoral de la Mata*
País Vasco	Araba/Álava	Araba-Alava*
País Vasco	Gipuzkoa	Gipuzkoa*
Principado de Asturias	Asturias	Tineo*
Principado de Asturias	Asturias	Vegadeo*
Illes Balears	Illes Balears	Palma*



Illes Balears	Illes Balears	Menorca*
Galicía	A Coruña	Ferrol*
Galicía	A Coruña	A Barcala*
Galicía	Lugo	Chantada*
Galicía	Lugo	Meira*
Galicía	Pontevedra	Deza*
La Rioja	La Rioja	Alfaro*

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që kafshët e gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e dërgesës; dhe

ii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 60 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës; ose

iii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 28 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë asaj periudhe i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupe ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, të kryera të paktën 28 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët; ose

iv. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes, me rezultate negative, të kryer të paktën 14 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët;

b) janë:

i. vaksinuar, të paktën 60 ditë përpara dërgesës, kundër të gjitha stereotipave të demonstruara të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ii. identifikuar si të vaksinuar; ose

iii. është demonstruar se kishte antitrupe për të paktën 60 ditë përpara dërgesës kundër të gjitha stereotipave të demonstruara se janë të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

c) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që meshkujt dhurues të spermës së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë para fillimit dhe gjatë mbledhjes së spermës; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për zbulimin e antitrupeve ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, midis 28 dhe 60 ditësh pas çdo grumbullimi për këtë ngarkesë; ose

iv. i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes në mostrat e gjakut të mbledhura në fillim dhe përfundim të, dhe të paktën çdo 7 ditë (testi i izolimit të virusit) ose të paktën çdo 28 ditë (testi PCR) gjatë mbledhjes së spermës për këtë ngarkesë, me rezultate negative;

v. sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ç) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që femrat dhuruese të embrioneve *in vivo* të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë përpara fillimit dhe gjatë mbledhjes së embrioneve; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupe ndaj virusit të gjuhës blu midis 28 dhe 60 ditësh pas grumbullimit, me rezultate negative; ose

iv. i janë nënshtruar një testi për identifikimin e agjentit të sëmundjes në një kampion gjaku të marrë në ditën e mbledhjes së embrioneve, me rezultate negative;

v. embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.8, 4.9 dhe 4.10, të



Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, sipas rastit;

vi. sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve ishte në përputhje me nenin 8.3.9 ose nenin 8.3.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore.

4. Certifikata veterinare shëndetësore garanton origjinën e tyre sipas përcaktimeve në pikat 2 dhe 3 të këtij urdhri.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjithë subjektet importuese të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

6. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

7. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

8. Urdhri nr. 892, datë 3.9.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Spanjës”, shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR

Nr. 908, datë 4.9.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË LISË SË DHENVE DHE DHIVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E RUMANISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit dhen dhe dhi, materialit biologjik, leshit dhe lëkurës së kafshëve të llojit dhen dhe dhi përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e pikës 2.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e lisë së dhenve dhe dhive, të shfaqur në shtetin e Rumanisë, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2*
1.	Mureș	Voivodeni*
2.	Mureș	Vatava*
3.	Mureș	Zau De Campie*
4.	Mureș	Suseni*
5.	Buzău	Padina*
6.	Iași	Popesti*
7.	Tulcea	Murighiol*
8.	Vâlcea	Malaia*
9.	Gorj	Turcinești*
10.	Constanța	Istria*
11.	Gorj	Targu Jiu*
12.	Constanța	Vulturii*
13.	Tulcea	Peceneaga*
14.	Brăila	Maxineni*
15.	Tulcea	Valea Nucarilor*
16.	Tulcea	Ostrov*
17.	Galați	Tudor Vladimirescu*
18.	Brăila	Gemenale*
19.	Buzău	Luciu*
20.	Gorj	Bengesti*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit dhen



dhe dhi, materialit biologjik, leshit dhe lëkurës së kafshëve të llojit dhen dhe dhi.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojë të gjithë subjektet importuese të kafshëve të gjalla të llojit dhen dhe dhi, materialit biologjik, leshit dhe lëkurës së kafshëve të llojit dhen dhe dhi për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Urdhri nr. 877, datë 31.8.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së lisë së dhenve dhe dhive, të shfaqur në shtetin e Rumanisë”, shfuqizohet.

7. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR
Nr. 1908, datë 9.9.2026

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të ligjit 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, të ndryshuar;

URDHËROJ:

1. Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme Rregullore dhe Përputhshmërisë në Fushën e Mbrojtjes, znj. Marbona Stavro, i delegohet kompetenca, për:

a) nënshkrimin e autorizimeve për përfaqësimin e Ministrisë së Mbrojtjes përpara gjykatave në çështjet në të cilat Ministria e Mbrojtjes është palë;

b) nënshkrimin e ankimeve, rekurseve, kundërankimeve, kundërrekrurseve të cilat ushtrohen kundër vendimeve në të cilat Ministria e Mbrojtjes ka qenë palë ndërgjyqëse;

c) nënshkrimin e padive, kundërpadive, kërkesave për sigurim padie, kërkesave për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të cilat ushtrohen nga Ministria e Mbrojtjes.

2. Urdhri i ministrit të Mbrojtjes nr. 1074, datë 21.5.2026, “Për delegimin e kompetencave”, shfuqizohet.

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme Rregullore dhe Përputhshmërisë në Fushën e Mbrojtjes, znj. Marbona Stavro.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I MBROJTJES
Ermal Nufi

GJYKATA EVROPIANE E
TË DREJTAVE TË NJERIUT
SEKSIONI I TRËTË

ÇËSHTJA PAPANDILE KUNDËR
SHQIPËRISË
(Kërkesa nr. 38771/23)

VENDIM

STRASBURG
25 gusht 2026

Ky është vendim përfundimtar, por mund t'i nënshtrohet rishikimit redaktorial.

Në çështjen Papandile kundër Shqipërisë,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur si Komitet i përbërë, nga:

Diana Kovatcheva, Kryetare,

Darian Pavli,

Vasilka Sancin, gjyqtarë,

dhe Olga Chernishova, zëvendëskancelare e seksionit,

Duke pasur parasysh:

kërkesën (nr. 38771/23) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituar në Gjykatë sipas nenit 34 të



Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (Konventa), më 19 tetor 2023, nga shtetasi shqiptar z. Eugen Papandile (kërkuesi), i lindur në vitin 1974, me banim në Tiranë dhe i përfaqësuar nga z. S. Hazizaj, avokat i licencuar në Tiranë;

vendimin për të njoftuar qeverinë e Shqipërisë (Qeveria) të përfaqësuar nga z. O. Moçka, Avokat i Përgjithshëm i Shtetit, për ankimin në lidhje me të drejtën e kërkuesit për respektimin e jetës private dhe për të shpallur të papranueshme pjesën tjetër të kërkesës;

parashtrimet e palëve;

Pas diskutimit me dyer të mbyllura, më 30 qershor 2026,

mori vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua po në këtë datë:

OBJEKTI I ÇËSHTJES

1. Çështja ka të bëjë me ndalimin 15-vjeçar të emërimit të kërkuesit në disa pozicione në sistemin e drejtësisë, të vendosur pas ndërprerjes së procesit të vetingut ndaj tij, për shkak se ai në fakt kishte dhënë dorëheqjen nga një pozicion që ishte subjekt vetingu (shihni kuadrin dhe praktikën përkatëse ligjore në çështjen *Bala kundër Shqipërisë* (vend. nr. 21141/20, §§ 21–27, 9 prill 2024).

2. Sipas ndryshimeve kushtetuese dhe legjislacionit të miratuar në vitin 2016, këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese ishin subjekte të procesit të rivlerësimit kalimtar (procesi i vetingut) (shihni *Xboxhaj kundër Shqipërisë*, nr. 15227/19, 9 shkurt 2021).

3. Kërkuesi shërbente si këshilltar ligjor në Gjykatën Kushtetuese dhe në janar 2017 paraqiti një deklaratë vetingu. Në vitin 2017 ai aplikoi dhe u emërua në pozicionin e Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës Kushtetuese, një pozicion që e ka mbajtur që në janar 2018.

4. Në vitin 2020, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (KED) e refuzoi kandidaturën e tij për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese. Ai gjeti që kërkuesi plotësonte kërkesat për përvojën profesionale dhe kishte vlerësim pozitiv të pasurisë, por nuk kishte vlerësim pozitiv të figurës.

5. Në vitin 2021, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) filloi kundër tij procesin e vetingut. Ai paraqiti se që në vitin 2018 kishte shërbyer si drejtues i administratës së Gjykatës Kushtetuese, funksion ky që Kushtetuta nuk e rendit si subjekt të vetingut *ex officio*; ai nuk kishte

dhënë dorëheqjen nga roli i tij i mëparshëm si këshilltar ligjor; ai ishte vlerësuar tashmë nga KED-ja; dhe si sekretar i Përgjithshëm, nuk kishte të drejtë t'i nënshtrohej vlerësimit për komponentin e aftësive profesionale të procesit të vetingut.

6. Më 23 nëntor 2022, KPK-ja e ndërpreu procesin dhe vendosi ndalimin 15-vjeçar ndaj emërimit të tij si gjyqtar ose prokuror në çdo shkallë, anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor ose të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë ose Prokurorisë së Përgjithshme (neni G i aneksit të Kushtetutës).

7. Kërkuesi paraqiti ankimim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit (KPA). Ai pretendoi se asnjëherë nuk kishte kërkuar t'i shmangej procesit të vetingut dhe që fakti që nuk i ishte nënshtroar vlerësimit nuk ishte për faj të tij, sepse ai nuk konsiderohej më si subjekt i vetingut në detyrë dhe nuk ishte njoftuar në lidhje me këtë. Më tej, paraqiti që KPK-ja nuk kishte përcaktuar “dorëheqje” formale sipas kuptimit të nenit G; që lëvizja e tij nga këshilltar ligjor në Sekretar i Përgjithshëm përbënte rritje të vërtetë në karrierë, jo përpjekje për t’ju shmangur vetingut, dhe që KPK-ja nuk kishte kompetencë, sepse ai ishte vlerësuar tashmë nga KED-ja (shihni paragrafin 4 më sipër). Në parashtrimet e tij të fundit ai kërkoi që vendimi i KPK-së të shfuqizohej dhe që KPA-ja të vendoste nëse duhej të ndërpritej procesi pa një ndalim ose të vazhdonte deri në përfundim.

8. Më 19 prill 2023, KPA-ja la në fuqi vendimin e KPK-së, si vijon:

a) Pretendimi i kërkuesit që ai u bë subjekt i vetingut vetëm në vitin 2021 ishte i gabuar sepse ndryshimet kushtetuese parashikonin zbatimin *ex officio* të procesit të vetingut, pas hyrjes së tyre në fuqi, për këshilltarët ligjorë që atëherë shërbenin në Gjykatën Kushtetuese;

b) Kërkuesi, me dijeni, aplikoi për pozicionin e Sekretarit të Përgjithshëm që ishte i papajtueshëm me rolin e tij si këshilltar ligjor dhe u bë palë në procesin e emërimit. Në këto rrethana, edhe në mungesë të shkresës zyrtare të dorëheqjes, kërkesa e tij tregoi synimin e qartë për t’u larguar nga detyra e tij e mëparshme. Pasi u provua që kërkuesi me vullnetin e tij ishte dorëhequr nga pozicioni që e kualifikonte si subjekt të vetingut, arsyet e tij ishin të parëndësishme sepse kjo zgjedhje personale tregonte që ai nuk mund të konsiderohej më subjekt i vetingut dhe e bëri të pamundur vazhdimin e procesit të vetingut. Synimi i një personi për të mos



ju shmangur vetingut mund të tregohet vetëm nga vendimi i tij për të qëndruar në detyrë dhe për të përfunduar procesin e vetingut. Lëvizja në karrierë e kërkuesit shkaktoi pasojën kushtetuese që lidhet me këtë zgjedhje – përkatësisht, ndalimi për 15 vjet i së drejtës për të aplikuar në shumicën e pozicioneve në sistemin e drejtësisë. Megjithatë, kjo nuk e pengoi që të vazhdonte të shërbente si Sekretar i Përgjithshëm i Gjykatës Kushtetuese;

c) Kur u kontaktua nga KPK-ja për herë të parë, kërkuesi u përgjigj që në atë moment nuk ishte subjekt i vetingut dhe nuk e plotësoi pyetësin standard. Sa kohë që ish-këshilltarët ligjorë kishin të drejtë t'i nënshtroheshin verifikimit të aftësisë profesionale, pretendimi i kërkuesit që ai nuk ishte njoftuar ishte i pabazuar dhe fakti që nuk u vlerësua tregoi mungesë vullneti për t'ju nënshtroar vetingut. Sjellja e tij dhe qëndrimet kontradiktore penguan vazhdimin e procesit të vetingut; dhe kërkesa e tij e fundit në apel nuk mbështetej nga struktura e përgjithshme ligjore dhe logjike e deklaramit të tij në apel; dhe

d) Organet e vetingut vlerësonin pasurinë, figurën dhe aftësinë profesionale. Nga ana tjetër, KED-ja verifikonte kushtet ligjore dhe kriterin e figurës dhe profesionalizmit për emërimin në pozicione të caktuara. Në çështjen e kërkuesit, vlerësimi i pasurisë nga KED-ja mbështetej vetëm në raportin e një organi ndihmës. Vlerësimi profesional i tij fokusohej në vitet e punës dhe kërkesa ligjore formale, ndërsa organet e vetingut kryenin një vlerësim më të detajuar të aftësisë profesionale. Procesi i vlerësimit kalimtar u krye i pavarur nga ndonjë proces përpara organeve të tjera kushtetuese. Procesi i KED-së rezultoi në vendim refuzimi të kandidaturës së tij.

9. Gjyqtari i KED-së, N. M., shprehu mendim pakice, duke vlerësuar se aplikimi për pozicionin e Sekretarit të Përgjithshëm nuk mund të barazohej automatikisht me një dorëheqje të qartë që do të sillte pasojat e nenit G. Në ankimin e tij, kërkuesi kishte kërkuar qartazi ndërprerjen e çështjes pa ndalim ose, përndryshe, vazhdimin e procesit të vetingut dhe hetimin administrativ. Kjo ishte kërkesë e hapur për t'u vlerësuar. Vetingu nuk i pengonte subjektet që të vazhdonin karrierën e tyre në pozicione të ndryshme; i penalizonte ata vetëm kur ndryshimi i funksionit ishte bërë vetëm për të shmangur vetingun dhe kjo çështje nuk përfshihet në këtë kategori. Kërkuesi përsëri e kishte të drejtën

në fazën e ankimit që të kërkonte t'i nënshtrohej vetingut dhe ai e ushtroi atë të drejtë. Edhe këshilltarët ligjorë që u larguan nga detyra përpara ndryshimeve kushtetuese kishin të drejtë të kërkonin t'i nënshtroheshin vetingut. Pra, KPA-ja duhej të kishte vazhduar procesin e vetingut.

VLERËSIMI I GJYKATËS

SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 8 TË KONVENTËS

A. Pranueshmëria

1. Parashtrimet e palëve

a) Qeveria

10. Qeveria pretendoi se kërkuesi nuk kishte prova që ndërprerja e procesit ose ndalimi për 15 vjet përbënte ndërhyrje në jetën e tij private apo arrinte në kufirin e kërkuar të rëndesës. Ai ju referua vetëm kufizimeve të pretenduara për aspiratat profesionale, sidomos dëshirës së tij për t'u emëruar në Gjykatën Kushtetuese. Masat nuk kishin ndikuar në marrëdhëniet e tij të punësimit ose në të ardhurat e tij. Procesi ishte ndërprerë për shkak të vetë sjelljes së kërkuesit dhe tregoi zgjedhjen e tij me dëshirë. Ai nuk ishte kufizuar në ushtrimin e profesionit të tij ekzistues; kishte kërkuar të drejtën për një detyrë specifike shtetërore për të cilën nuk kishte të drejtë të mirëqenë për t'u emëruar. Ai kishte marrë përsipër dhe mbante një pozicion më të lartë me pagë më të mirë, duke e konsideruar pozicionin e Sekretarit të Përgjithshëm si një shkallë më lart në karrierën e tij. Ndalimi zbatohej vetëm ndaj disa pozicioneve të listuara në kushtetutë ndërsa kërkuesi ishte i lirë të ndiqte profesionin e tij në sferën publike ose private dhe vazhdoi të mbante një nga pozicionet më të larta administrative në sistemin e drejtësisë.

b) Kërkuesi

11. Kërkuesi pretendoi se nuk kishte bazë ligjore për argumentin që subjektet e vetingut nuk duhet të lejohen të ndryshojnë pozicionet ose të zhvillohen në karrierë gjatë procesit të vetingut. As Kushtetuta as legjislacioni përkatës nuk vendosin kufizime për lëvizjen në karrierë brenda sistemit të drejtësisë gjatë atij procesi apo nuk kërkojnë qëndrimin në të njëjtin pozicion deri në përfundim të procesit të vetingut. Vendorsja e ndalimit për t'u përfshirë në procedura të tjera gjatë procesit të gjatë të vetingut do të ishte në kundërshtim me të drejtat kushtetuese dhe nenin 8 të Konventës.

2. Vlerësimi i Gjykatës



12. Mospranimi në profesion ose masa të ngjashme jo favorizuese kanë tendencën të ndikojnë në aspekte të ndryshme të jetës private, përfshirë “rrethin e brendshëm” të një personi, mundësinë për të krijuar dhe zhvilluar marrëdhënie me të tjerët dhe reputacionin profesional dhe social të personit. Nëse lind një çështje e “jetës private” për shkak të pasojave të një mase, kufiri i rëndësës bëhet i rëndësishëm sidomos në kontekstin e të drejtës për pozicione ose detyra në shërbimin publik. Neni 8 i Konventës nuk e garanton të drejtën për t’u emëruar në një pozicion ose detyrë në shërbimin publik apo ndonjë formë kualifikimi apo të drejte për pozicione të larta në sistemin e drejtësisë. I takon kërkuesit që të tregojë natyrën e ndërhyrjes së pretenduar dhe të tregojë në mënyrë bindëse pasojat shumë të rënda të masës që ndikojnë në jetën e tij në një masë shumë të konsiderueshme dhe të përcaktojë dhe të provojë natyrën dhe shkallën e atyre pasojave (shihni *Bala kundër Shqipërisë* (vend.) nr. 21141/20, §§ 56–58 dhe 65, 9 prill 2024, me referenca të mëtejshme).

13. Duke marrë pozicionin e Sekretarit të Përgjithshëm, kërkuesi kërkoi ecuri në karrierë në të njëjtën gjykatë, në një detyrë të lartë administrative dhe kështu qëndroi brenda sistemit të drejtësisë (shihni, për krahasim, *Bala*, cituar më lart, §§ 67, 70 dhe 78). Prandaj, kërkuesi e gjeti veten në një situatë tepër të ndryshme krahasuar me ata që ishin larguar nga sistemi i drejtësisë, duke çuar në ndërprerje të procesit të vetingut. Në praktikë, ai u vu në pozitë më pak të favorshme për shkak të ndjekjes së ecurisë në karrierë brenda të njëjtës gjykatë, kur lindi mundësia, në një moment ku procesi i vetingut zgjaste shumë vite dhe vetingu i këshilltarëve ligjorë nuk konsiderohej përparësi (shihni paragrafët 2, 3 dhe 5 më sipër). Kufizimi që rezultoi mbi mundësitë e tij të ardhshme profesionale – pavarësisht që ai vazhdoi të shërbejë brenda sistemit të drejtësisë në nivel të lartë – shkoi përtej efekteve normale të rregullimit të shërbimit publik dhe ndikoi direkt në aftësinë e tij për identitetin profesional dhe mundësi karriere. Në këto rrethana, Gjykata konkludon se faktet e çështjes tregojnë një nivel rëndese të mjaftueshme për të përfshirë të drejtën e kërkuesit për respektimin e jetës së tij private.

14. Gjykata vëren se kjo kërkesë nuk është haptazi e pabazuar sipas kuptimit të nenit 35 § 3 (a) të Konventës ose e papranueshme për ndonjë shkak tjetër. Prandaj, kërkesa duhet të pranohet.

B. Themeli

1. Parashtrimet e palëve

15. Kërkuesi iu përmbajt kërkesës së tij.

16. Qeveria u shpreh që kërkuesi nuk kishte paraqitur dokumentacionin e kërkuar dhe nuk ishte vlerësuar profesionalisht, duke treguar kështu mungesën e vullnetit të tij për t’ju nënshtruar vetingut. Procesi i vetingut synon kthimin e besimit të publikut te gjyqësori dhe ndalimi 15-vjeçar synon të sigurojë që personat të mos i shmangen procesit të jashtëzakonshëm të verifikimit të figurës, duke refuzuar t’i nënshtrohen vetingut. Në mungesë të dorëheqjes formale, KPA-ja shqyrtoi rrethanat specifike të çështjes. Duke pranuar emërimin e tij dhe duke qëndruar në pozicionin e Sekretarit të Përgjithshëm, kërkuesi tregoi që me dëshirë kishte hequr dorë nga roli i tij si këshilltar ligjor, duke shkaktuar kështu ndërprerjen e procesit të vetingut. KPA-ja bëri dallimin ndërmjet rolit të tij të mëparshëm, që ishte subjekt i vetingut, dhe pozicionit të tij si Sekretar i Përgjithshëm, që ishte jashtë juridiksionit të tij. Ky dallim tregoi ndryshimin ndërmjet funksioneve që kërkojnë rivlerësimin e figurës dhe detyrave administrative. KPA-ja, pas një vlerësimi konkret, konkludoi që ndalimi nuk kishte shkaktuar dëm të rëndë dhe ishte në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

2. Vlerësimi i Gjykatës

17. Pasi gjeti që në këtë rast zbatohet neni 8 (shihni paragrafin 13 më sipër), Gjykata vlerëson që vendimi i KPA-së përbën ndërhyrje në të drejtën e kërkuesit për të respektuar jetën e tij private. Kjo ndërhyrje do të përbente shkelje të nenit 8 nëse nuk është në përputhje me ligjin, nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nuk është e nevojshme në një shoqëri demokratike.

18. Gjykata nuk ka nevojë të mbajë qëndrim të prerë nëse kërkuesi mund të kishte parashikuar mjaftueshëm që ecuria e brendshme në karrierë brenda sistemit të drejtësisë do të shkaktonte ndalimin 15-vjeçar. Sidoqoftë, ndërhyrja nuk ka treguar se është proporcionale me qëllimet legjitime të ndjekura në rrethanat e kësaj çështjeje.

19. Ndalimi rezultoi nga zbatimi automatik dhe disi i rreptë i rregullit të përjashtimit 15-vjeçar. Skema e dorëheqjes u krijua për të mos lejuar që personat që largohen nga një pozicion në sistemin e drejtësisë të kthehen më vonë aty dhe duke ju shmangur kështu procesit të vetingut, një qëllim që mund të konsiderohet legjitim në parim (shihni *Bala*, cituar më sipër, § 71). Megjithatë, zbatimi i asaj



skeme në këtë çështje kishte efektin e penalizimit të kërkuarit i cili, në mirëbesim të supozuar, kishte kërkuar ecure në karrierë brenda sistemit të drejtësisë (shihni paragrafin 13 më sipër).

20. Kohëzgjatja 15-vjeçare e ndalimit përbënte një kufizim të konsiderueshëm mbi të ardhmen profesionale të kërkuarit. Ndërsa në praktikë ndalimi kufizojë në disa pozicione të nivelit kushtetues, këto pozicione përbënin disa nga funksionet më të larta në gjyqësorin e vendit – sidomos në lidhje me pozicionet e hapura për magistratët jo të karrierës (shihni *Bala*, cituar më lart, § 62) – dhe përbënin një komponent të rëndësishëm të ecurisë profesionale brenda sistemit të drejtësisë. Kufizimi u zbatua për pjesën më të madhe të jetës aktive në punë që i kishte mbetur kërkuarit dhe ndikoi direkt në mundësitë e tij për karrierë dhe identitet profesional (shihni paragrafin 4 më sipër). Ndalimi hyri në fuqi ndërkohë që kërkuari vazhdonte të shërbente brenda sistemit të drejtësisë, duke krijuar kështu një pengesë të brendshme dhe të vazhdueshme. Në rrethanat specifike të çështjes, ky rezultat nuk ishte proporcional me qëllimin legjitim të ndjekur.

21. Nuk i takon Gjykatës të përcaktojë se si duhej të zgjidhej situata ose duke mos e përdorur ndalimin në çështjen e kërkuarit, duke e lejuar që t'i nënshtrohej vetëgjyqësorisë, ose duke gjetur zgjidhje alternative. Këto çështje janë kompetencë e autoriteteve kombëtare. Në këtë drejtim, mund të ketë rëndësi që, pavarësisht dallimeve në vetëgjyqësorin e magistratëve në detyrë, procedura e zhvilluar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi të përfshijë vlerësimin e saj për përshtatshmërinë, kualifikimet profesionale dhe figurën, bazuar në kritere ligjore dhe mekanizma të zgjeruar të verifikimit (shihni paragrafin 4 më sipër).

22. Prandaj në këto rrethana është gjetur shkelje e nenit 8 të Konventës.

ZBATIMI I NENEVE 46 DHE 41 TË KONVENTËS

I. KËRKESË PËR ÇAKTIMIN E NJË MASE PERSONALE

23. Gjykata ka gjetur shkelje të nenit 8 sepse rezultati i procesit të vetëgjyqësorisë nuk rezultoi proporcional me qëllimet legjitime të ndjekura. Në një kontekst të ngjashëm, Gjykata ka treguar që rihapja e procesit të vetëgjyqësorisë do të ishte e përshtatshme (shihni *Serdari kundër Shqipërisë* nr. 40662/19, §§ 144-45, 13 dhjetor 2022, dhe Rezoluta

CM/ResDH(2024)212). Mandatet e të dyja organeve të vetëgjyqësorisë kanë mbaruar tashmë. Neni 179/b § 8 i Kushtetutës rregullon shqyrtimin e proceseve në pritje ose të pazgjidhura pas përfundimit të këtyre mandateve. Nëse kërkuari e kërkon, do të ishte e përshtatshme rihapja e proceseve dhe rishqyrtimi i çështjes, në përputhje me kërkesat e nenit 8, siç tregohet në këtë vendim.

II. DËMI

24. Kërkuari pretendoi për kompensim në lidhje me dëmin jopasuror, që të vendosej nga Gjykata.

25. Qeveria e kundërshton pretendimin.

26. Nisur nga natyra e shkeljes së gjetur, Gjykata cakton për kërkuarin kompensimin në shumën prej 3.000 euro për dëmin jopasuror, plus çdo taksë që mund t'i ngarkohet kërkuarit.

III. KOSTO DHE SHPENZIME

27. Kërkuari pretendon për kosto dhe shpenzime pa dhënë specifikime. Duke ju referuar praktikës së saj (shihni *Serdari*, cituar më lart, § 152), Gjykata e refuzon këtë pretendim.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, UNANIMISHT,

1. *deklaron* të pranueshëm ankimin, në lidhje me të drejtën e kërkuarit për respektimin e jetës private;

2. *vendos* që është shkelur neni 8 i Konventës;

3. *Vendos*:

a) që shteti i paditur duhet t'i paguajë kërkuarit, brenda tre muajve, shumën 3,000 EUR (tre mijë euro), plus çdo taksë që mund t'i ngarkohet, në lidhje me dëmin jopasuror, që do të konvertohen në monedhën e Shtetit të paditur me kursin në fuqi në datën e shlyerjes;

b) që nga mbarimi i afatit tremujor të sipërpërmendur deri në shlyerje, të paguhet interes i thjeshtë për shumën e mësipërme sipas normës së njëjtë me normën marxhinale të kreditimit të Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagimit plus tre pikë përqindje;

4. *rrefuzon* pjesën tjetër të pretendimit të kërkuarit për kompensim të drejtë.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 25 gusht 2026, sipas Rregullit 77 §§ 2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

Olga Chernishova
ZËVENDËSKANCELARE

Diana Kovatcheva
KRYETARE



VENDIM
Nr. 30, datë 26.8.2026

PËR NJË NDRYSHIM NË
RREGULLOREN NR. 2, DATË 22.2.2018,
“PËR FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT
TË PROVIMEVE TË AFTËSIVE
PROFESIONALE DHE MBIKËQYRJES SË
PROCESIT TË TESTIMIT TË
KANDIDATËVE PËR AUDITUES LIGJOR
DHE KONTABILIST TË MIRATUAR TË
BORDIT TË MBIKËQYRJES PUBLIKE”,
TË NDRYSHUAR

Në zbatim të ligjit nr. 10091, datë 5.3.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, të ndryshuar; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 786, datë 9.11.2016, “Për procedurat e përzgjedhjes dhe rastet e shkarkimit të anëtarëve, si dhe rregullat e organizimit e të funksionimit të Bordit të Mbiqëqyrjes Publike”, Bordi i Mbiqëqyrjes Publike, në mbledhjen e tij, sipas rendit të ditës,

VENDOSI:

1. Në rregulloren nr. 2, datë 22.2.2018, “Për funksionimin e Komisionit të Provimeve të Aftësive Profesionale dhe mbiqëqyrjes së procesit të testimit të kandidatëve për auditues ligjor dhe kontabilist të miratuar të Bordit të Mbiqëqyrjes Publike”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

1.1 Në nenin 10, pika 5, shkronja “c”, të shfuqizohet.

2. Shfuqizimi i parashikuar në pikën 1.1 të këtij vendimi bëhet me qëllim harmonizimin e rregullores me parashikimet e nenit 15, pika 6, të ligjit nr. 10091, datë 5.3.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, të ndryshuar.

3. Rregullorja nr. 2, datë 22.2.2018, “Për funksionimin e Komisionit të Provimeve të Aftësive Profesionale dhe mbiqëqyrjes së procesit të testimit të kandidatëve për auditues ligjor dhe kontabilist të miratuar të Bordit të Mbiqëqyrjes Publike”, e ndryshuar sipas këtij vendimi, botohet në Fletoren Zyrtare.

4. Të ngarkojë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi strukturën mbështetëse të Bordit të

Mbiqëqyrjes Publike dhe strukturat përgjegjëse që preken nga kjo rregullore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare: Elira Hoxha
Anëtarë: Sanije Tafa, Dorida Marku, Lirim Sulaj, Enslemvera Zake

RREGULLORE
Nr. 2, datë 22.2.2018

PËR FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT
TË PROVIMEVE TË AFTËSIVE
PROFESIONALE DHE MBIKËQYRJES SË
PROCESIT TË TESTIMIT TË
KANDIDATËVE PËR AUDITUES
LIGJORË DHE KONTABILIST TË
MIRATUAR TË BORDIT TË
MBIKËQYRJES PUBLIKE

Ndryshuar me vendimin nr. 69, datë 16.10.2020, të
Bordit të Mbiqëqyrjes Publike.

Ndryshuar me vendimin nr. 9, datë 21.3.2024, të
Bordit të Mbiqëqyrjes Publike.

Kjo rregullore është hartuar në bazë të:

Nenit 5, pika 1, “a”, “b”, “h”, nenit 15, nenit 16, nenit 17, nenit 18, nenit 49, nenit 50 dhe nenit 51, të ligjit nr. 10 091, datë 5.3.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi dhe objekti i kësaj rregulloreje

1. Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e mënyrës së funksionimit të Komisionit të Provimeve të Aftësive Profesionale dhe mënyrës së mbiqëqyrjes së procesit të testimit dhe vlerësimit të kandidatëve për AL dhe KM.

2. Kjo rregullore parashikon edhe rregullat dhe kriteret e përgjithshme mbi bazën e të cilave përgatiten të gjitha, aktet, rregullat dhe vendimet që dalin në zbatim të kësaj rregulloreje nga BMP-ja, KPAP-ja, si dhe organizatat profesionale të parashikuara në dispozitat e kësaj rregulloreje.



3. Në këtë rregullore parashikohen, gjithashtu, rregullat e përgjithshme për mbikëqyrjen dhe rregullimin e procesit të testimit dhe certifikimit të kandidatëve për auditues ligjorë dhe kontabilist të miratuar.

Neni 2

Shkurtime dhe përkufizime

1. Shkurtime të përdorura në këtë rregullore kanë këto kuptime:

KPAP – Komisioni i Provimeve të Aftësive Profesionale;

BMP – Bordi i Mbikëqyrjes Publike;

SM – Struktura Mbështetëse e Bordit të Mbikëqyrjes Publike;

PTAP – Provimet Teorike të Aftësive Profesionale;

PPAP – Provimet Përfundimtare të Aftësive Profesionale;

KM – Kontabilist i Miratuar;

AL – Auditues Ligjor;

VKM – Vendim i Këshillit të Ministrave;

Institucion: Me termin institucion për qëllime të këtij ligji do të nënkuptohen organizatat profesionale (të audituesve ligjorë apo kontabilistëve të miratuar);

Person përgjegjës për mbikëqyrjen (PPM) – Është personi përgjegjës, i caktuar në përpunje me aktet rregullatore të miratuar nga BMP, i cili kryen funksionet e parashikuara në këtë rregullore;

Provimi për zhvillimin profesional: Është provimi vullnetar që japin KM-të për qëllim të njehsimit të kurrikulave me programet e reja të aprovuara për qëllime të ndryshme akademike apo për të vazhduar programin për KM;

Provimi përfundimtar: Për qëllime të kësaj rregulloreje termi “provimi përfundimtar” dhe “provime përfundimtare” janë sinonime të njëra-tjetres dhe nënkuptojnë PPAP-të;

Formati i përgjithshëm i tezës: Është formati i përgjithshëm i tezave të PPAP-ve në të cilin jepet informacion mbi numrin dhe formatin e pyetjeve dhe ushtrimeve, dhe kategorizimin sipas seksioneve. Në formatin e përgjithshëm jepet informacion edhe mbi numrin e pikëve të aplikuara për secilën pyetje dhe seksion. Formatin e përgjithshëm i tezës nuk përmban pyetje apo ushtrime konkrete por një përshkrim të përgjithshëm të natyrës së ushtrimit apo pyetjeve dhe referimit me kurrikulat përkatëse;

BSNEK – Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Edukimit Kontabël;

IFIAR – “*The International Forum of Independent Audit Regulators*” – Forumi Ndërkombëtar i Rregullatorëve të Pavarur të Kontrollit;

ACCA – “*The Association of Chartered Certified Accountants*” – Shoqata e Kontabilistëve të Certifikuar të Autorizuar;

IFAC – “*International Federation of Accountants*” – Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve;

OPAL – Organizata Profesionale e Audituesve Ligjorë;

OPKM – Organizata Profesionale e Kontabilistëve të Miratuar.

Specializime të lidhura me auditimin, kontabilitetin dhe financën: Me specializim për qëllime të kësaj rregulloreje do të përfshihen, si më poshtë (të paktën njëra prej tyre):

a) Certifikim/titull profesional brenda ose jashtë vendit në fushat e mësipërme;

b) Diplomë në fushat e mësipërme;

c) Master në fushat e mësipërme;

d) Kurs profesional që zotëron të paktën 20 kredite në fushat e mësipërme, të njohura ndërkombëtarisht ose nga institucioni vendor përkatës;

e) Eksperiencë profesionale prej së paku 5 vite të lidhura me fushat e mësipërme.

Faqe Elektronike e BMP-së: Për qëllime të kësaj rregulloreje me faqe elektronike do të nënkuptohet njëra ose të gjitha nga të mëposhtmet (kur është e mundur):

a) llogaria/faqja zyrtare;

b) mediat sociale në *Facebook*; *Twitter*;

c) adresat elektronike.

Ligji për auditimin: Ligji nr. 10091, datë 5.3.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

2. Të gjitha termat e përdorura në këtë rregullore janë të njëjta me ato të përdorura në nenin 2, të ligjit për auditimin.

3. Termat ose shkurtime të mësipërme mund të përdoren si zëvendësues të njëra-tjetres.



KREU II
ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I
KPAP-së

Neni 3

**Komisioni i Provimeve të Aftësive
Profesionale**

1. Për të realizuar testimet, në kuadrin e provimit përfundimtar të aftësive profesionale të kandidatëve për auditues ligjorë, pranë Bordit të Mbikëqyrjes Publike (BMP) ngrihet dhe funksionon Komisioni i Provimeve të Aftësive Profesionale (KPAP).

2. KPAP-ja përbëhet nga pesë anëtarë, të cilët emërohen nga BMP-ja për një periudhë katërvjeçare, sipas propozimeve të mëposhtme:

- a) kryetari nga ministri i Financave;
- b) dy anëtarë nga organizata profesionale e audituesve ligjorë;
- c) një anëtar nga organizmat profesionalë apo Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit;
- ç) një anëtar nga profesorati i fushës së universiteteve.

3. Përfaqësuesit e parashikuar në pikën 2, të këtij neni, duhet të kenë përfunduar, të paktën, studimet universitare të ciklit të dytë, në nivelin “Master” ose të zotërojnë diplomë universitare të ekuivalentuar me këtë nivel, si dhe të jenë specializuar në fushat e ekonomisë dhe/ose të jurisprudence, të cilat duhet të jenë të lidhura me auditimin, kontabilitetin dhe financën, me përvojë profesionale jo më të vogël se dhjetë vite, ose 7 vite përvojë pune, në rast se mbajnë një grade apo titull shkencor. Gjithashtu, përfaqësuesit e parashikuar në pikën 2 të këtij neni, duhet të:

- a) jenë shtetas shqiptarë;
- b) të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata;
- c) të mos kenë konflikt interesi me anëtarët e Bordit të Mbikëqyrjes Publike apo strukturat e mbikëqyrjes së veprimtarisë së komisionit;
- ç) të mos jenë të angazhuar në role apo funksione politike;
- d) të mos jenë në strukturat/këshillat drejtues të më shumë se një nga organet/institucionet/organizatat e parashikuara në ligjin nr. 10091/2009, që lidhen drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë me përzgjedhjen dhe veprimtarinë e KPAP-së.

4. Përveç kriterëve të mësipërme për përfaqësuesit e parashikuar në pikën 2 të këtij neni

do të konsiderohen preferenciale kriteret e mëposhtme:

a) të kenë eksperiencë në ligjërime apo trajnime profesionale në fushën e auditimit, kontabilitetit dhe financës;

b) të kenë publikime në revista shkencore, konferenca ose pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme kërkimore-shkencore së paku në 5 vitet e fundit në fushën e auditimit, kontabilitetit dhe financës.

5. Përfaqësuesit e parashikuar në germat “b” dhe “c”, të pikës 2 të këtij neni, që përmbushin kriteret e përcaktuara në pikën 3, kandidatët aplikojnë pranë institucioneve përkatëse, sipas rregulloreve të brendshme të funksionimit, të miratuara në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Propozimet, nga këto institucione, së bashku me dokumentacionin e kandidatëve dorëzohen pranë strukturës mbështetëse të BMP-së, sipas kërkesave të kësaj rregulloreje dhe kuadrit rregullator të miratuar nga BMP-ja. Këto institucione duhet të përfshijnë në listën e propozimeve të kandidatëve që plotësojnë kriteret, si dhe listën e plotë të të gjithë kandidatëve që kanë konkurruar.

6. Përfaqësuesit e parashikuar në germën “ç” aplikojnë drejtpërdrejtë pranë Bordit të Mbikëqyrjes Publike.

7. Kandidatët për anëtarë që i propozohen BMP-së nga institucionet, duhet të përzgjidhen prej tyre në një proces të hapur, transparent, gjithëpërfshirës, në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi. Dokumentacioni i përzgjedhjes ruhet pranë organizatës profesionale për të paktën tre vite, dhe është subjekt i mbikëqyrjes së BMP-së.

8. Bordi i Mbikëqyrjes Publike përzgjedh anëtarët, nga radhët e kandidatëve, në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje dhe dispozitat e statutit të BMP-së, duke konsideruar kriteret dhe përfaqësimin e profesionit kontabël.

9. Në rastin e pikës 2, germat “b” dhe “c”, institucionet njoftohen me shkresë e cila publikohet edhe në faqen elektronike të BMP-së. Në rastin e germës “ç”, njoftimi bëhet përmes njoftimit ose publikimit në faqen elektronike të BMP-së. Për përfaqësuesin e parashikuar në germën “a”, të pikës 2 të këtij neni, BMP-ja njofton me shkresë ministrin përgjegjës për financat.

10. Në rast se nuk janë respektuar kërkesat e kësaj rregulloreje, BMP-ja ka të drejtën të aplikojë masa



ndëshkimore ndaj institucioneve propozuese dhe personave përgjegjës, subjekt i mbikëqyrjes nga BMP-ja, të cilët nuk kanë respektuar këto kërkesa në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Në rast se evidentohen shkelje të kërkesave të kësaj rregulloreje, BMP-ja ka të drejtën t'i përjashtojë këto institucione nga e drejta e propozimit për një periudhë deri në 5 vite, duke lejuar aplikim të lirë të kandidatëve të këtyre institucioneve përmes një procedure të veçantë, e cila miratohet nga BMP-ja.

11. Përmes një procesi vlerësimi të dosjes së kandidatëve për t'u përzgjedhur si anëtarë të KPAP-së, BMP-a përzgjedh dhe emëron kandidatët fitues të propozuar nga institucionet e përcaktuara në germenat "c" e "ç", të pikës 2, me shumicë të thjeshtë të anëtarëve pjesëmarrës. Procesi i vlerësimit bëhet nga një komision "ad hoc" nga struktura mbështetëse që bën vlerësimin e aplikimeve dhe ia paraqet BMP-së për vendimarrje. Sistemi i vlerësimit miratohet me vendim të veçantë nga BMP-ja në momentin e shpalljes së vendeve vakante duke konsideruar kriteret e përcaktuara në këtë nen.

12. BMP-ja mund të lirojë nga detyra anëtarët e KPAP-së, nëse:

a) anëtari nuk paraqitet në mbledhje tre herë radhazi apo më shumë se shtatë mbledhje përgjatë vitit;

b) kur veprimet apo mosveprimet e tij kanë dëmtuar rëndë veprimtarinë dhe emrin e KPAP-së, BMP-së dhe profesionit të AL-së dhe KM-së;

c) janë shkelur procedurat e propozimit të parashikuara në këtë rregullore;

ç) kryen veprime të paligjshme apo që cenojnë rëndë imazhin e KPAP-së dhe BMP-së;

d) kur ka marrë më shumë se tre vërejte me shkrim nga kryetari i BMP-së për shkelje apo sjellje të papajtueshme me kuadrin rregullator në fuqi (në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje);

dh) kur nuk përmbush funksionet e parashikuara nga ligji dhe kjo rregullore;

e) përfshihet në veprime të dhunshme duke ushtruar forcë fizike;

ë) kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

f) ka konflikt interesi me funksionin e vet;

g) dorëhiqet apo vdes;

gj) kur nuk është më anëtarë ushtrues (aktiv) i organizatës profesionale apo nuk përfaqëson më institucionin që e ka propozuar;

h) në rast të shkeljeve etike pranë institucioneve ku ka aderuar më parë apo edhe shkeljeve etike gjatë angazhimit pranë BMP-së, në përputhje me kërkesat përkatëse në kodin e etikës së BMP-së dhe atij të IFAC-ut;

i) në rast mosdhënie informacioni apo mosdorëzim të dokumentacionit brenda afateve të parashikuara në këtë rregullore apo kur kërkohen nga kryetari apo drejtori ekzekutiv i BMP-së.

Në rastin e lirit të anëtarit të KPAP-së, sipas përcaktimeve të pikës 12, Bordi duhet të emërojë zëvendësuesin e tij, brenda një afati prej 30 (tridhjetë) ditësh pune, duke filluar nga data e marrjes së propozimit/aplikimit përkatës, në përputhje me procedurat e përzgjedhjes, të parashikuara në këtë nen. Në rastin e anëtarëve të ardhur sipas pikës 2, germenat: "b", "c", "ç", BMP-ja, nga lista e aplikimit/propozimit të ardhur zgjedh edhe anëtarët zëvendësues të cilët ushtrojnë kompetencat e anëtarit të liruar/pezulluar deri në përzgjedhjen e anëtarit të ri ose ndërprerjes së procesit të pezullimit.

13. Bordi i Mbikëqyrjes Publike mund të bëjë pezullimin e menjëhershëm të secilit prej anëtarëve në rastet, kur ndaj tyre:

a) konstatohet shkelje e kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi;

b) ka nisur proces investigimi, lidhur me veprimtarinë e tij që lidhet me ushtrimin e detyrës si anëtar i KPAP-së, të cilat cenojnë imazhin e KPAP-së dhe BMP-së;

c) përfshihet në konflikte të cilat përfshijnë dhunën fizike apo presionin verbal që vë në kërcënim jetën, pasurinë, punën apo karrierën e cilitdo personi, përgjatë ushtrimit të veprimtarisë së funksioneve të veta si anëtar i KPAP-së ose që lidhen me ushtrimin e veprimtarisë si anëtar i KPAP-së;

ç) në rast se anëtari është ushtrues i profesionit apo ka qenë më parë ushtrues i profesionit dhe nga procesi i kontrollit të cilësisë janë evidentuar gjetje të cilat, në përputhje me vendimin 39/2019, e kategorizojnë me notën D ose F, ose në rastet kur Komisioni i Investigimit ka rekomanduar masa disiplinore administrative;

d) në rast të indicieve për shkelje etike pranë institucioneve ku ka aderuar më parë apo edhe shkeljeve etike gjatë angazhimit pranë BMP-së, në përputhje me kërkesat përkatëse në kodin e etikës së BMP-së dhe atij të IFAC-ut;



e) për çdo rast tjetër që parashikohet nga kuadri rregullator në fuqi.

14. Nga momenti i pezullimit, anëtarit të pezulluar i njoftohet vendimi dhe i kërkohet informacion dhe evidencë mbështetëse për të verifikuar kushtet e papajtueshmërisë. Në rast se anëtari i pezulluar nuk depoziton informacionin dhe evidencat e kërkuara, brenda 10 ditësh kalendarike, atëherë bëhet shkarkimi/lirimi i tij. Në rast se nga verifikimi i këtyre evidencave konstatohet se ka shkelje atëherë anëtari shkarkohet.

Në rast të shkarkimit të anëtarit, sipas rasteve të parashikuara në pikat 12 dhe 14 të këtij neni, zgjedhja e anëtarit të ri bëhet në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje.

Neni 4

Kompetencat mbi organizimin dhe realizimin e procesit të provimeve

1. KPAP-ja merret me zbatimin e procedurave të testimit, në kuadrin e provimit përfundimtar të aftësive profesionale të kandidatëve që kanë përmbushur kërkesat e parashikuara në nenet 15, 16, 18, 49 dhe 50, të ligjit për auditimin, sipas ndarjes më poshtë:

1.1 Kandidati për kontabilist i miratuar duhet të plotësojë kërkesat në vijim:

a) të ketë zotësi për të vepruar;

b) të mos jetë dënuar penalisht ose me dënim plotësues, të natyrës që vë në dyshim ndershmërinë e tij;

b/1) të mos jenë në ndjekje penale nga prokuroria dhe/ose në gjykim për vepra penale;

c) të ketë përfunduar, të paktën, studimet universitare të ciklit të dytë në nivelin “Master” ose të zotërojë diplomë universitare të ekuivalentuar, ose ekuivalente me këtë nivel për çdonjërin nga degët e studimit në shkencat ekonomike, si: kontabilitet, financë, administrim biznesi, ekonomiks apo të barasvlershme me to;

ç) ka, të paktën, tre vite përvojë profesionale në fushën e kontabilitetit, të financës, kontrollit financiar dhe në fusha të ngjashme;

d) ka kryer kursin e kualifikimit në fushën e standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të kontabilitetit dhe raportimit financiar, të organizuar ose të monitoruar nga organizata profesionale e kontabilistëve të miratuar, e njohur nga BMP-ja, në

të cilën individi dëshiron të anëtarësohet, si dhe testimet përkatëse sipas kuadrit rregullator në fuqi.

1.2 Kandidati për auditues ligjor, me përjashtim të rasteve kur në ligjin për auditimin ose në këtë rregullore ose rregulloret dhe vendimet e tjera të miratuara nga BMP-ja, në përputhje me ligjin e auditimit parashikohet ndryshe, duhet të plotësojë kërkesat në vijim:

a) të ketë zotësi për të vepruar;

b) të mos jetë dënuar penalisht ose me dënim plotësues, të natyrës që vë në dyshim ndershmërinë e tij;

b/1) të mos jenë në ndjekje penale nga prokuroria dhe/ose në gjykim për vepra penale;

c) të ketë përfunduar, të paktën, studimet universitare të ciklit të dytë në nivelin “Master” ose të zotërojë diplomë universitare të ekuivalentuar, ose ekuivalente me këtë nivel për çdonjërin nga degët e studimit në shkencat ekonomike, si: kontabilitet, financë, administrim biznesi, ekonomiks apo të barasvlershme me to;

ç) të ketë kaluar me sukses të gjitha testet e parashikuara në programin e përgatitjes teorike profesionale, në përputhje me rregullat dhe procedurat e testimit, të propozuara nga organizata profesionale dhe të miratuara nga Bordi;

d) të ketë kryer gjysmën e praktikës profesionale, e cila zgjat në total 3 vite, në kushtet e punësimit me kohë të plotë në auditimin e pasqyrave financiare vjetore, individuale dhe/ose të konsoliduara ose pasqyrave financiare të tjera, të ngjashme, pranë një audituesi ligjor ose shoqërie auditimi të njohur në Republikën e Shqipërisë, që dallohet për reputacion të mirë dhe nën udhëheqjen e audituesve ligjorë që kanë garancitë e mjaftueshme për këtë qëllim. Të paktën dy të tretat e kësaj praktike profesionale duhet të kryhen pranë një audituesi ligjor ose një shoqërie auditimi të regjistruar në Republikën e Shqipërisë.

2. Rregullat, procedurat e testimit, sistemi i vlerësimit, formati i përgjithshëm i tezës (për PPAP-në), koha e provimit, për çdo disiplinë të parashikuar në nenin 18 të ligjit për auditimin, propozohen nga organizata e audituesve ligjorë, dhe miratohen nga BMP-ja, në përputhje me kriteret dhe dispozitat ligjore dhe nënligjore, duke mbajtur në konsideratë dhe pa rënë ndesh me rregulloret dhe vendimet e tjera të miratuara nga BMP-ja.

3. Programet e disiplinave të parashikuara në nenin 18 të ligjit, për PPAP-në, për provimet për



titullin e Audituesit Ligjor dhe për provimet për titullin Kontabilist i Miratuar, propozohen nga organizata profesionale e audituesve ligjorë, pasi ka shqyrtuar paraprakisht opinionin në formë të shkruar nga organizatat profesionale të kontabilistëve të miratuar, të njohur nga BMP-ja.

Propozimet e konsoliduara, të shoqëruara me relacionin përkatës, dorëzohen pranë BMP-së për t'u miratuar. Programet e disiplinave pasi të miratohen nga BMP-ja, duhet të publikohen të paktën 3 muaj përpara caktimit të datave të provimeve.

4. Propozimet e ardhura nga organizata profesionale e audituesve ligjorë, BMP-ja, në përputhje me këtë rregullore, mund t'i miratojë, t'i kthejë për rishqyrtim me sugjerime dhe komente të cilat janë të detyrueshme për t'u zbatuar ose t'i rishqyrtojë vetë, duke bërë ndryshimet në rast se janë të nevojshme e më pas t'i miratojë.

5. Sekretaria teknike për organizimin e provimit përfundimtar kryhet nga organizata profesionale e audituesve ligjorë, nën mbikëqyrjen e Bordit të Mbikëqyrjes Publike, sipas përcaktimeve dhe kërkesave të kësaj rregulloreje. Sekretaria teknike për organizimin e provimit përfundimtar ka vetëm kompetenca teknike të cilat janë të përcaktuara në dispozitat e kësaj rregulloreje, e cila mund të asistohet edhe nga struktura mbështetëse. Personat që angazhohen në sekretarinë teknike përzgjidhen nga këshilli i drejtimit të organizatës profesionale të audituesve ligjorë, të cilët mund të jenë ose jo pjesë e strukturës së përhershme administrative të saj.

6. Organizata profesionale e audituesve ligjorë duhet të sigurojë që ekipi i përfshirë në përgatitjen e propozimit për përgatitjen e rregullave dhe procedurave të testimit duhet të ketë nivelin e duhur profesional dhe akademik.

7. Për të garantuar mbarëvajtjen e procesit të testimit, KPAP-ja fillon procesin e përzgjedhjes së hartuesve dhe hartues rishikues, jo më vonë se 3 muaj përpara datës së testimit. Hartuesit depozitojnë fondin e pyetjeve pranë KPAP-së, të paktën 15 ditë përpara datës së provimit. Pyetjet përfshijnë një kombinim të pyetjeve me alternativa, pyetjeve të zhvillimit teorik dhe pyetjeve të tipit rast studimor. Dorëzimi i fondit të pyetjeve do të bëhet në zarf të mbyllur, në CD/USB të mbyllur e të nënshkruar në prani të KPAP-së. KPAP-ja përgatit testet e mundshme për provimin final nga fondi i pyetjeve të hartuesve në jo më pak se 3 versione të cilat i

dorëzohen rishikuesit/ve të tezës, jo më herët se pesë ditë para datës së provimit. Rishikuesi i cilësisë së tezës përgatit versionet e tij pranë ambienteve të BMP-së ose ambienteve të autorizuar nga BMP-ja me vendim të veçantë, me qëllim që të sigurohet integriteti i procesit. Rishikuesi i cilësisë së tezës bën vlerësimin e përmbajtjes së çdo pyetjeje të përfshirë në tezë, vlerëson kohën e nevojshme për të zgjidhur secilën nga këto teza dhe modifikon jo më pak se 15% dhe jo shumë se 30% të pyetjeve/ushtrimeve të tezës. Këto ndryshime duhet të kenë karakter cilësor dhe ta bëjnë tezën më të plotë dhe më përfshirëse në raport me programin. Gjithashtu, rishikuesi i cilësisë së tezës mund të modifikojë pjesërisht pyetjet dhe ushtrimet për të gjithë tezën pa prekur përmbajtjen kryesore dhe strukturën, me qëllim garantimin e konfidencialitetit dhe cilësisë. Të gjitha versionet e tezave i dorëzohen KPAP-së, jo më herët se 4 orë nga nisja e provimit përfundimtar në një zarf, në CD/USB të mbyllur e të nënshkruar në prani të KPAP-së.

7.1 Pyetjet e hartuara dhe të përzgjedhura për përdorim në provim, të cilat janë vlerësuar nga hartuesi rishikues si të vlefshme për përdorim të mëvonshëm me aprovim të KPAP-së ose Komisionit të Rishikimit do të transferohen në fondin e pyetjeve në formën e fondit shtesë të pyetjeve, për t'u konsideruar si bazë për t'u përdorur në sezonet e mëpasshme me kushtin që mos të ketë element përsëritës me tezat e kryera në periudhat e mëparshme. Për fondin e pyetjeve për përdorim të mëpasshme do të zbatohen të njëjtat masa mbi sigurinë dhe ruajtjen e përmbajtjes, si për pyetjet pjesë të fondit të pyetjeve të PPAP-së.

8. KPAP-ja miraton vlerësimin përfundimtar të kandidatëve dhe bën publikimin e rezultateve në përputhje me këtë rregullore.

9. Personi përgjegjës për mbikëqyrjen ndjek të gjithë procesin e organizimit të testimit, procesin e korrigjimit dhe vlerësimit, duke qenë i pranishëm në të gjitha proceset që marrin pjesë dhe përfshihen anëtarët e KPAP-së dhe sekretaria teknike.

Neni 4/1

Rishikimi i cilësisë së procesit të provimit të aftësive profesionale

1. Bordi i Mbikëqyrjes Publike, për të mundësuar një proces cilësor në hartimin, korrigjimin dhe rishikimin, ngre pranë tij komisionin për rishikimin



e cilësisë së procesit të testimeve, me mandat 4-vjeçar.

2. Komisioni i rishikimit përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë profesionistë:

a) 2 (dy) ndër të cilët të jenë juristë, të cilët duhet të plotësojnë kërkesat, si më poshtë:

- të jetë shtetas shqiptar;
- të zotërojë diplomë “Master i Shkencave” ose “Master i Arteve” apo të barasvlershme me to, si dhe titullin, sipas legjislacionit të arsimit të lartë;
- të ketë mbi 7 vite përvojë pune në fushën përkatëse;
- të ketë njohuri të mira të legjislacionit, të lidhur me fushën dhe kuadrit rregullator të BMP-së;
- të mos jetë dënuar penalisht ose me dënim plotësues, të natyrës që vë në dyshim ndershmërinë e tij;

b) 3 (tre) prej anëtarëve do të përzgjidhen nga profesionistë të fushës së kontabilitetit, auditimit, fiskale, e të menaxhimit që plotësojnë kërkesat, si më poshtë:

- të jetë shtetas shqiptar;
- të zotërojë diplomë “Master i Shkencave” ose “Master i Arteve” apo të barasvlershme me to, si dhe titullin, sipas legjislacionit të arsimit të lartë;
- të ketë mbi 7 vite përvojë pune në fushën përkatëse;
- të ketë njohuri të mira të legjislacionit të lidhur me fushën dhe kuadrit rregullator të BMP-së;
- të mos jetë dënuar penalisht ose me dënim plotësues, të natyrës që vë në dyshim ndershmërinë e tij.

3. Komisioni i Rishikimit ka kompetencat, si më poshtë:

- të verifikojë hartuesit dhe korrigjuesit që propozohen nga KPAP-ja në përputhje me këtë rregullore;
- të verifikojë rishikuesit e cilësisë së hartimit të tezës që propozohen nga KPAP-ja, në përputhje me këtë rregullore që do të kontrollojnë cilësinë e fondit të pyetjeve të përgatitura nga hartuesit;
- të verifikojë rikorrigjuesit që propozohen nga KPAP-ja në përputhje me këtë rregullore që do të angazhohen për të rishikuar rastet e fletoreve të korrigjuara për të gjitha diferencat mbi 5% të pikëve, që rrjedhin nga procesi i korrigjimit të dy grupeve paralele të korrigjuesve.

4. Shkarkimi i anëtarit të komisionit të rishikimit bëhet sipas të njëjtave dispozita që aplikohen për shkarkimin/lirimin e anëtarit të KPAP-së.

Neni 5

Kandidatët për hartues dhe korrigjues

1. KPAP-ja përzgjedh dhe përcakton numrin e nevojshëm të hartuesve, rishikuesve dhe korrigjuesve dhe rikorrigjuesve. Përzgjedhja bëhet në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje.

2. Kriteret që duhet të plotësojnë hartuesit, hartuesit rishikues dhe korrigjuesit, dhe rikorrigjuesit janë, si më poshtë:

a) Hartuesit duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme në përputhje me kurrikulën në të cilën do të angazhohen:

i. diplomë “Master i Shkencave” ose “Master i Arteve” apo të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë dhe 7 vite përvojë pune në fushën përkatëse; ose

ii. gradë apo titull shkencor apo të barasvlershme me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë dhe minimalisht 5 vite përvojë pune në fushën përkatëse;

iii. si dhe përveç pikës “i” ose pikës “ii”, aftësi për të hartuar teste dhe aftësi për të hartuar dhe zgjidhur në mënyrë pragmatike rastet studimore;

b) Hartuesit rishikues duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme në përputhje me kurrikulën në të cilën do të angazhohen:

i. diplomë “Master i Shkencave” ose “Master i Arteve” apo të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë dhe 7 vite përvojë pune në fushën përkatëse; ose

ii. gradë apo titull shkencor apo të barasvlershme me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë dhe minimalisht 5 vite përvojë pune në fushën përkatëse;

iii. si dhe përveç pikës “i” ose pikës “ii”, aftësi për të hartuar teste dhe aftësi për të hartuar dhe zgjidhur në mënyrë pragmatike rastet studimore;

c) Korrigjuesit duhet të plotësojnë të paktën kërkesat e mëposhtme:

i. diplomë “Master i Shkencave” ose “Master i Arteve” apo të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë;

ii. mbi 5 vite përvojë pune në fushën përkatëse;

iii. njohuri të mira të standardeve profesionale dhe/ose kuadrit rregullator të lidhur me fushën në të cilën do angazhohen si hartues dhe korrigjues dhe të kenë përvojë praktike lidhur me fushën përkatëse;

d) Rikorrigjuesit duhet të plotësojnë të paktën kërkesat e mëposhtme:



i. diplomë “Master i Shkencave” ose “Master i Arteve” apo të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë;

ii. mbi 5 vite përvojë pune në fushën përkatëse;

dh) Njohuri të mira të standardeve profesionale dhe/ose kuadrit rregullator të lidhur me fushën në të cilën do angazhohen si hartues dhe korrigjues, dhe të kenë përvojë praktike lidhur me fushën përkatëse.

3. Anëtarët e KPAP-së përjashtohen nga e drejta për të qenë hartues, rishikues, korrigjues apo rikorrigjues.

4. Çdo kandidat që aplikon për hartues, hartues rishikues, korrigjues dhe rikorrigjues duhet të paraqesë zyrtarisht dokumentacionin e mëposhtëm pranë sekretarisë teknike të KPAP-së, si dhe një kopje e cila vihet në dispozicion të strukturës mbështetëse të BMP-së:

a) kërkesë me shkrim për pozicionin që po aplikon;

b) *curriculum vitae*;

c) referencë ose dokument zyrtar për të vërtetuar përvojën në fushën përkatëse për të cilën po aplikon;

d) fotokopje të diplomave;

e) shfuqizohet;

f) certifikatën e gjendjes gjyqësore (informacion për rekorde penale).

5. KPAP-ja, në përfundim të procedurave të përzgjedhjes, pas verifikimit nga Komisioni i Rishikimit, miraton listën e hartuesve, hartuesit/ve rishikues dhe korrigjuesit, dhe rikorrigjuesit që plotësojnë kriteret, në përputhje me pikën 2 të këtij neni, të kësaj rregulloreje.

6. Komisioni i Rishikimit, përveçse bën verifikimet për të gjithë kandidatët për hartues, hartuesit rishikues dhe korrigjuesit, dhe rikorrigjuesit, në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje, për të garantuar një përzgjedhje sa më cilësore dhe në rast se konstaton parregullsi ose papajtueshmëri apo në rast se kandidatët nuk plotësojnë kriteret, bën skualifikimin e tyre duke kërkuar propozime shtesë.

7. Përzgjedhja e hartuesve, hartuesve rishikues, korrigjuesve dhe rikorrigjuesve duhet të garantojë objektivitetin e procesit, duke nënvizuar shmangien e konfliktit të interesit midis tyre dhe mospërfshirjen në më shumë se një proces në të njëjtin provim.

8. Të gjithë hartuesit, hartuesit rishikues, korrigjues dhe rikorrigjuesit e provimeve përfundimtare mund t'i nënshtrohen trajnimit.

Programin e trajnimit dhe trajnimin e organizon KPAP-ja nën mbikëqyrjen e BMP-së.

Neni 6

Mbledhja dhe pagesat e anëtarëve të KPAP-së

1. KPAP-ja do të mbledhet së paku 12 herë në vit.

2. KPAP-ja përgatit një plan vjetor pune ku specifikohen edhe mbledhjet e planifikuara përgjatë vitit, të cilin ia kalon për miratim BMP-së, në përputhje me nenin 4 të kësaj rregulloreje.

3. Mbledhja e KPAP-së mund të bëhet edhe jashtë planit vjetor, në raste të jashtëzakonshme, me kushtin që ato të aprovohen nga BMP-ja.

4. Me propozim të organizatës profesionale të audituesve ligjorë, njëri nga anëtarët e propozuar sipas pikës 2 (b), të nenit 3, përzgjidhet nënkryetar.

5. Mbledhja e KPAP-së thirret dhe drejtohet nga kryetari, jo më herët se 24 orë para saj. Në mungesë të kryetarit dhe me autorizim të tij, mbledhjet mund të drejtohen nga nënkryetari, të cilit i delegohen nga kryetari të drejtat e tij të parashikuara në këtë rregullore. Mbledhjet e KPAP-së mund të thirren dhe jashtë Planit Vjetor të Punës me kërkesë të BMP-së.

6. Mbledhjet e KPAP-së janë të vlefshme kur në to marrin pjesë jo më pak se katër anëtarë. Nëse njëri nga anëtarët mungon në tre mbledhje radhazi, të paarsyetuara (përgjashtimisht rastet e shërbimeve jashtë shtetit dhe sëmundjet) propozohet zëvendësimi i tij brenda sezonit. Për ditët e mungesave me dhe pa arsye nuk kryhet pagesë. Vendimet janë të vlefshme, kur votojnë “pro” shumica e anëtarëve pjesëmarrës. Në rast të numrit të barabartë të votave “pro” dhe “kundër”, vota e kryetarit të KPAP-së konsiderohet përcaktuese. Vendimet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët pjesëmarrës. Ato duhet të jenë të argumentuara dhe në çdo rast, votat “kundër” duhet të shpjegohen në procesverbalin e mbledhjes. Në raste emergjence apo të kushtëzuara nga rrethana objektive, KPAP-ja mund të marrë edhe vendime qarkulluese.

7. Vendimet e KPAP-së përgatiten në tre kopje, të cilat dy kopje mbahen në sekretarinë teknike të KPAP-së dhe një kopje pranë strukturës mbështetëse të BMP-së. Sekretaria teknike e KPAP-së që angazhohet pranë BMP-së mban protokoll të posaçëm për veprimtarinë në lidhje me KPAP-në.



8. Mbledhja e Komisionit konsiderohet e vlefshme kur ka rend dite të përcaktuar, të hartuar nga kryetari, e cila procedon me vendimmarrje për të gjitha çështjet e parashikuara në rendin e ditës. Me miratimin e datave të testeve, në kuadër të provimit përfundimtar të aftësive profesionale, KPAP-ja nuk mund të shqyrtojë dhe të marrë vendime në lidhje me pezullimin/anulimin e realizimit të procesit të testeve, me përjashtim të rasteve kur me ligj ose akt normativ, për shkak të situatës së jashtëzakonshme, parashikohet ndryshe. Në çdo rast, një vendim i tillë miratohet nga BMP-ja. BMP-ja mund të kërkojë përfshirjen në rend dite të KPAP-së edhe çështje të cilat mund të konsiderohen të nevojshme të shqyrtohen nga KPAP-ja.

9. Materialet që do të shqyrtohen në mbledhje u shpërndahen paraprakisht anëtarëve nga sekretaria teknike. Të gjitha materialet i dorëzohen njëkohësisht edhe personit përgjegjës për mbikëqyrjen.

10. KPAP-ja i zhvillon mbledhjet pranë ambienteve të BMP-së ose ambienteve të autorizuar nga BMP-ja me vendim të veçantë me kushtin që të sigurohet integriteti i procesit.

11. Miratimi i pagesave për anëtarët e KPAP-së, të propozuara nga këshilli drejtues i organizatës profesionale, do të bëhet me vendim të veçantë, të miratuar nga BMP-ja për referencat e pagave të komisionit të KPAP-së dhe buxhetit të funksionimit të KPAP-së. Pavarësisht volumit të punës apo mënyrës së shpërndarjes së kohës, anëtarët e KPAP-së do të paguhen jo më shumë se 40 mbledhje përgjatë një sezoni të plotë provimesh.

Neni 7

Buxheti dhe tarifat e regjistrimit

1. Kostot e administrimit të veprimtarisë së KPAP-së mbulohen nga tarifat e regjistrimit të kandidatëve që testohen në përputhje me rregulloren për mbledhjen e të ardhurave të miratuar nga BMP-ja. Tarifat e regjistrimit të arkëtuara janë të pakthyeshme. Kandidatëve që kanë kryer pagesat dhe për arsye të ndryshme nuk janë paraqitur në testim, pagesa i njihet vetëm për sezonin e menjëhershëm pasardhës.

2. Personat që angazhohen si vëzhgues, hartues, hartues rishikues, korrigjues, korrigjues rishikues, në procesin e rishikimit, si dhe personeli tjetër ndihmës

marrin honorare, masa e të cilave miratohet nga BMP-ja në përputhje me procedurat e pikës 3 të këtij neni.

3. Sekretaria teknike e KPAP-së përgatit një preventiv, lidhur me shpenzimet e nevojshme për procesin e organizimit dhe realizimit të provimeve. Mbi bazën e të dhënave të siguruara dhe me propozim të strukturës përgjegjëse për financën, BMP-ja shqyrton dhe miraton këtë preventiv shpenzimesh në përputhje me referencat maksimale miratuar prej tij, për çdo sezon, 10 ditë pas shpalljes së listës së aplikantëve nga KPAP-ja, por jo më vonë se 2 javë përpara provimit të parë. Pas miratimit të këtij preventivi nga BMP-ja, ngarkohet struktura përgjegjëse për financën të ndjekë zbatimin e tij. Në varësi të numrit të kandidatëve të regjistruar dhe me kërkesë të strukturës së BMP-së, Bordi mund të rishikojë preventivin e miratuar.

4. Struktura përgjegjëse për financën pranë BMP-së mban regjistrime të veçanta të arkëtimeve dhe pagesave që lidhen me veprimtarinë e KPAP-së. Në përfundim të procesit të testimit të kandidatëve, SM-ja i paraqet BMP-së një raport financiar ku evidentohen arkëtimet, shpenzimet e kryera për testimin e kandidatëve dhe tepricat e mbetur ose diferencat e pambuluar.

5. Shpenzimet e lidhura me procesin e provimeve, sipas preventivit të miratuar nga BMP-ja, kryhen në përputhje me rregulloren për të ardhurat miratuar nga BMP-ja.

KREU III

MBIKËQYRJA E FUNKSIONIMIT TË KPAP-SË DHE PROCESIT TË CERTIFIKIMIT

Neni 8

Mbikëqyrja e funksionimit të KPAP-së

1. Për të realizuar procesin e mbikëqyrjes, të funksionimit dhe organizimit të KPAP-së, si dhe procesit të organizimit të provimit përfundimtar, BMP-ja cakton një person përgjegjës për mbikëqyrjen (PPM) pranë KPAP-së, i cili do të mbikëqyrë procesin e organizimit të provimeve përfundimtare të aftësive profesionale të kandidatëve për AL dhe KM.

2. Sekretaria teknike e KPAP-së do të mbikëqyrë nga PPM-ja për çdo informacion apo dokumentacion, apo dosje të dorëzuar pranë KPAP-së apo të ardhur pranë saj, lidhur me të gjithë



procesin e organizimit të testimi. PPM-ja është i detyruar të raportojë pranë BMP-së, në lidhje me veprimtarinë e KPAP-së, nëpërmjet një raporti përmbledhës.

3. PPM-ja merr pjesë në çdo mbledhje të KPAP-së.

4. Në rast se përgjatë procesit të mbledhjes së anëtarëve të KPAP-së vëren se ka çështje të cilat bien ndesh me këtë rregullore apo me ligjin, apo me çdo vendim të nxjerrë nga BMP-ja, përmes një raporti PPM-ja informon, brenda 5 ditëve pune, anëtarët e BMP-së. BMP-ja mbledhet brenda jo më pak se 5 ditëve pune për të shqyrtuar problematikën në fjalë. Vendimi i marrë nga BMP-ja konsiderohet përfundimtar. Ky vendim iu vihet në dijeni anëtarëve të KPAP-së dhe bëhet i zbatueshëm menjëherë nga momenti i marrjes së tij.

5. PPM-ja përgjatë kryerjes së funksioneve të përcaktuara në këtë rregullore mbështetet nga struktura mbështetëse në logjistikë apo burime njerëzore, nëse kërkohet.

6. BMP-ja mund të kërkojë pavlefshmërinë e çdo vendimi të marrë nga KPAP-ja në rastet kur gjykon se vendimi bie ndesh me këtë rregullore, çdo rregullore tjetër apo vendim të dalë prej BMP-së, apo bie ndesh me ligjin për auditimin.

7. PAGESA E PERSONIT PËRGJEGJËS PËR MBIKËQYRJEN DO TË BËHET NË PËRPUTHJE ME RREGULLOREN E FUNKSIONIMIT TË STRUKTURËS MBËSHTETËSE. Emërimi bëhet në përputhje me dispozitat statutoire të BMP-së. Në rregulloren e funksionimit të strukturës mbështetëse, përveç detyrave të parashikuara në këtë rregullore për PPM-në, mund të përcaktohen edhe detyra të tjera shtesë.

8. Për të gjitha çështjet e tjera të cilat nuk janë parashikuar në këtë nen, PPM-ja ndjek zbatimin e kësaj rregulloreje dhe informon BMP-në përmes një raporti të hollësishëm mbi problematikën dhe zbatimin e saj.

9. Në raste të jashtëzakonshme, të cilat lidhen me ngjarje që cenojnë rëndë reputacionin e KPAP-së, BMP-së apo imazhin e profesionit, BMP-ja, e cila mund të jetë vënë në dijeni nga personi përgjegjës për mbikëqyrjen apo nga burime të tjera alternative dhe mund të kërkojë pezullimin e procesit, dhe shqyrtimin e çështjes në BMP. Anëtarët e BMP-së në rastin e vënies në dijeni nga burime alternative vënë menjëherë në dijeni kryetarin, i cili duhet të bëjë thirrjen e BMP-së në përputhje me kërkesat statutoire të BMP-së.

10. Përveç PPM-së, si dhe strukturës mbështetëse, çdo anëtar i BMP-së mund të jetë prezent për të vëzhguar procesin e kryerjes së provimeve.

Neni 9

Provimi i aftësive profesionale

1. Për të kryer testimet, në kuadrin e provimit përfundimtar të aftësive profesionale (PPAP), kandidatët duhet t'i drejtojnë kërkesë me shkrim, së bashku me dokumentacionin mbështetës, Komisionit të Provimeve të Aftësive Profesionale (KPAP). Kërkesa depozitohet në dy kopje. Origjinali së bashku me dokumentacionin mbështetës pranë sekretariatit teknik të KPAP-së ndërsa një kopje e kërkesës, së bashku me mandatin e bankës (që dëshmon pagesën e aplikimit për regjistrim) pranë Bordit të Mbikëqyrjes Publike, të cilat depozitohen pranë strukturës mbështetëse të BMP-së. Kërkesa duhet të përmbajë informacion mbi të gjithë listën e dokumenteve të dorëzuara në dokumentacionin e aplikimit që tregojnë përmbushjen ose jo të kërkesave ligjore të renditura në nenin 4 të kësaj rregulloreje ose të tregojë që kandidati ka përmbushur të drejtën e përjashtimit nga kryerja e praktikës profesionale. Vetëm pasi është kryer pagesa e regjistrimit aplikantit i lind e drejta për t'u konsideruar kandidat. Procesi i regjistrimit në provime bëhet në përputhje me këtë rregullore.

2. Sekretaria teknike e KPAP-së përpunon të gjitha kërkesat e grumbulluara dhe përgatit listën e të gjithë kandidatëve, shoqëruar me informacion në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar nga secili kandidat. Sekretaria teknike duhet të dorëzojë pranë KPAP-së, brenda 3 ditëve pune pas përfundimit të afatit zyrtar të aplikimit, një listë përmbledhëse të të gjithë aplikantëve dhe dokumentacionin përkatës të secilit. KPAP-ja, si dhe personi përgjegjës për mbikëqyrjen kanë të drejtën që të kërkojnë dosjen së bashku me çdo evidence të grumbulluar për secilin nga kandidatët nëse është e nevojshme ose në rast se ka ankim nga kandidatët përgjatë procesit.

3. Sekretaria teknike ka për detyrë të pranojë dhe të ruajë të gjitha aplikimet e bëra nga kandidatët për AL dhe kandidatët për KM, në përputhje me këtë rregullore, si dhe në përputhje me të gjitha aktet e miratuara nga BMP-ja. Detyrat e sekretarisë teknike të KPAP-së janë vetëm teknike dhe organizative



brenda tagrave të përcaktuara nga kuadri i zbatueshëm rregullator i BMP-së.

4. Të gjitha kërkesat e grumbulluara, së bashku me evidencat origjinale do të jenë subjekt i mbikëqyrjes lidhur me pajtueshmërinë e dokumentacionit të kandidatëve. Personi përgjegjës për mbikëqyrjen, si dhe çdo anëtar i BMP-së, në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje mund të jenë prezent në hapjen e kërkesave dhe dosjeve origjinale nga sekretaria teknike.

5. KPAP-ja shpall listën e plotë të kandidatëve për të hyrë në provimet e PPAP-së deri në një muaj, përpara datës së provimit të parë. Procesi i regjistrimit fillon të paktën një muaj përpara shpalljes së listës së aplikantëve. Të gjithë kandidatët për AL dhe KM kanë të drejtën të aplikojnë për t'u regjistruar në secilin provim të parashikuar në gërmat "a", "b" dhe "c", të nenit 9, pika 12 të kësaj rregulloreje, pavarësisht rezultatit të provimit paraardhës. Gjithashtu, kandidatët për AL nëse kanë mbyllur me sukses provimet e mësipërme kanë të drejtën të futen në provimet pasardhëse dhe kanë të drejtën të aplikojnë për t'u regjistruar në secilin provim pavarësisht rezultatit të provimit paraardhës.

6. Përpara se të marrin pjesë në testimet e parashikuara në kuadrin e provimit përfundimtar të aftësive profesionale (PPAP) kandidatët për AL (me përjashtim të rasteve të parashikuara ndryshe në ligj dhe në këtë rregullore) duhet të provojnë se kanë kaluar me sukses të gjitha provimet teorike e aftësive profesionale (PTAP) që përfshihen në programin e miratuar nga organizata profesionale e audituesve ligjorë, të hartuar sipas kërkesave të pikave 2 e 3, të nenit 18 të ligjit për auditimin.

7. Evidencat e lidhura me pikën 6 të këtij neni duhet të dorëzohen në dosjen e regjistrimit së bashku me dokumentet e tjera, në përputhje me pikën 1 të këtij neni.

8. Për të gjitha ato disiplina, që nuk janë trajtuar nga institucionet përkatëse të arsimit të lartë, organizohen provime të veçanta nga organizata profesionale e audituesve ligjorë, në bashkëpunim me institucionet e arsimit të lartë, me të cilat ajo ka nënshkruar marrëveshje.

9. Në rastet kur:

a) organizata profesionale e audituesve ligjorë nuk ka nënshkruar një marrëveshje me institucionet e arsimit të lartë; apo

b) institucionet e arsimit të lartë nuk përgjigjen ndaj kërkesës për bashkëpunim;

c) në raste të ndryshmeve në kurrikulat e institucioneve të arsimit të lartë; apo

ç) ndryshimeve të konsiderueshme të përmbajtjes së programit të përgatitjes profesionale, organizata profesionale e audituesve ligjorë mund t'i organizojë këto teste e vetme, me kushtin që procesi i organizimit të testimit të garantojë standarde të njëjta, si dhe vë në dijeni BMP-në për zhvillimin e këtyre testeve.

10. BMP-ja mund të mbikëqyrë procesin e provimeve të parashikuar në pikën 5, 6, 7, 8, dhe 9 të këtij neni, duke kontrolluar dosjet e kandidatëve, si dhe përmes mundësisë së pjesëmarrjes përmes një përfaqësuesi nga struktura mbështetëse ose personi përgjegjës për mbikëqyrjen, në procesin e kryerjes së testimit, si dhe duke shqyrtuar të gjithë procesin e organizimit dhe kryerjes së testimit dhe procesit të vlerësimit.

11. Mënyra e mbikëqyrjes së realizimit të provimeve teorike të parashikuara në pikën 6, 8 dhe 9 të këtij neni përcaktohet me vendim të veçantë të BMP-së.

12. Provimi përfundimtar i aftësive profesionale garanton shkallën e nevojshme të njohurive teorike rreth disiplinave që lidhen me auditimin ligjor dhe aftësinë për të vënë në praktikë njohuri të tilla. Ai realizohet nëpërmjet jo më pak se 4 testeve me shkrim dhe përfshin vlerësimin e aftësive të kandidatëve për auditues ligjorë për të zbatuar në praktikë e për të bërë gjykime profesionale në një shkallë të avancuar, në fushat e mëposhtme:

a) raportimi dhe përgatitja e pasqyrave financiare, sipas standardeve kombëtare e ndërkombëtare të raportimit financiar;

b) zbatimi në praktikë i legjislacionit mbi të drejtën civile, të drejtën penale, legjislacionit tregtar dhe të drejtën e punës në Republikën e Shqipërisë, në masën që këto i interesojnë profesionit të auditimit ligjor të pasqyrave financiare;

c) zbatimi në praktikë i kërkesave të legjislacionit të tatimeve dhe taksave në Republikën e Shqipërisë;

ç) zbatimi në praktikë i kërkesave të etikës profesionale dhe procedurat e punës për auditimin e pasqyrave financiare, sipas kërkesave të standardeve ndërkombëtare të auditimit;

d) zbatimi i modeleve të duhura të organizimit, drejtimit, qeverisjes dhe kontrollit të brendshëm të njësisë ekonomike të biznesit (personave juridikë);

dh) përdorimi i sistemeve të informacionit dhe të informatikës.



13. Testimet, në kuadër të provimit përfundimtar të aftësive profesionale (PPAP), zhvillohen të paktën një herë në vit në datat e miratuara nga KPAP-ja. BMP-ja, me propozim të KPAP-së, përmes një vendimi, mund të përcaktojë që testimet në kuadër të provimit përfundimtar të aftësive profesionale për kandidatët për AL ose për kandidatët për KM, ose për të dy bashkë të zhvillohen edhe më shumë se një herë në vit, por jo më tepër se tre herë.

14. Kandidatët që kanë fituar titullin “Kontabilist i miratuar”, pasi kanë kaluar testet e provimit përfundimtar të aftësive profesionale, që parashikohen në shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të pikës 12 të këtij neni, kalojnë drejtpërdrejt në testet e disiplinave të tjera të provimit përfundimtar të aftësive profesionale, të parashikuara në shkronjat “ç”, “d”, dhe “dh”, të pikës 12, të këtij neni, nëse kanë plotësuar kërkesat e parashikuara në nenet 4 dhe 10 të kësaj rregulloreje, si dhe me kushtin që programi i provimeve të dhëna, të përcaktuara në pikën 12 të këtij neni, nuk kanë pësuar ndryshime të konsiderueshme, për shkak të ndryshimeve thelbësore të legjislacionit, standardeve apo për shkak të ndryshimeve thelbësore të përmbajtjes së tyre të përfshira në këto nënndarje.

15. Shtetasit shqiptarë apo të huaj, të cilët kanë kaluar një provim universitar apo ekuivalent ose kanë një diplomë universitare apo kualifikim ekuivalent në një apo më shumë nga disiplinat e përcaktuara në pikën 6 të këtij neni, që kandidojnë për AL, mund të përjashtohen nga testimi i aftësive teorike profesionale (PTAP) për disiplinat e mbuluara nga këto provime ose diploma në rast se janë në përputhje me programin e përgatitjes profesionale të organizatës profesionale të audituesve ligjorë dhe miratuar nga BMP-ja.

16. Për shtetasit e huaj apo audituesit ligjorë të huaj BMP-ja mund të miratojë tarifa të ndryshme nga ato të parashikuara në rregulloren për mbledhjen e të ardhurave, lidhur me testimet e PPAP-ve sipas parimeve të reciprocitetit.

17. Të gjithë AL-të që janë certifikuar përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 47/2016 dhe që plotësojnë kërkesat e pikave 19 dhe 20 të këtij neni, kanë të drejtën të njehsojnë/ekuivalentojnë kurrikulat me programet e reja. Njehsimi propozohet nga KPAP-ja dhe miratohet nga BMP-ja me kërkesë të çdo të interesuari i cili zotëron titullin e Ekspertit Kontabël të Regjistruar (Audituesit Ligjor) pavarësisht nëse është pjesë e regjistrit publik ose jo. Një kopje e

vendimit i çohet KPAP-së dhe organizatës profesionale të audituesve ligjorë për të bërë njehsimin.

18. Njehsimi i kurrikulave bëhet vetëm për qëllime profesionale brenda apo jashtë vendit të të interesuarve, por në asnjë rast pa prekur të drejtën e ushtrimit të profesionit apo të drejtat dhe detyrimet që lindin prej ligjit. Pas njehsimit, AL-ja do të pajiset me formatin e ri të certifikatës dhe licencës, si dhe me një program lëndësh të zbërthyer sipas programit të ri.

19. Të gjithë Ekspertet Kontabël të Regjistruar (Audituesit Ligjorë) që kanë fituar titullin përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, të cilët kanë shlyer të gjitha detyrimet financiare ndaj organizatës profesionale përkatëse, si dhe BMP-së, iu lind e drejta e njehsimit në mënyrë të menjëhershme.

20. Për njehsimin e kurrikulave paguajnë një tarifë, e përcaktuar me vendim të BMP-së dhe derdhet në llogaritë e BMP-së, në përputhje me Rregulloren për Mbledhjen e të Ardhurave. Një kopje e dëshmisë së pagesës dorëzohet bashkë me kërkesën për njehsim.

21. Për KM-të të cilët duan të bëjnë njehsimin e kurrikulave me programet e reja zbatohen dispozitat e pikave 17, 18, 19, 20 (të zbatueshme në mënyrë analoge vetëm për pjesën e kontabilistit të miratuar) me kushtin që të japin testimin e parashikuar në pikën 12, germa “c” të këtij neni. Testimi i parashikuar në pikën 12, germa “c” të këtij neni, për këta kandidatë mund të organizohet në çdo kohë nga KPAP-ja për të kryer testimin për zhvillim profesional të zbatimit në praktikë të kërkesave të legjislacionit të tatimeve dhe taksave në Republikën e Shqipërisë.

22. Tarifat që do të aplikohen për KM-të përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 47/2016, për hyrjen në testimin vullnetar/për zhvillim profesional të përcaktuar në pikën 12, germa “c” të këtij neni do të ndahen në sezonale dhe josezonale. Tarifat sezonale nënkuptojnë tarifat që aplikohen për këta kandidatë nëse ata vendosin të hyjnë gjatë periudhës së organizimit të provimeve për kandidatët për KM dhe AL. Tarifat josezonale nënkuptojnë tarifat e veçanta kur provimi organizohet jashtë programit vjetor të provimeve për kandidatët për KM dhe AL. Tarifat sezonale për të dhënë testin vullnetar/për zhvillim profesional për “zbatimin në praktikë të kërkesave të legjislacionit të tatimeve dhe taksave në Republikën e Shqipërisë”, në provimin e taksimit të



avancuar janë të njëjtat tarifa që janë parashikuar në rregulloren për mbledhjen e të ardhurave të BMP-së. Tarifat josezonale përcaktohen me vendim të veçantë të BMP-së. Mënyra e organizimit dhe kushtet për të hyrë në testin vullnetar/për zhvillim profesional për “zbatimin në praktikë të kërkesave të legjislacionit të tatimeve dhe taksave në Republikën e Shqipërisë”/provimin e taksimit të avancuar kur ka më pak se 5 kandidat bëhet me vendim të veçantë të BMP-së.

23. Njehsimi i kurrikulave për KM bëhet vetëm për qëllime profesionale brenda apo jashtë vendit të të interesuarve, si dhe për t'u njohur si program në rast se duan të ndjekin programin për AL, por në asnjë rast pa prekur të drejtën e ushtrimit të profesionit si KM apo të drejtat dhe detyrimet që lindin prej ligjit.

KREU IV KUADRI RREGULLATOR I PËRGJITHSHËM DHE MBIKËQYRJA E PRAKTIKËS PROFESIONALE

Neni 10

Dispozita të përgjithshme mbi praktikën profesionale dhe hyrjen në profesion

1. Rregullat e detajuara për hyrjen, ndjekjen dhe përjashtimin nga praktika profesionale përgatiten nga organizata profesionale e audituesve ligjorë dhe miratohen nga BMP-ja, duke respektuar dispozitat e këtij neni dhe rregulloret për edukimin, kualifikimin e vijueshëm, mbikëqyrjen dhe rregullimin e praktikës profesionale të miratuara nga BMP-ja, sipas kërkesave ligjore.

2. Bordi i Mbikëqyrjes Publike, pasi merr propozime të sjella nga organizatat profesionale, i shqyrton ato dhe nëse ka rekomandime nga anëtarët i përfshin ato drejtpërdrejtë në rregullat përfundimtare të cilat miratohen nga BMP-ja.

3. Përpara se të testohet në provimin përfundimtar për marrjen e titullit “Auditues Ligjor”, me qëllim që të regjistrohet në regjistrin publik të audituesve ligjorë, kandidati duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 15 të ligjit për auditimin dhe dispozitat zbatuese të parashikuara në rregulloret për edukimin, kualifikimin e vijueshëm, mbikëqyrjen dhe rregullimin e praktikës profesionale. Për përjashtimin nga kryerja e praktikës profesionale

zbatohen kërkesat e nenit 15 të ligjit për auditimin dhe dispozitat zbatuese të rregulloreve përkatëse.

4. Individët që përjashtohen nga praktika profesionale, duke qenë se kanë 15 vite angazhim në veprimtari profesionale, në përputhje me pikën 6, të nenit 15 të ligjit për auditimin, i nënshtrohen të njëjtut proces testimi, të cilit i nënshtrohen edhe kandidatët.

5. Individët që kërkojnë të përjashtohen nga kryerja e praktikës profesionale duhet t'i dorëzojnë një kërkesë me shkrim këshillit të drejtimit të organizatës profesionale të audituesve ligjorë, së bashku me dokumentacionin mbështetës që provon se kandidati plotëson kohën e angazhimit për t'u përjashtuar nga praktika profesionale. Ky dokumentacion është subjekt i mbikëqyrjes. Këshilli i drejtimit të organizatës profesionale të audituesve ligjorë përcjell pranë BMP-së, propozimin për përjashtimin ose jo nga kryerja e praktikës profesionale të këtyre individëve, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e dorëzimit të kërkesës pranë IEKA-s. Propozimi për përjashtim duhet të përmbajë dokumentacionin, si më poshtë:

a) relacion shoqërues në të cilin argumentohet propozimi për përjashtimin nga praktika profesionale;

b) kopje të dosjes së dorëzuar nga individ i sipas kërkesave të rregullores së edukimit të vijueshëm profesional të IEKA-s;

c) shfuqizohet.

6. BMP-ja shqyrton dhe miraton propozimin e përcjellë nga organizata profesionale e audituesve ligjorë kur propozimi është në pajtim me ligjin dhe kërkesat e kësaj rregulloreje. BMP-ja ka të drejtë ta kthejë për rishqyrtim propozimin e sjellë pranë tij, duke dhënë rekomandimet dhe sugjerimet përkatëse për plotësimin e kushteve të përcaktuara në këtë rregullore për përjashtimin nga praktika profesionale. Këshilli i drejtimit në propozimin e rishikuar duhet të plotësojë të gjitha rekomandimet dhe sugjerimet e BMP-së. Organizata profesionale e audituesve ligjorë përcjell pranë KPAP-së një kopje të vendimit të përjashtimit nga praktika profesionale.

7. BMP-ja kërkon përditësim të dokumentacionit të dorëzuar nga individ, në rast se OPAL-i nuk përcjell propozimin për përjashtim në përputhje me afatet dhe kërkesat e parashikuara në pikën 5 të këtij neni.

8. Përjashtohen nga detyrimi për kryerjen e praktikës profesionale shtetasit shqiptarë, të cilët



kanë fituar titullin CPA apo ACCA në një shtet tjetër dhe që janë anëtarë të një organizimi profesional të audituesve ligjorë në një shtet tjetër, duke qenë të detyruar të japin vetëm provimet e parashikuara në nenin 9, pika 12, germa “b” dhe “c”.

KREU V DOKUMENTACIONI NË MBYLLJE TË PROCESIT TË CERTIFIKIMIT DHE ANKIMIMI

Neni 11 Dëshmitë e testimi

1. Për çdo testim (provim) të dhënë, lidhur me PPAP-të, kandidati fitues do të pajiset me dëshmi të firmosura nga kryetari i KPAP-së dhe anëtari më i vjetër i KPAP-së.

2. Në dëshmi tregohen pikët e fituara. Çdo dëshmi përgatitet në dy kopje, nga të cilat një i jepet kandidatit dhe tjetra ruhet në dosjen e kandidatit.

3. Për kandidatët për Auditues Ligjorë në përfundim të procesit të testeve, BMP-ja pajis kandidatët të cilët kanë përfunduar plotësisht praktikën profesionale trevjeçare dhe që i ka fituar të gjitha provimet, me një dokument zyrtar të emërtuar “CERTIFIKATË”, që vërteton përfundimin me sukses të praktikës profesionale dhe të gjithë PPAP-ve për Audituesin Ligjor.

4. Për kandidatët për Auditues Ligjorë, në përfundim të procesit të testeve, BMP-ja pajis kandidatët të cilët kanë përfunduar pjesërisht praktikën profesionale (në përputhje me nenin 15, pika 1, germa “c” të ligjit për auditimin) dhe që i ka fituar të gjitha provimet, me një dokument zyrtar të emërtuar “DËSHMI PËR MBYLLJEN E PROVIMEVE”, që vërteton mbylljen e provimeve të PPAP-së. Vetëm pasi ka mbyllur plotësisht praktikën profesionale kandidatit i lind e drejta për të marrë certifikatën e cila dëshmon se ka fituar titullin profesional Auditues Ligjor.

5. Për kandidatët për Kontabilist i Miratuar që kanë përmbushur plotësisht dispozitat e ligjit për auditimin, si dhe kërkesat e kësaj rregulloreje dhe që i ka fituar të gjitha provimet, BMP-ja pajis kandidatin me një dokument zyrtar të emërtuar “CERTIFIKATË” që vërteton përfundimin me sukses të dhe të gjitha PPAP-ve përkatëse, të kërkuara për KM.

6. Format i dokumenteve të pikave 1, 3, 4 dhe 5 propozohen nga organizata profesionale e audituesve ligjorë dhe miratohet nga BMP-ja.

7. Dëshmitë e çdo provimi dhe certifikatat përfundimtare (Kontabilist i Miratuar ose Auditues Ligjor) janë me numër rendor dhe regjistrohen progresivisht në një regjistër të posaçëm të KPAP-së që mbahet nga sekretaria teknike e OPAL-it, i cili dorëzohet në fund të çdo procesi provimi përfundimtar pranë strukturës mbështetëse të BMP-së.

8. Certifikatat e lëshuara nga KPAP-ja dhe BMP-ja janë të ndryshme nga licencat profesionale dhe shërbejnë si dokument zyrtar për t’iu lejuar kandidatëve që kanë fituar titujt përkatës (Auditues Ligjor, Kontabilist i Miratuar) dhe që kanë përmbushur të gjitha detyrimet që rrjedhin nga ligji për auditimin dhe kuadri rregullator i miratuar nga BMP-ja të fitojnë të drejtën për ushtrimin e profesionit.

9. Licencat e AL-së merren pasi kandidatët janë përfshirë në regjistrin Publik të Audituesve Ligjorë.

10. Licencat e KM-së merren pasi kandidatët që kanë fituar titullin profesional KM janë anëtarësuar në një organizatë profesionale të kontabilistëve të miratuar të njohur nga BMP-ja (në përputhje me dispozitat e nenit 51 të ligjit për auditimin) dhe janë përfshirë në regjistrin e këtyre organizatave profesionale të kontabilistëve të miratuar.

Neni 12 Ruajtja dhe asgjësimi i dokumentacionit lidhur me certifikimin

1. Dokumentet zyrtare që përgatiten lidhur me procesin e certifikimit dorëzohen dhe ruhen në fund të çdo sezoni në arkivin e BMP-së, në përputhje me legjislacionin në fuqi, me përjashtim të fletoreve të provimeve të kandidatëve pjesëmarrës, të cilat ruhen jo më shumë se 12 muaj nga data e dhënies së provimit, në varësi të procesit të ankimit.

2. Asgjësimi i fletoreve bëhet nga një komision prej 3 (tre) anëtarësh, 1 anëtar i caktuar nga struktura mbështetëse e BMP-së dhe 2 nga sekretaria teknike e KPAP-së. Deri në asgjësimin e tyre, fletoret administrohen nga sekretaria teknike pranë ambienteve të BMP-së.



Neni 13 Ankimi

1. Kandidatët, për të përfituar titullin për Auditues Ligjor ose Kontabilist i Miratuar kanë të drejtën e ankimit pranë Bordit të Mbikëqyrjes Publike, në rastet në vijim:

- Për vendimet e marra nga KPAP-ja;
- Për propozimet dhe vendimet e marra nga këshilli i drejtimit të organizatës profesionale të audituesve ligjorë ose organizatës së kontabilistëve të miratuar;

- Për refuzimin për pranim të dokumentacionit nga sekretaria teknike e KPAP-së ngritur pranë organizatës profesionale të audituesve ligjorë, si dhe nga struktura mbështetëse e BMP-së;

- Për problematika të lidhura me procesin e organizimit të testeve apo të tjera problematika të lidhura me hartimin dhe përmbajtjen e tezave;

- Për çdo çështje tjetër, lidhur me procesin e testimit, e cila është nën autoritetin e BMP-së.

2. Kandidatët për t'u bërë anëtarë të KPAP-së kanë të drejtën e ankimit pranë Bordit të Mbikëqyrjes Publike, në rastet në vijim:

- Për propozimet dhe vendimet e marra nga institucioni/organizata ku ata aderojnë;

- Për zvarritjen ose refuzimin e shqyrtimit të dosjes nga institucioni/organizata ku ata aderojnë;

- Për refuzimin për pranim të dosjes nga struktura mbështetëse e BMP-së;

- Për problematika të lidhura me procesin e organizimit të njoftimit, thirrjes dhe përzgjedhjes së kandidatëve të propozuara apo të tjera problematika të lidhura me mbarëvajtjen e procesit;

- Për çdo çështje tjetër e cila është nën autoritetin e BMP-së.

3. Me përjashtim të rasteve të parashikuara ndryshe në këtë rregullore, BMP-ja mblidhet me qëllim shqyrtimin e ankimit jo më herët se 10 ditë pune dhe jo më vonë se 45 ditë pune nga momenti i dorëzimit të ankesave pranë strukturës mbështetëse.

4. Të gjitha rastet e lidhura me ankimet e parashikuara në këtë nen, me kërkesë të BMP-së, mund të kalojnë për një mendim teknik pranë strukturës mbështetëse dhe/ose për një mendim ligjor pranë personelit dhe/ose komisionit që merret me çështjet ligjore. Në këto raste, personeli apo anëtarët e strukturave përkatëse përgatisin një raport duke vendosur referencat ligjore dhe rregullatorë,

lidhur me çështjen e ankimit. Ky raport i dorëzohet anëtarëve të BMP-së të cilët mund ta konsiderojnë përgjatë procesit të vendimarrjes.

5. Vendimet e BMP-së do të konsiderohen përfundimtare.

KREU VI DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 14 Dispozita kalimtare dhe përfundimtare

1. Shfuqizohet.

2. Shfuqizohet.

3. Shfuqizohet.

4. Shfuqizohet.

5. Të gjitha aktet e nxjerra nga BMP-ja përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, që bien ndesh me ligjin ose me këtë rregullore shfuqizohen.

6. Të gjitha çështjet që lidhen me funksionimin e KPAP-së apo çdo strukture të lidhur me veprimtarinë e procesit të provimeve dhe çështjeve të lidhura me to, të cilat nuk janë parashikuar as në rregulloret e tjera do të rregullohen me vendime të veçanta të BMP-së, si dhe nga legjislacioni në fuqi.

7. Për të gjitha ato rregullore dhe vendime të përmendura në këtë rregullore, të cilat nuk janë miratuar deri në momentin e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje do të zbatohen vetëm dispozitat e tjera të parashikuara në këtë rregullore, si dhe kërkesat e ligjit të auditimit.

7/1. Shfuqizohet.

7/2. Shfuqizohet.

7/3. Afatet e parashikuara në nenin 4 të kësaj rregulloreje, në kushtet e gjendjes së fatkeqësisë natyrore, do të rregullohen me vendim të veçantë nga BMP-ja.

7/4. Afatet dhe zbatimi i dispozitave të kësaj rregulloreje, si dhe mënyra e organizimit të provimeve, mjediseve dhe çështjeve të lidhura me procesin e provimeve, në kushtet e gjendjes së fatkeqësisë natyrore, ngjarjeve të forcës madhore dhe/ose në gjendjen e pandemisë apo pengesave, që mund të shkaktohen si rrjedhojë e pandemive, sipas përkufizimeve në legjislacionin përkatës, do të rregullohen me vendim të veçantë të BMP-së, duke respektuar kërkesat e këtyre dispozitave.

7/5. Shfuqizohet.

7/6. Mandati i anëtarëve të KPAP-së, që bien ndesh me dispozitat e kësaj rregulloreje, përfundon



automatizisht me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje ose në momentin e konstatimit nga SM-ja apo institucionet propozuese të anëtarit përkatës.

8. Të gjithë kandidatët që janë regjistruar për të fituar titullin AL por kanë kaluar me sukses së paku të njëjtat provime që kryejnë kandidatët për KM, u lind e drejta të marrin edhe titullin e KM-së. Tarifa për mbulimin e kostove administrative dhe të printimit mbulohet nga personi që aplikon për njohjen e provimeve.

9. Shfuqizohet.

10. Ngarkohen për zbatimin e kësaj rregulloreje Bordi i Mbikëqyrjes Publike, Komisioni i Provimit të Aftësive Profesionale, Komisioni i Rishikimit, organizatat profesionale që janë subjekt i mbikëqyrje së BMP-së, struktura mbështetëse e BMP-së, kandidatët për AL dhe KM, si dhe sekretaria teknike e KPAP-së.

VENDIM

Nr. 241, datë 28.8.2026

MBI MODIFIKIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “POWER ENERGY” SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 25 mw

Në mbështetje të neneve 16, 51 dhe 136, pika 2, të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të nenit 11, pika 3, të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; të neneve 13, 14, pika 9 dhe 15, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; të “Rregullave për njoftimin dhe regjistrimin pranë ERE-s të impianteve të depozitimit të energjisë elektrike gjatë regjimit kalimtar”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 230, datë 18.8.2026, si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.8.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1608/10 prot., datë 27.8.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit,

Autorizimeve dhe Garancive të Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Power Energy’ sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 25 mw”,

konstatoi se:

1. Të dhëna për shoqërinë

- Shoqëria “Power Energy” sh.p.k. është licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 198, datë 15.8.2025, të ndryshuar, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 25 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1608 prot., datë 15.5.2026, shoqëria ka paraqitur kërkesën për modifikimin e licencës së saj dhe shtimin e veprave ndihmëse (sistem akumulimi energjie) në aneksin A të licencës, pa ndryshuar kapacitetin total të centralit, prej 25 mw.

- Ky aplikim vjen në rrethanat kur shoqëria disponon vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 310, datë 4.6.2025, si dhe kontratën nr. 5129 rep., nr. 2337 kol., datë 13.6.2025, referohet e drejta “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 25 mw, dhe veprave ndihmëse, në zonën kadastrale 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier, nga shoqëria ‘Power Energy’ sh.p.k.”, si dhe referuar përcaktimeve të pikës 3, të nenit 11, të ligjit nr. 24/2023.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 148, datë 28.5.2026, vendosi të fillojë procedurën për modifikimin e licencës së shoqërisë për prodhimin e energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 30.5.2026 dhe 1.6.2026) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 29.6.2026), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- ERE, me shkresën nr. 1608/4 prot., datë 3.6.2026, ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM) dhe Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OSTI) sh.a., për fillimin e kësaj procedure. Në lidhje me përgjigjet e institucioneve



të njoftuara, nga ana e MIE-s është përcjellë qëndrimi, sikurse më poshtë referuar, ndërsa nga ana e AKM-së nuk rezulton të jetë depozituar ndonjë përgjigje në lidhje me këtë procedurë. Po ashtu, nga ana e “OST” sh.a. nuk ka pasur kthim përgjigje, por gjithsesi, njohja në kuadër të kësaj procedure nuk e zhvesh subjektin nga detyrimet e tjera, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 59/2026, si dhe të “Rregullave për njoftimin dhe regjistrimin në ERE të impianteve të depozitimit të energjisë elektrike gjatë regjimit kalimtar”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 230, datë 18.8.2026.

- Me shkresën nr. 1608/3 prot., datë 3.6.2026, ERE ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës për modifikimin e licencës së saj, si dhe e ka bërë me dije, në lidhje me informacionin/ dokumentacionin që duhet të plotësohet për këtë aplikim.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1608/5 prot., datë 15.6.2026, shoqëria ka depozituar informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar në kuadër të procedurës së modifikimit të licencës.

- Me shkresën nr. 4755/1 prot., datë 29.6.2026, protokolluar në ERE me nr. 1291/9 prot., datë 1.7.2026, MIE ka bërë me dije, ndër të tjera se, referuar të drejtës për ndërtim të lëshuar nga MIE dhe parashikimeve të kontratës së nënshkruar ndërmjet palëve në vijim, çdo ndryshim në projekt, përfshirë shtimin e veprave ndihmëse apo njërive të depozitimit të energjisë elektrike, duhet të trajtohet në përputhje me kushtet kontraktuale dhe kuadrin rregullator në fuqi, duke sjellë në vëmendje të ERE-s për të mbajtur në konsideratë këtë qëndrim për të gjitha njoftimet e vendimeve të Bordit të ERE-s, lidhur me modifikimin e licencave për shtimin e veprave ndihmëse/njërive të depozitimit të energjisë elektrike.

- Me shkresën nr. 1608/6 prot., datë 14.7.2026, ERE i ka përcjellë shoqërisë qëndrimin e MIE-s dhe i ka kërkuar depozitimin e qëndrimit përkatës të MIE-s, lidhur me shtimin e veprave ndihmëse dhe njërive të depozitimit të energjisë elektrike. Kjo shkresë i është përcjellë shoqërisë edhe nëpërmjet *email-it* të datës 21.7.2026, pasi dërgesa postare ishte kthyer mbrapsht.

- Me vendimin nr. 205, datë 21.7.2026, Bordi i ERE-s ka vendosur pezullimin e procedurës deri në administrimin nga ERE të qëndrimit të MIE-s, por jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë nga hyrja në fuqi e vendimit. Ky vendim i është njoftuar shoqërisë me shkresën nr. 1608/8 prot., datë 29.7.2026.

- Me shkresën nr. 4755/15 prot., datë 3.8.2026, protokolluar në ERE me nr. 1608/9 prot., datë 5.8.2026, MIE ka sqaruar se, për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese që nuk janë objekt koncesioni, zbatohen rregullat dhe procedurat e VKM-së nr. 822/2015, të ndryshuar. Për impiantet e depozitimit të energjisë elektrike, MIE ka referuar zbatimin e nenit 51, pikat 3, 4 dhe 5, të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”, sipas të cilit impiantet e depozitimit që ishin në zhvillim ose në operim pa licencën përkatëse në datën e hyrjes në fuqi të ligjit njihen dhe lejohen të vijnë në operim sipas licencës ekzistuese; operatori duhet të aplikojë për licencë të posaçme të depozitimit brenda 12 muajve, sipas pikës 4 dhe të njoftojë e të regjistrohet në ERE, brenda 60 ditëve, sipas pikës 5. Në këtë kuadër, MIE vlerëson se shoqëria “Power Energy” sh.p.k. mund të vijojë operimin sipas licencës ekzistuese, në përputhje me nenin 51, të ligjit nr. 59/2026.

- Me administrimin e qëndrimit të MIE-s, konsiderohet i përmbushur qëllimi dhe kushti mbi të cilin është bazuar pezullimi i procedurës, ndaj kushti i përcaktuar në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 205, datë 21.7.2026, konsiderohet i ezauruar.

- Në kushtet kur impianti i depozitimit të energjisë elektrike të deklaruar nga shoqëria i nënshtrohen regjimit të posaçëm kalimtar të përcaktuar në nenin 51, të ligjit nr. 59/2026, njohja e tij dhe vijimi i përkohshëm i operimit sipas licencës ekzistuese, në kuptim të pikës 3 të këtij neni, nuk zëvendëson licencën e posaçme për operimin e impiantit të depozitimit dhe nuk përbën pengesë për vijimin dhe përfundimin e procedurës së modifikimit të licencës së prodhimit. Për rrjedhojë, shqyrtimi i kërkesës së shoqërisë nga ERE kufizohet në përmbushjen e kriterëve dhe kërkesave të tjera ligjore dhe rregullatore të zbatueshme për modifikimin e licencës.

- Referuar dokumentacionit të administruar, përmbushjes së kërkesave të ERE-s gjatë shqyrtimit të aplikimit dhe qëndrimit të MIE-s të përcjellë me shkresën nr. 4755/15 prot., datë 3.8.2026, vlerësohet se janë përmbushur kushtet ligjore dhe rregullatore për miratimin e kërkesës së shoqërisë “Power Energy” sh.p.k. për modifikimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike.

- Për sa më sipër, vlerësohet që, të licencuarit t'i lihet detyrë të sigurojë që gjatë të gjithë kohës së operimit të impiantit të depozitimit të energjisë



elektrike, i përbërë nga 5 njësi me kapacitet energjetik 5.015 mwh secila dhe kapacitet energjetik total 25.075 mwh), të mos tejkalojë kapacitetin e instaluar të centralit fotovoltaiik të licencuar prej 25 mw, si dhe të respektojë kushtet dhe kufizimet teknike të përcaktuara nga operatori i rrjetit .

- E drejta e operimit të impiantit të depozitimit të energjisë elektrike, brenda licencës, i njihet shoqërisë deri në përfundim të periudhës 12-mujore të përcaktuar në nenin 51, pika 5, të ligjit nr. 59/2026, brenda së cilës shoqëria duhet të aplikojë për licencë për operimin e impiantit të depozitimit sipas legjislacionit në fuqi.

- Po ashtu, duke qenë se me vendimin nr. 230, datë 18.8.2026, ERE ka miratuar “Rregullat për njoftimin dhe regjistrimin pranë ERE-s të impianteve të depozitimit të energjisë elektrike gjatë regjimit kalimtar”, vlerësohet se informacioni dhe dokumentacioni i administruar në këtë procedurë mund të përdoret edhe për qëllimet e njoftimit dhe regjistrimit, duke u plotësuar, kur është e nevojshme, me dokumentacionin shtesë të kërkuar. Njoftimi dhe regjistrimi duhet të trajtohen si detyrim i veçantë i operatorit sipas nenit 51, pika 5, të ligjit nr. 59/2026, brenda afatit ligjor 60-ditor nga ndërhyrja në fuqi e ligjit. Përmbushja e këtyre kërkesave do të trajtohet në kuadër të procesit të njoftimit dhe regjistrimit dhe nuk përbën pengesë për vijimin dhe përfundimin e procedurës së modifikimit të licencës.

- Nga analiza e aplikimit rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga “Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të modifikojë licencën e shoqërisë “Power Energy” sh.p.k. dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 198, datë 15.8.2025, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 25 mw, duke reflektuar në aneksin A, të licencës impiantit e depozitimit të energjisë elektrike, të përbërë nga 5

(pesë) njësi me kapacitet energjetik 5.015 mwh secila dhe kapacitet energjetik total 25.075 mwh.

2. Impianti i depozitimit të energjisë elektrike, i përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, për periudhën kalimtare njihet dhe lejohet të vijojë operimin në kuadër të licencës ekzistuese të prodhimit, në përputhje me nenin 51, pika 3, të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”. Reflektimi i tij në licencën e prodhimit nuk përbën dhe nuk zëvendëson licencën për operimin e impiantit të depozitimit të energjisë elektrike, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

3. Shoqëria “Power Energy” sh.p.k. ka detyrimin të sigurojë që gjatë të gjithë kohës së operimit të impiantit të depozitimit të energjisë, fuqia totale e injektuar në pikën e lidhjes në rrjet të mos tejkalojë në asnjë moment 25 mw, përkatësisht kapacitetin e instaluar të centralit fotovoltaiik të licencuar, si dhe të respektojë kushtet dhe kufizimet teknike të përcaktuara nga operatori i rrjetit.

4. E drejta për vijimin e operimit të impiantit të depozitimit të energjisë elektrike, sipas pikës 2, të këtij vendimi i njihet shoqërisë vetëm për periudhën kalimtare të parashikuar në nenin 51, të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”. Shoqëria ka detyrimin që, brenda afatit 12-mujor të përcaktuar në pikën 5, të nenit 51 të këtij ligji, të paraqesë pranë ERE-s aplikimin për licencimin e veprimtarisë së operimit të impiantit të depozitimit të energjisë elektrike, në përputhje me legjislacionin dhe aktet rregullatore në fuqi për ushtrimin e këtij aktiviteti.

5. Përfundimi i periudhës kalimtare të përcaktuar në pikën 4 të këtij vendimi nuk krijon të drejtë për vijimin e operimit të impiantit të depozitimit të energjisë elektrike në kuadër të licencës së prodhimit, përtej rasteve dhe kushteve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

6. Ky vendim është objekt rishikimi në rast se rezulton se të dhënat, dokumentacioni ose rrethanat mbi të cilat është bazuar vendimarrja e Bordit të ERE-s kanë ndryshuar ose nuk përputhen me gjendjen faktike dhe juridike të impianteve të depozitimit të energjisë elektrike.

7. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “Power Energy” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM) dhe shoqërinë “Operatori i Sistemit të



Transmetimit” (OST) sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse kur gjykata vendos ndryshe, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti

VENDIM
Nr. 242, datë 28.8.2026

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS
ADMINISTRATIVE PËR KËRKESËN E
SHOQËRISË “ALBPOWER” SHPK PËR
LICENCIM NË VEPRIMTARINË E
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 40, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të neneve 4, pika 1, germa “e”, 5, pika 1, germa “e” dhe 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.8.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2586/1 prot., datë 26.8.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Originës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘AlbPower’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “AlbPower” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE nr. 2586 prot., datë 21.8.2026, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Nga shqyrtimi i aplikimit rezulton se ajo ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në nenin 9, për pikën 1.1, germat: “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, germat: “a” “c” dhe “d”; për pikën 1.3, germat “a”, “b”, si dhe pikën 2.5.

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar rezulton se, në vijim të procedurës, shoqëria duhet të plotësojë aplikimin me dokumentacionin dhe informacionin, si më poshtë:

Neni 9. Format i dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1. Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.2. Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- germa “b”: Dëshminë e penaltetit të përditësuar për shoqërinë;

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- germa “c”: Sqarime dhe plotësime të planit të biznesit, lidhur me sasitë e energjisë elektrike të parashikuara për t'u tregtuar gjatë 5 (pesë) viteve në vijim.

Dokumentacioni i depozituar vlerësohet i mjaftueshëm për fillimin e procedurës administrative.

Në vijim të procedurës, shoqëria “AlbPower” sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE dokumentacionin dhe informacionin e sipërcituar, në përputhje me kërkesat e nenit 9, të rregullores së licencimit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën administrative për licencimin e shoqërisë “AlbPower” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Shoqëria “AlbPower” sh.p.k. të depozitojë në ERE, në vijim të procedurës, dokumentacionin dhe informacionin plotësues si më poshtë:



a) dëshminë e penalitetit të përditësuar për shoqërinë, në përputhje me nenin 9, pika 1.2, germa “b”, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar.

b) planin e biznesit të plotësuar, në të cilin të evidentohen, për secilin nga 5 (pesë) vitet e parashikuara të ushtrimit të veprimtarisë, sasitë e energjisë elektrike që shoqëria parashikon të tregtojë, të shprehura në mwh, në përputhje me nenin 9, pika 1.3, germa “c”, të rregullores së licencimit.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “AlbPower” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse kur gjykata vendos ndryshe, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 243, datë 28.8.2026

MBI MODIFIKIMIN E LICENCËS SË
SHOQËRISË “GREENNAT SOLAR PARK
BALLSH” SHPK NË VEPRIMTARINË E
PRODIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA CENTRALI
FOTOVOLTAIK ME KAPACITET
TË INSTALUAR 100 mw

Në mbështetje të neneve 16, 51 dhe 136, pika 2, të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të nenit 11, pika 3, të ligjit nr. 24/2023,

“Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; neneve 13, 14, pikat 9 dhe 10, si dhe nenit 15, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; të “Rregullave për njoftimin dhe regjistrimin pranë ERE-s të impianteve të depozitimit të energjisë elektrike gjatë regjimit kalimtar”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 230, datë 18.8.2026, si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.8.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1291/16 prot., datë 27.8.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘GreenNat Solar Park Ballsh’ sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 100 mw”,

konstatoi se:

1. Të dhëna për shoqërinë

- Shoqëria “GreenNat Solar Park Ballsh” sh.p.k., është licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 132, datë 2.7.2024, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 100 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale 1090, Njësia Administrative Ballsh, Bashkia Mallakastër, qarku Fier, i ndryshuar.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1291 prot., datë 28.4.2026, shoqëria ka paraqitur aplikim për modifikimin e licencës, duke shtuar veprat ndihmëse/njësitë e depozitimit të energjisë elektrike në aneksin A të saj pa ndryshuar kapacitetin e instaluar të centralit fotovoltaiik prej 100 mw. Nga shqyrtimi paraprak i dosjes rezultoi mungesa e pagesës së aplikimit, ndaj ERE, me *email*-in nr. 1291/1 prot., datë 5.5.2026, kërkoj kryerjen e saj. Pas pagesës, me *email*-in nr. 1291/2 prot., datë 18.5.2026, shoqëria paraqiti saktësime dhe sqarime, duke kërkuar edhe ndryshimin e numrit të paneleve/njësive gjeneruese, pa ndryshuar kapacitetin e instaluar të centralit fotovoltaiik prej 100 mw.

- Ky aplikim vjen në rrethanat kur shoqëria disponon vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 6, datë 11.1.2023, si dhe kontratën nr. 31 rep., nr.



13 kol., datë 27.1.2023, “Kontratë për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 100 mw dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në zonën kadastrale nr. 1090, Njësia Administrative Ballsh, Bashkia Mallakastër, qarku Fier, nga shoqëria ‘GreeNNat Solar Park Ballsh’ sh.p.k.”.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 146, datë 28.5.2026, vendosi të fillojë procedurën për modifikimin e licencës së shoqërisë për prodhimin e energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 30.5.2026 dhe 1.6.2026). Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- ERE, me shkresën nr. 1291/6 prot., datë 2.6.2026, ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës për modifikimin e licencës së saj, si dhe i ka bërë me dije, në lidhje me dokumentacionin/informacionin i cili duhej të plotësohej për këtë aplikim.

- ERE, me shkresën nr. 1291/7 prot., datë 2.6.2026, ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM) dhe Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a., për fillimin e kësaj procedure. Nga ana e AKM dhe OST sh.a., nuk rezulton të ketë pasur ndonjë qëndrim në lidhje me këtë procedurë.

- Gjithsesi, njohja në kuadër të kësaj procedure është kryer dhe nuk i zhvesh subjektet nga detyrimet e tjera, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 59/2026, si dhe të “Rregullave për njoftimin dhe regjistrimin në ERE të impianteve të depozitimit të energjisë elektrike gjatë regjimit kalimtar”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 230, datë 18.8.2026.

- Ndërkohë nga ana e MIE-s, brenda afatit të pritjeve të komenteve, me shkresën nr. 4755/1 prot., datë 29.6.2026, protokolluar në ERE me nr. 1291/9 prot., datë 1.7.2026, është bërë me dije, ndër të tjera se, referuar të drejtës për ndërtim të lëshuar nga MIE dhe parashikimeve të kontratës së nënshkruar ndërmjet palëve në vijim, çdo ndryshim në projekt, përfshirë shtimin e veprave ndihmëse dhe/ose njësive të depozitimit të energjisë elektrike, duhet të trajtohet në përputhje me kushtet kontraktuale dhe kuadrin rregullator në fuqi, duke sjellë në vëmendje të ERE-s për të mbajtur në konsideratë këtë

qëndrim për të gjitha njoftimet e vendimeve të Bordit të ERE-s, lidhur me modifikimin e licencave për shtimin e veprave ndihmëse/njësive të depozitimit të energjisë elektrike.

- Me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 1291/8 prot., datë 24.6.2026 dhe me nr. 1291/10 prot., datë 8.7.2026, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit.

- ERE me shkresën nr. 1291/11 prot., datë 14.7.2026, i është drejtuar MIE-s, për dijeni shoqërisë, duke i kërkuar sqarimin përkatës në rast se shoqëria duhet të marrë në mënyrë specifike qëndrimin e saj për ndryshimin e numrit të paneleve dhe shtimin e veprave ndihmëse/njësive të depozitimit të energjisë elektrike.

- Për sa më sipër, me qëllim administrimin e një qëndrimit të MIE-s, lidhur me ndryshimin e numrit të paneleve dhe shtimin e veprave ndihmëse/njësive të depozitimit të energjisë elektrike, Bordi i ERE-s me vendimin nr. 202, datë 21.7.2026, vendosi të pezullojë procedurën deri në marrjen e qëndrimit nga ana e MIE-s, por jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë nga hyrja në fuqi e vendimit.

- Ky vendim i është njoftuar shoqërisë nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 1291/13 prot., datë 29.7.2026.

- MIE, me shkresën nr. 4755/12 prot., datë 3.8.2026, protokolluar në ERE me nr. 1291/14 prot., datë 5.8.2026, sqaroi se, sipas kontratës nr. 31 rep., nr. 13 kol., datë 27.1.2023, parametrat teknikë/energjetikë mund të ndryshojnë me miratim të ministrisë, me kusht që kapaciteti prodhues të mos kalojë 100 mw. Për shtimin e impiantit të depozitimit, MIE referon zbatimin e VKM-së nr. 822/2015, të ndryshuar, si dhe nenit 51, të ligjit nr. 59/2026, sipas të cilit shoqëria duhet të njoftojë dhe regjistrohet pranë ERE-s brenda 60 ditëve dhe të aplikojë për licencën e operimit brenda 12 muajve. Në përfundim, MIE vlerëson se shoqëria “GreeNNat Solar Park Ballsh” sh.p.k. mund të vijojë operimin sipas licencës ekzistuese gjatë periudhës tranzitore të parashikuar nga ligji, në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në ligj.

- Nga sa më sipër, rezulton se MIE ka dhënë qëndrimin e saj, lidhur me shtimin dhe operimin e njësive të depozitimit të energjisë elektrike, ndërsa nuk ka dhënë një sqarim specifik nëse ndryshimi i numrit të paneleve fotovoltaike, pa ndryshuar kapacitetin prodhues prej 100 mw, kërkon miratim paraprak apo përmbyshjen e një procedure tjetër administrative pranë MIE-s.



- ERE, me shkresën nr. 1291/15 prot., datë 20.8.2026, me qëllim qartësimin e mëtejshëm të qëndrimit të MIE-s, lidhur me këtë procedurë, i ka kërkuar të sqarojë nëse ndryshimi i numrit të paneleve, pa ndryshuar kapacitetin prodhues të centralit, konsiderohet si ndryshim i parametrave teknikë/energjetikë sipas kontratës nr. 31 rep., nr. 13 kol., datë 27.1.2023 dhe nëse për këtë ndryshim kërkohet miratim paraprak apo procedurë tjetër administrative pranë MIE-s.

- Duke qenë se qëndrimi i MIE-s është i nevojshëm për trajtimin e kërkesës së shoqërisë për ndryshimin e numrit të paneleve fotovoltaike dhe për përcaktimin nëse ky ndryshim kërkon miratim paraprak apo përmbushjen e ndonjë procedure tjetër administrative pranë MIE-s, në kuadër të këtij modifikimi do të trajtohet vetëm çështja e shtimit të impiantit të depozitimit të energjisë (BESS), ndërsa për kërkesën për ndryshimin e numrit të paneleve vlerësohet të pezullohet procedura deri në administrimin e qëndrimit përkatës të MIE-s, por jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë, duke filluar nga data 20.8.2026, datë në të cilën ERE i ka përcjellë MIE-s kërkesën për qëndrim.

- Po ashtu, në nenin 14, pika 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, parashikohet se Bordi i ERE-s, rast pas rasti, pas fillimit të procedurës, mund të vendosë të pezullojë vendimmarrjen e tij.

- Me administrimin nga ERE të shkresës së MIE-s nr. 4755/12 prot., datë 3. 8.2026, konsiderohet i përmbushur kushti procedural mbi të cilin ishte bazuar pezullimi i procedurës me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 202, datë 21.7.2026. Megjithatë, duke qenë se ky qëndrim nuk ka dhënë një sqarim specifik, lidhur me ndryshimin e numrit të paneleve fotovoltaike, për këtë çështje ERE i është drejtuar sërish MIE-s me shkresën nr. 1291/15 prot., datë 20.8.2026.

- Në kushtet kur impianti i depozitimit të energjisë (BESS), i deklaruar nga shoqëria, i nënshtrohet regjimit të posaçëm kalimtar të përcaktuar në nenin 51, të ligjit nr. 59/2026, njohja e tyre dhe vijimi i operimit sipas licencës ekzistuese përbëjnë çështje të rregulluara drejtpërdrejt nga ligji dhe nuk përbëjnë pengesë për vijimin dhe përfundimin e procedurës së modifikimit të licencës

së prodhimit. Për rrjedhojë, shqyrtimi i kërkesës së shoqërisë nga ERE kufizohet në përmbushjen e kritereve dhe kërkesave të tjera ligjore dhe rregullatore të zbatueshme për modifikimin e licencës.

- Referuar dokumentacionit të administruar, përmbushjes së kërkesave të ERE-s gjatë shqyrtimit të aplikimit dhe qëndrimit të MIE-s të përcjellë me shkresën nr. 4755/12 prot., datë 3.8.2026, vlerësohet se janë përmbushur kushtet ligjore dhe rregullatore për miratimin e kërkesës së shoqërisë “GreeNNat Solar Park Ballsh” sh.p.k. për modifikimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike.

- Për sa më sipër, vlerësohet që, të licencuarit t'i lihet detyrë të sigurojë që gjatë të gjithë kohës së operimit të impiantit të depozitimit të energjisë (BESS), i përbërë nga 36 njësi me kapacitet energjetik 2.5 mwh secila, pra me kapacitet energjetik total 90 mwh, të mos tejkalojë kapacitetin e instaluar të centralit fotovoltaike të licencuar prej 100 mw, si dhe të respektojë kushtet dhe kufizimet teknike të përcaktuara nga operatori i rrjetit.

- E drejta e operimit të impiantit të depozitimit të energjisë (BESS) i njihet shoqërisë, sipas licencës ekzistuese, deri në përfundim të periudhës 12-mujore të përcaktuar në nenin 51, pika 5, të ligjit nr. 59/2026, brenda së cilës shoqëria duhet të aplikojë për licencë për operimin e impiantit të depozitimit sipas legjislacionit në fuqi.

- Po ashtu, duke qenë se me vendimin nr. 230, datë 18.8.2026, ERE ka miratuar “Rregullat për njoftimin dhe regjistrimin pranë ERE-s të impianteve të depozitimit të energjisë elektrike gjatë regjimit kalimtar”, vlerësohet se informacioni dhe dokumentacioni i administruar në këtë procedurë mund të përdoret edhe për qëllimet e njoftimit dhe regjistrimit, duke u plotësuar, kur është e nevojshme, me dokumentacionin shtesë të kërkuar. Njoftimi dhe regjistrimi duhet të trajtohen si detyrim i veçantë i operatorit sipas nenit 51, pika 5, të ligjit nr. 59/2026, brenda afatit ligjor 60-ditor nga hyrja në fuqi e ligjit. Përmbushja e këtyre kërkesave do të trajtohet në kuadër të procesit të njoftimit dhe regjistrimit dhe nuk përbën pengesë për vijimin dhe përfundimin e procedurës së modifikimit të licencës.

- Nga analiza e aplikimit rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A dhe ka plotësuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga “Rregullorja për



procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të modifikojë licencën e shoqërisë “GreeNNat Solar Park Ballsh” sh.p.k., dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 132, datë 2.7.2024, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 100 mw, duke reflektuar në aneksin A të licencës impiantit të depozitimit të energjisë elektrike (BESS), të përbërë nga 36 (tridhjetë e gjashtë) njësi me kapacitet energjetik 2,5 mwh secila dhe kapacitet energjetik total 90 mwh.

2. Impianti i depozitimit të energjisë elektrike (BESS), i përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, për periudhën kalimtare njihet dhe lejohet të vijoje operimin në kuadër të licencës ekzistuese të prodhimit, në përputhje me nenin 51, pika 3, të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”. Reflektimi i tij në licencën e prodhimit nuk përbën dhe nuk zëvendëson licencën për operimin e impiantit të depozitimit të energjisë elektrike, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

3. Shoqëria “GreeNNat Solar Park Ballsh” sh.p.k. ka detyrimin të sigurojë që, gjatë operimit të centralit fotovoltaiik dhe impiantit të depozitimit të energjisë elektrike (BESS), fuqia aktive totale e injektuar në pikën e lidhjes në rrjet nga centrali fotovoltaiik dhe impianti i depozitimit, në asnjë moment, të mos tejkalojë 100 mw, përkatësisht kapacitetin e instaluar të centralit fotovoltaiik të licencuar, si dhe të respektojë kushtet dhe kufizimet teknike të përcaktuara nga operatori i rrjetit.

4. E drejta për vijimin e operimit të impiantit të depozitimit të energjisë elektrike (BESS), sipas pikës 2 të këtij vendimi, i njihet shoqërisë vetëm për periudhën kalimtare të parashikuar në nenin 51, të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”. Shoqëria ka detyrimin që, brenda afatit 12-mujor të përcaktuar në pikën 5, të nenit 51 të këtij ligji, të paraqesë pranë ERE-s aplikimin për licencimin e veprimtarisë së operimit të impiantit

të depozitimit të energjisë elektrike, në përputhje me legjislacionin dhe aktet rregullatore në fuqi.

5. Përfundimi i periudhës kalimtare të përcaktuar në pikën 4 të këtij vendimi nuk krijon të drejtë për vijimin e operimit të impiantit të depozitimit të energjisë elektrike, në kuadër të licencës së prodhimit, përtej rasteve dhe kushteve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

6. Të pezullojë procedurën administrative për pjesën e kërkesës së shoqërisë “GreeNNat Solar Park Ballsh” sh.p.k., që lidhet me ndryshimin e numrit të paneleve të centralit fotovoltaiik, deri në administrimin e qëndrimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), por jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë, duke filluar nga data 20.8.2026, datë në të cilën ERE i ka përcjellë MIE-s kërkesën për qëndrim.

7. Me administrimin e qëndrimit të MIE-s ose, në çdo rast, me përfundimin e afatit të përcaktuar në pikën 6 të këtij vendimi, procedura administrative për pjesën e kërkesës së pezulluar rifillon dhe afati për vendimmarrjen vijon të llogaritet për pjesën e mbetur.

8. Ky vendim është objekt rishikimi në rast se rezulton se të dhënat, dokumentacioni ose rrethanat mbi të cilat është bazuar vendimmarrja e Bordit të ERE-s kanë ndryshuar ose nuk përputhen me gjendjen faktike dhe juridike të impianteve të depozitimit të energjisë elektrike, si dhe në rast depozitimi të një qëndrimi nga MIE, në lidhje me pikën 6 të këtij vendimi.

9. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “GreeNNat Solar Park Ballsh” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM) dhe shoqërinë “Operatori i Sistemit të Transmetimit” (OST) sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse



kur gjykata vendos ndryshe, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 244, datë 28.8.2026

MBI MODIFIKIMIN E LICENCËS SË
SHOQËRISË “IDI 2005” SHPK NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
CENTRALI FOTOVOLTAIK ME
KAPACITET TË INSTALUAR 8.8 mw

Në mbështetje të neneve 16, 51 dhe 136, pika 2, të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të nenit 11, pika 3, të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; të neneve 13, 14, pika 9 dhe 15, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; të “Rregullave për njoftimin dhe regjistrimin pranë ERE-s të impianteve të depozitimit të energjisë elektrike gjatë regjimit kalimtar”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 230, datë 18.8.2026, si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.8.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1899/10 prot., datë 27.8.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘IDI 2005’ sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 8.8 mw”,

konstatoi se:

1. Të dhëna për shoqërinë

- Shoqëria “IDI 2005” sh.p.k. është licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 289, datë 13.11.2025, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 8.8 mw, me vendndodhje në zonën

kadastrale nr. 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1899 prot., datë 18.6.2026, ajo ka paraqitur kërkesën për modifikimin e së saj, nëpërmjet saktësimit të veprave ndihmëse (sistem akumulimi energjie) në aneksin A të saj, pa ndryshuar kapacitetin e instaluar të impiantit fotovoltaik të centralit, prej 8.8 mw.

- Ky aplikim vjen në rrethanat ku shoqërisë i është dhënë e drejta në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 534, datë 25.9.2025 dhe Kontratën nr. 1888 rep., nr. 1013 kol., datë 29.10.2025, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 8.8 mw dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në zonën kadastrale 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier, nga shoqëria ‘IDI 2005’ sh.p.k.”, si dhe referuar përcaktimeve të pikës 3, të nenit 11, të ligjit nr. 24/2023.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 178, datë 29.6.2026, vendosi të fillojë procedurën për modifikimin e licencës së shoqërisë për prodhimin e energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 1.7.2026 dhe 2.7.2026) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 10.7.2026), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- ERE, me shkresën nr. 1899/3 prot., datë 6.7.2026, ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM) dhe OSSH sh.a., për fillimin e kësaj procedure. Nga ana e AKM-së dhe “OSSH” sh.a., nuk rezultoi të ketë pasur ndonjë qëndrim në lidhje me këtë procedurë.

- Me shkresën nr. 1899/4 prot., datë 6.7.2026, ERE ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës për modifikimin e licencës së saj, si dhe i ka bërë me dije në lidhje me dokumentacionin/informacionin i cili ka ende nevojë për t’u plotësuar. Shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1899/7 prot., datë 27.7.2026, ka depozitua në ERE dokumentacionin plotësues.

- Në vijim, në lidhje me përgjigjet e institucioneve të njoftuara, nga ana e MIE-s është përcjellë qëndrimi, sikurse më poshtë referuar, ndërsa nga



AKM-ja nuk rezulton të jetë depozituar ndonjë përgjigje në lidhje me këtë procedurë. Po ashtu, nga ana e “OSSH” sh.a. nuk ka pasur kthim përgjigjeje, por gjithsesi, njohja në kuadër të kësaj procedure nuk e zhvesh subjektin nga detyrimet e tjera, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 59/2026, si dhe të “Rregullave për regjistrimin në ERE të impianteve të depozitimit të energjisë elektrike gjatë regjimit kalimtar”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 230, datë 18.8.2026.

- Rezulton se me shkresën 4755/1 prot., datë 29.6.20256, protokolluar në ERE me nr. 1291/9 prot., datë 1.7.2026, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), ka bërë me dije, ndër të tjera se, referuar të drejtës për ndërtim të lëshuar nga MIE dhe parashikimeve të kontratës së nënshkruar ndërmjet palëve në vijim, çdo ndryshim në projekt, përfshirë shtimin e veprave ndihmëse dhe/ose njësive të depozitimit të energjisë elektrike, duhet të trajtohet në përputhje me kushtet kontraktuale dhe kuadrin rregullator në fuqi, duke sjellë në vëmendje të ERE-s për të mbajtur në konsideratë këtë qëndrim për të gjitha njoftimet e vendimeve të Bordit të ERE-s, lidhur me modifikimin e licencave për shtimin e veprave ndihmëse/njësive të depozitimit të energjisë elektrike.

- Në vijim, ERE i është drejtuar shoqërisë me shkresën 1899/5 prot., datë 14.7.2026, me anë të së cilës, ka njoftuar shoqërinë në lidhje me shkresën e MIE-s, si dhe i ka kërkuar depozitimin në ERE të qëndrimit të MIE-s, në lidhje me shtimin e veprave ndihmëse/njësive të depozitimit të energjisë elektrike.

- Referuar sa më sipër, me qëllim pritjen e qëndrimit të MIE-s për këtë procedurë, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 204, datë 21.7.2026, vendosi të pezullojë procedurën deri në administrimin nga ERE të qëndrimit të MIE-s, por jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

- MIE, me shkresën nr. 4755/14 prot., datë 3.8.2026, protokolluar në ERE me nr. 1899/9 prot., datë 5.8.2026, ka sqaruar se, për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese që nuk janë objekt koncesioni, zbatohen rregullat dhe procedurat e VKM-së nr. 822/2015, të ndryshuar. Për impiantet e depozitimit të energjisë elektrike, MIE ka referuar zbatimin e nenit 51, pikat 3, 4 dhe 5, të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”, sipas të cilit impiantet e depozitimit që ishin në zhvillim

ose në operim pa licencën përkatëse në datën e hyrjes në fuqi të ligjit, njihen dhe lejohen të vijnë në operimin sipas licencës ekzistuese; operatori duhet të aplikojë për licencë të posaçme të depozitimit brenda 12 muajve, sipas pikës 4 dhe të njoftojë e të regjistrohet në ERE, brenda 60 ditëve, sipas pikës 5. Në përfundim, MIE vlerëson se shoqëria “IDI 2005” sh.p.k. mund të vijojë operimin sipas licencës ekzistuese, në përputhje me nenin 51, të ligjit nr. 59/2026.

- Me administrimin nga ERE të qëndrimit të MIE-s, vlerësohet se është përmbushur qëllimi dhe kushti mbi të cilin është bazuar pezullimi i procedurës, sipas pikës 2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 204, datë 21.7.2026. Për rrjedhojë, kushti i përcaktuar në këtë pikë konsiderohet i ezauruar në kuadër të këtij pezullimi.

- Në kushtet kur impianti i depozitimit të energjisë elektrike i deklaruar nga shoqëria i nënshtrihen regjimit të posaçëm kalimtar të përcaktuar në nenin 51, të ligjit nr. 59/2026, njohja e tij dhe vijimi i përkohshëm i operimit sipas licencës ekzistuese, në kuptim të pikës 3 të këtij neni, nuk zëvendëson licencën e posaçme për operimin e impiantit të depozitimit dhe nuk përbëjnë pengesë për vijimin dhe përfundimin e procedurës së modifikimit të licencës së prodhimit. Për rrjedhojë, shqyrtimi i kërkesës së shoqërisë nga ERE kufizohet në përmbushjen e kriterëve dhe kërkesave të tjera ligjore dhe rregullatore të zbatueshme për modifikimin e licencës.

- Referuar dokumentacionit të administruar, përmbushjes së kërkesave të ERE-s gjatë shqyrtimit të aplikimit dhe qëndrimit të MIE-s të përcjellë me shkresën nr. 4755/14 prot., datë 3.8.2026, vlerësohet se janë përmbushur kushtet ligjore dhe rregullatore për miratimin e kërkesës së shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k. për modifikimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike.

- Për sa më sipër, vlerësohet që të licencuarit t'i lihet detyrë të sigurojë që gjatë të gjithë kohës së operimit të impiantit të depozitimit të energjisë, i përbërë nga 5 njësi me kapacitet energjetik 2.4 mwh secila, me kapacitet total energjetik 12 mwh) të mos tejkalojë kapacitetin e instaluar të centralit fotovoltaiik të licencuar prej 8.8 mw, si dhe të respektojë kushtet dhe kufizimet teknike të përcaktuara nga operatori i rrjetit.

- E drejta e operimit të impiantit të depozitimit të energjisë elektrike i njihet shoqërisë, sipas licencës



ekzistuese deri në përfundim të periudhës 12-mujore të përcaktuar në nenin 51, pika 5, të ligjit nr. 59/2026, brenda së cilës shoqëria duhet të aplikojë për licencë për operimin e impiantit të depozitimit sipas legjislacionit në fuqi.

- Po ashtu, duke qenë se me vendimin nr. 230, datë 18.8.2026, ERE ka miratuar “Rregullat për njoftimin dhe regjistrimin pranë ERE-s të impianteve të depozitimit të energjisë elektrike gjatë regjimit kalimtar”, vlerësohet se informacioni dhe dokumentacioni i administruar në këtë procedurë mund të përdoret edhe për qëllimet e njoftimit dhe regjistrimit, duke u plotësuar, kur është e nevojshme, me dokumentacionin shtesë të kërkuar. Njoftimi dhe regjistrimi duhet të trajtohen si detyrim i veçantë i operatorit sipas nenit 51, pika 5, të ligjit nr. 59/2026, brenda afatit ligjor 60-ditor nga hyrja në fuqi e ligjit. Përmbushja e këtyre kërkesave do të trajtohet në kuadër të procesit të njoftimit dhe regjistrimit dhe nuk përbën pengesë për vijimin dhe përfundimin e procedurës së modifikimit të licencës.

- Nga analiza e aplikimit rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga “Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të modifikojë licencën e shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k., dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 289, datë 13.11.2025, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 8.8 mw, duke reflektuar në aneksin A të licencës impiantit e depozitimit të energjisë elektrike, të përbërë nga 5 (pesë) njësi me kapacitet energjetik 2.4 mwh secila dhe kapacitet energjetik total 12 mwh.

2. Impianti i depozitimit të energjisë elektrike, i përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, për periudhën kalimtare njihet dhe lejohet të vijoje operimin në kuadër të licencës ekzistuese të prodhimit, në përputhje me nenin 51, pika 3, të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”. Reflektimi i tij në licencën e prodhimit nuk përbën dhe nuk

zëvendëson licencën për operimin e impiantit të depozitimit të energjisë elektrike, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

3. Shoqëria “IDI 2005” sh.p.k. ka detyrimin të sigurojë që, gjatë operimit të centralit fotovoltaiik dhe impiantit të depozitimit të energjisë elektrike, fuqia aktive totale e injektuar në pikën e lidhjes në rrjet nga centrali fotovoltaiik dhe impianti i depozitimit, në asnjë moment, të mos tejkalojë 8.8 mw, përkatësisht kapacitetin e instaluar të centralit fotovoltaiik të licencuar, si dhe të respektojë kushtet dhe kufizimet teknike të përcaktuara nga operatori i rrjetit,

4. E drejta për vijimin e operimit të impiantit të depozitimit të energjisë elektrike, sipas pikës 2 të këtij vendimi, i njihet shoqërisë vetëm për periudhën kalimtare të parashikuar në nenin 51, të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”. Shoqëria ka detyrimin që, brenda afatit 12-mujor të përcaktuar në pikën 5, të nenit 51 të këtij ligji, të paraqesë pranë ERE-s aplikimin për licencimin e veprimtarisë së operimit të impiantit të depozitimit të energjisë elektrike, në përputhje me legjislacionin dhe aktet rregullatore në fuqi.

5. Përfundimi i periudhës kalimtare të përcaktuar në pikën 4 të këtij vendimi nuk krijon të drejtë për vijimin e operimit të impiantit të depozitimit të energjisë elektrike, në kuadër të licencës së prodhimit, përtej rasteve dhe kushteve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

6. Ky vendim është objekt rishikimi në rast se rezulton se të dhënat, dokumentacioni ose rrethanat mbi të cilat është bazuar vendimarrja e Bordit të ERE-s kanë ndryshuar ose nuk përputhen me gjendjen faktike dhe juridike të impianteve të depozitimit të energjisë elektrike.

7. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancive të Origjinës të njoftojë shoqërinë “IDI 2005” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM) dhe shoqërinë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” (OSSH) sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të



bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse kur gjykata vendos ndryshe, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 245, datë 28.8.2026

MBI MODIFIKIMIN E LICENCËS SË
SHOQËRISË “SUNNY SIDE ENERGY”
SHPK NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA CENTRALI
FOTOVOLTAIK ME KAPACITET
TË INSTALUAR 100 mw

Në mbështetje të neneve 16, 51 dhe 136, pika 2, të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të nenit 11, pika 3, të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; të neneve 13, 14, pika 9 dhe 15, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; të “Rregullave për njoftimin dhe regjistrimin pranë ERE-s të impianteve të depozitimit të energjisë elektrike gjatë regjimit kalimtar”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 230, datë 18.8.2026, si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.8.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1611/11 prot., datë 27.8.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancive të Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Sunny Side Energy’ sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 100 mw”,

konstatoi se:

1. Të dhëna për shoqërinë

- Shoqëria “Sunny Side Energy” sh.p.k. është licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 13, datë 16.1.2025, të ndryshuar, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 100 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 1451, fshati Darzezë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1611 prot., datë 15.5.2026, shoqëria ka paraqitur kërkesën për modifikimin e licencës së saj, dhe shtimin e veprave ndihmëse në aneksin A të licencës, pa ndryshuar kapacitetin total të centralit, prej 100 mw.

- Ky aplikim vjen në rrethanat kur shoqëria disponon vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 673, datë 30.10.2024 dhe kontratën nr. 1192 rep., nr. 482 kol., datë 11.11.2024, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 100 mw dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në zonën kadastrale nr. 1451, fshati Darzezë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier, nga shoqëria ‘Sunny Side Energy’ sh.p.k.”, si dhe referuar përcaktimeve të pikës 3, të nenit 11, të ligjit nr. 24/2023.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 145, datë 28.5.2026, vendosi të fillojë procedurën për modifikimin e licencës së shoqërisë për prodhimin e energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 30.5.2026 dhe 1.6.2026) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 29.6.2026), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- ERE, me shkresën nr. 1611/3 prot., datë 3.6.2026, ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM) dhe Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a., për fillimin e kësaj procedure. Nga ana e AKM-së dhe OST sh.a. nuk rezultoi të ketë pasur kthim përgjigjeje.

- Në lidhje me përgjigjet e institucioneve të njoftuara, nga ana e MIE-s është përcjellë qëndrimi, sikurse më poshtë referuar, por gjithsesi, njohja në kuadër të kësaj procedure nuk i zhvesh subjektet nga



detyrimet e tjera, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 59/2026, si dhe të “Rregullave për regjistrimin në ERE të impianteve të depozitimit të energjisë elektrike gjatë regjimit kalimtar”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 230, datë 18.8.2026.

- Me shkresën nr. 1611/4 prot., datë 3.6.2026, ERE ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës për modifikimin e licencës së saj, si dhe i ka bërë me dije në lidhje me informacionin/dokumentacionin që duhet të plotësohet në aplikim.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1611/5 prot., datë 15.6.2026, shoqëria ka depozituar informacionin/dokumentacionin e kërkuar.

- Në vijim, me shkresën nr. 4755/1 prot., datë 29.6.2026, protokolluar në ERE me nr. 1291/9 prot., datë 1.7.2026, MIE ka bërë me dije, ndër të tjera se, referuar të drejtës për ndërtim të lëshuar nga MIE dhe parashikimeve të kontratës së nënshkruar ndërmjet palëve në vijim, çdo ndryshim në projekt, përfshirë shtimin e veprave ndihmëse dhe/ose njërive të depozitimit të energjisë elektrike, duhet të trajtohet në përputhje me kushtet kontraktuale dhe kuadrin rregullator në fuqi, duke sjellë në vëmendje të ERE-s për të mbajtur në konsideratë këtë qëndrim për të gjitha njoftimet e vendimeve të Bordit të ERE-s, lidhur me modifikimin e licencave për shtimin e veprave ndihmëse/njësive të depozitimit të energjisë elektrike.

- Me shkresën nr. 1611/7 prot., datë 14.7.2026, ERE i ka përcjellë shoqërisë qëndrimin e MIE-s dhe i ka kërkuar depozitimin e qëndrimit përkatës të MIE-s, lidhur me shtimin e veprave ndihmëse dhe njësive të depozitimit të energjisë elektrike.

- Me vendimin nr. 206, datë 21.7.2026, Bordi i ERE-s ka vendosur pezullimin e procedurës deri në administrimin nga ERE të qëndrimit të MIE-s, por jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë nga hyrja në fuqi e vendimit. Ky vendim i është njoftuar shoqërisë nëpërmjet shkresës së ERE nr. 1611/9 prot., datë 29.7.2026.

- Me shkresën nr. 4755/11 prot., datë 3.8.2026, protokolluar në ERE me nr. 1611/10 prot., datë 5.8.2026, MIE ka sqaruar se, për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese që nuk janë objekt koncesioni, zbatohen rregullat dhe procedurat e VKM-së nr. 822/2015, të ndryshuar. Për impiantet e depozitimit të energjisë elektrike, MIE ka referuar zbatimin e nenit 51, pikat 3, 4 dhe 5, të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”, sipas të cilit impiantet në zhvillim ose operim në hyrjen në

fuqi të ligjit, pa licencën përkatëse, njihen dhe lejohen të operojnë sipas licencës ekzistuese, në kushtet dhe afatet e përcaktuara nga ky nen. Në përfundim, MIE vlerëson se shoqëria “Sunny Side Energy” sh.p.k. mund të vijoje operimin sipas licencës ekzistuese, në përputhje me nenin 51, të ligjit nr. 59/2026.

- Me administrimin e qëndrimit të MIE-s, konsiderohet i përmbushur kushti mbi të cilin ishte bazuar pezullimi i procedurës me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 206, datë 21.7.2026.

- Në kushtet kur impianti i depozitimit të energjisë elektrike i deklaruar nga shoqëria i nënshtrohen regjimit të posaçëm kalimtar të përcaktuar në nenin 51, të ligjit nr. 59/2026, njohja e tij dhe vijimi i përkohshëm i operimit sipas licencës ekzistuese, në kuptim të pikës 3 të këtij neni, nuk zëvendëson licencën e posaçme për operimin e impiantit të depozitimit, si dhe nuk përbëjnë pengesë për vijimin dhe përfundimin e procedurës së modifikimit të licencës së prodhimit. Për rrjedhojë, shqyrtimi i kërkesës së shoqërisë nga ERE kufizohet në përmbushjen e kriterëve dhe kërkesave të tjera ligjore dhe rregullatore të zbatueshme për modifikimin e licencës.

- Referuar dokumentacionit të administruar, përmbushjes së kërkesave të ERE-s gjatë shqyrtimit të aplikimit dhe qëndrimit të MIE-s të përcjellë me shkresën nr. 4755/11 prot., datë 3.8.2026, vlerësohet se janë përmbushur kushtet ligjore dhe rregullatore për miratimin e kërkesës së shoqërisë “Sunny Side Energy” sh.p.k. për modifikimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike.

- Për sa më sipër, vlerësohet që, të licencuarit t'i lihet detyrë të sigurojë që gjatë të gjithë kohës së operimit të impiantit të depozitimit të energjisë elektrike, i përbërë nga 20 njësi me kapacitet energjetik 5,015 mwh secila dhe kapacitet energjetik total 100,3 mwh; të mos tejkalojë kapacitetin e instaluar të centralit fotovoltaiik të licencuar prej 100 mw, si dhe të respektojë kushtet dhe kufizimet teknike të përcaktuara nga operatori i rrjetit.

- E drejta e operimit të impiantit të depozitimit të energjisë elektrike, i njihet shoqërisë, sipas licencës ekzistuese, deri në përfundim të periudhës 12-mujore të përcaktuar në nenin 51, pika 5, të ligjit nr. 59/2026, brenda së cilës shoqëria duhet të aplikojë për licencë për operimin e impiantit të depozitimit sipas legjislacionit në fuqi.



- Po ashtu, duke qenë se me vendimin nr. 230, datë 18.8.2026, ERE ka miratuar “Rregullat për njoftimin dhe regjistrimin pranë ERE-s të impianteve të depozitimit të energjisë elektrike gjatë regjimit kalimtar”, vlerësohet se informacioni dhe dokumentacioni i administruar në këtë procedurë mund të përdoret edhe për qëllimet e njoftimit dhe regjistrimit, duke u plotësuar, kur është e nevojshme, me dokumentacionin shtesë të kërkuar. Njoftimi dhe regjistrimi duhet të trajtohen si detyrim i veçantë i operatorit sipas nenit 51, pika 5, të ligjit nr. 59/2026, brenda afatit ligjor 60-ditor nga hyrja në fuqi e ligjit. Përmbushja e këtyre kërkesave do të trajtohet në kuadër të procesit të njoftimit dhe regjistrimit dhe nuk përbën pengesë për vijimin dhe përfundimin e procedurës së modifikimit të licencës.

- Nga analiza e aplikimit rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga “Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të modifikojë licencën e shoqërisë “Sunny Side Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 13, datë 16.1.2025, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 100 mw, duke reflektuar në aneksin A të licencës impiantit e depozitimit të energjisë elektrike (BESS), të përbërë nga 20 (njëzet) njësi me kapacitet energjetik 5,015 mwh secila dhe kapacitet energjetik total 100,3 mwh.

2. Impianti i depozitimit të energjisë elektrike (BESS), i përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, për periudhën kalimtare njihet dhe lejohet të vijojë operimin, në kuadër të licencës ekzistuese të prodhimit, në përputhje me nenin 51, pika 3, të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”. Reflektimi i tij në licencën e prodhimit nuk përbën dhe nuk zëvendëson licencën për operimin e impiantit të depozitimit të energjisë elektrike, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

3. Shoqëria “Sunny Side Energy” sh.p.k. ka detyrimin të sigurojë që, gjatë operimit të centralit fotovoltai dhe impiantit të depozitimit të energjisë elektrike (BESS), fuqia aktive totale e injektuar në pikën e lidhës në rrjet nga centrali fotovoltai dhe impianti i depozitimit, në asnjë moment, të mos tejkalojë 100 mw, përkatësisht kapacitetin e instaluar të centralit fotovoltai të licencuar, si dhe të respektojë kushtet dhe kufizimet teknike të përcaktuara nga operatori i rrjetit.

4. E drejta për vijimin e operimit të impiantit të depozitimit të energjisë elektrike (BESS), sipas pikës 2 të këtij vendimi, i njihet shoqërisë vetëm për periudhën kalimtare të parashikuar në nenin 51, të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”. Shoqëria ka detyrimin që, brenda afatit 12-mujor të përcaktuar në pikën 5, të nenit 51 të këtij ligji, të paraqesë pranë ERE-s aplikimin për licencimin e veprimtarisë së operimit të impiantit të depozitimit të energjisë elektrike, në përputhje me legjislacionin dhe aktet rregullatore në fuqi.

5. Përfundimi i periudhës kalimtare të përcaktuar në pikën 4 të këtij vendimi nuk krijon të drejtë për vijimin e operimit të impiantit të depozitimit të energjisë elektrike, në kuadër të licencës së prodhimit, përtej rasteve dhe kushteve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

6. Ky vendim është objekt rishikimi në rast se rezulton se të dhënat, dokumentacioni ose rrethanat mbi të cilat është bazuar vendimarrja e Bordit të ERE-s kanë ndryshuar ose nuk përputhen me gjendjen faktike dhe juridike të impianteve të depozitimit të energjisë elektrike.

7. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancive të Origjinës të njoftojë shoqërinë “Sunny Side Energy” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM) dhe shoqërinë “Operatori i Sistemit të Transmetimit” (OST) sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në



Fletoren Zyrtare. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse kur gjykata vendos ndryshe, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 246, datë 28.8.2026

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS
ADMINISTRATIVE PËR KËRKESËN E
SHOQËRISË “EUROTECH
INNOVATION” SHPK PËR LICENCIM
NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 40, pika 2, germa “a”, 41, pika 1, germa “a”, dhe 136, pika 2, të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a” dhe 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.8.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2563/1 prot., datë 26.8.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancive të Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘EuroTech Innovation’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “EuroTech Innovation” sh.p.k., me shkresën nr. 2563 prot., datë 19.8.2026, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 1451, fshati Darzezë, njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe

afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezultoi se:

Përputhshmëria e aplikimit me rregulloren

- Në përputhje me nenin 9, pika 1 dhe 1.1 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për pajisjen me licencë sipas germave “a”, “b” dhe “c”, duke plotësuar formularin sipas formatit të përcaktuar në shtojcën 1;

- Në përputhje me nenin 9, pika 1.2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin juridik dhe administrativ të kërkuar sipas germave “a”, “b” dhe “d”.

- Në përputhje me nenin 9, pika 1.3 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin financiar dhe fiskal të kërkuar sipas germës “c”.

- Në përputhje me nenin 9, pika 2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin specifik për licencimin në sektorin e prodhimit të energjisë elektrike sipas germave “c” dhe “d”.

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera
Shoqëria “EuroTech Innovation” sh.p.k.:

- Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) kontratën nr. 3143 rep., nr. 863 kol., datë 30.11.2022, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaiike, me kapacitet prodhues 2 mw dhe veprave ndihmëse, në zonën kadastrale nr. 1451, fshati Darzezë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier, nga shoqëria ‘EuroTech Innovation’ sh.p.k.”;

- Ka marrë miratimin për pikën e lidhjes së centralit me rrjetin e shpërndarjes nëpërmjet shkresës së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH sha) nr. 7737/3 prot., datë 26.8.2022, me lëndë “Miratim pikë lidhje central fotovoltaiik ‘Helios Energy’”, drejtuar shoqërisë “EuroTech Innovation” shpk, për centralin e identifikuar dhe në kontratën me MIE-n.

- Është pajisur me VNM paraprase nr. AN150820240004, datë 19.9.2024, komisioni 118, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për zhvillimin e projektit “Impianti fotovoltaiik Helios Energy 2 mw”, për kapacitetin 2 mw, për centralin e identifikuar dhe në kontratën me MIE-n.

- Rezulton se shoqëria duhet të plotësojë këtë aplikim dhe me dokumentacionin si vijon:

Neni 9. Formatit dhe dokumentacioni për aplikim



Pika 1, Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

- Në lidhje me dokumentacionin juridik, administrativ, financiar dhe fiskal, shoqëria duhet të depozitojë informacion dhe dokumentacion të përditësuar mbi stafin teknik të deklaruar, me qëllim verifikimin e angazhimit aktual të tij pranë shoqërisë, si dhe vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve ndaj organeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, në përputhje me nenin 9, pika 1.2, germa “c”, dhe pika 1.3, germa “a”, të rregullores së licencimit.

- germa “b”: Dokumentacionin mbështetës që vërteton se ka aftësi financiare për të mbuluar 100% të vlerës totale të investimit të projektit sipas kontratës së nënshkruar me MIE-n.

Pika 2, Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

2.1 Për t'u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë gjithashtu:

- germa “a”: informacion mbi numrin e njërive gjeneruese dhe kapacitetin përkatës të tyre, i cili duhet të jetë sa përcaktuar në kuptim të VNM-së dhe marrëveshjes me MIE-n (2 mw), datën në të cilën parashikon të fillojë operimin e centralit dhe nëse disponohet dokumentacionin/certifikatë në lidhje me jetëgjatësinë e pritshme të centralit;

- germa “b”: raportimet e paraqitura pranë MIE-s, në përputhje me përcaktimet e nenit 17, të kontratës nr. 3143 rep., nr. 863 kol., datë 30.11.2022;

- germa “e”: informacion/dokumentacion në lidhje me fillimin e punimeve për ndërtimin e centralit, me qëllim vlerësimin e vlefshmërisë së VNM-së së depozituar në kuadër të aplikimit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën administrative për licencimin e shoqërisë “EuroTech Innovation” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 1451, fshati Darzezë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier.

2. Shoqëria “EuroTech Innovation” sh.p.k. të depozitojë në ERE, në vijim të procedurës, dokumentacionin dhe informacionin plotësues si më poshtë:

a) informacion dhe dokumentacion të përditësuar mbi stafin teknik të deklaruar nga shoqëria, me qëllim verifikimin e angazhimit aktual të tij pranë shoqërisë, si dhe vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve ndaj organeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore;

b) dokumentacionin mbështetës që vërteton aftësinë financiare të shoqërisë për të mbuluar 100% të vlerës totale të investimit të projektit, sipas kontratës së nënshkruar me MIE-n;

c) informacion mbi numrin dhe kapacitetin e njërive gjeneruese, të cilat në total duhet të jenë në përputhje me kapacitetin e centralit fotovoltai prej 2 mw, si dhe datën e parashikuar të fillimit të operimit të centralit dhe, nëse disponohet, dokumentacionin teknik mbi jetëgjatësinë e pritshme të tij;

d) raportimet e paraqitura pranë MIE-s në zbatim të nenit 17 të kontratës së lidhur me këtë ministri;

e) informacion/dokumentacion në lidhje me fillimin e punimeve për ndërtimin e centralit, me qëllim vlerësimin e vlefshmërisë së VNM-së së depozituar në kuadër të aplikimit.


3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancive të Origjinës, të njoftojë shoqërinë “EuroTech Innovation” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse kur gjykata vendos ndryshe, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 272 lekë



[[FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË][Vulosur elektronikisht nga Qendra e
Botimeve Zyrtare][Viti: 2026 - Numri: 198][Datë: 14.09.2026 14:01:10
+02:00][aa29d296-72c7-4b33-8c4d-bcc4f8f10a99]

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik(Qendra e
Botimeve Zyrtare)